

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI I JURIDIKUT
ПРАВЕНА ФАКУЛТЕТ
FAKULTY OF LAW

Fakulteti i Juridikës
Studime pasdiplomike- drejtimi Penal

PUNIM MAGJISTRATURE

“FEMRAT SI SUBJEKTE TË VEPRAVE PENALE SIPAS LEGJISLACIONIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT DHE RIINTEGRIMI I TYRE NË SHOQËRI”

Kandidati-ja:
Lulzana Arslani Iseni me nr. të **ID:117884:**

Mentori:
Prof.dr.Ismail Zejneli

Nëntor, 2020

PËRMBAJTJA E PUNIMIT

FALËNDERIMET	5
QËLLIMET E HULUMTIMIT	6
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	7
RËNDËSIA E PUNIMIT	8
1. HYRJE	8
Pyetjet kërkimore që synohet t'i japim përgjigjë është:	9
KREU I.....	9
1. Kuptimi (nacioni) i kriminalitetit.....	9
1.1. Femrat si subjekt i veprës penale në RMV.....	23
1.2. Femrat si viktimat e veprës penale.....	27
2. Kriminaliteti i femrave në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....	30
3. Aspekte krahasimore-femrat si subjekt i veprave penale.....	35
3.1 Kriminaliteti i femrave në Republikën e Kosovës	35
3.2 Kriminaliteti i femrave në Republikën e Shqipërisë	38
3.3 Riintegrimi i grave të dënuara në Kosovë – Shqipëri.....	39
KREU II	44
Faktorët dhe motivet që dërgojnë në përfshirjen e femrave në kriminalitet	44
1.1 Gjendja ekonomike.....	49
1.2 Papunesia	50
1.3 Varferia.....	52
2.Dhuna në familje	53
2.1 Marrëdhënia e femrave të dënuara me familjarët, fëmijët, bashkëshortin.	57
3.Arsimi.....	58
KREU III	61
1.1 Veprat penale më të përhapura në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga ana e femrave	61
1.2 Mashtrimi	61
1.2 Falsifikimi i dokumentave	66
1.3 Krime kundër jetës.....	70

1.4 Vjedhja	73
1.5 Prostitucioni	75
1.5.1 Kuadri ligjor në lidhje me prostitucionin.....	80
1.6 Vështrim i përgjithshëm, të dhëna statistikore të veprave penale nga Gjykata Themelore në Tetovë	81
Kreu IV	83
Riintegrimi i grave të dënuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.....	83
Mosdiskriminimi i grave të dënuara në RMV	85
Diskriminimi pozitiv.....	85
Dënimi më burg	87
Ambientet e vuajtjes së dënimit me burgim dhe me burgim të përjetshëm	88
Trajtimi i femrave të dënuara me heqje lirie.....	90
Nevoja e trajnimit të veçantë të grave të dënuara me heqje lirie.....	91
Praktika Gjygjësore në Gjykatën Themelore të Tetovës në lidhje me rastet femrat si subjekte të veprave penale.....	92
Statistika rreth veprave penale të kryera nga ana e femrave në RMV për disa vite 2010-2018.....	97
Metoda e analizës së të dhënave.....	101
Intervista dhe përmbajtja e saj	101
Vendndodhja / Mbulimi	101
Instrumentet sasiore.....	101
Pyetje e anketës	102
Tabela 1. Anketa përmban këto të dhëna.....	102
Tabela 2. Grup mosha e të anketuarëve.....	103
Grafikoni 2. Grup mosha e të anketuarëve	103
Tabela 3. Kategoritë e të anketuarëve	103
Grafikoni 3. Kategoritë e të anketuarëve	104
Tabela 4. Vendbanimi i të anketuarëve	104
Grafiku 4. Vendbanimi i të anketuarëve	105
Interpretimi dhe paraqitja e rezultateve nga pyetësi i realizuar	105
Tabela 5 Si keni jetuar përpara sesa të dënoheshit?	106

Grafikoni 5 Si keni jetuar përpara sesa të dënoheshit.....	106
Tabela 6. Kanë qenë të mira marrëdhëniet me familjen/fëmijët/vëllezërit/motrat?	107
Grafiku 6. Kanë qenë të mira marrëdhëniet me familjen/fëmijët/vëllezërit/motrat?	107
Tabela 7. Ke qenë e dhunuar (fizikisht/psikologjikisht/seksualisht) përpara burgosjes nga burri ose të tjerë?.....	107
Grafikoni 7 Ke qenë e dhunuar (fizikisht/psikologjikisht/seksualisht) përpara burgosjes nga burri ose të tjerë?.....	108
Tabela 8. A ju sigurohet takimi, korrespondenca, bisedat telefonike me avokatët?	108
Grafikoni 8. A ju sigurohet takimi, korrespondenca, bisedat telefonike me avokatët?	108
Grafikoni 9. A është i mirë ushqimi në institucion	109
PËRFUNDIMI	109
BIBLIOGRAFIA.....	113
I -Libra.....	113
III- Ligje, Kushtetuta	116

FALËNDERIMET

Falënderoj të gjithë ata që kontribuan në përfundimin e këtij studimi, veçanërisht Zotin i cili më ka mbrojtur dhe më ka dhënë mundësinë që ta realizoj qëllimin tim. Gjithashtu unë nuk do të kisha patur mundësinë që ta kryej këtë disertacion pa udhëzimet e anëtarëve të komisionit, përkrahjes nga familja ime dhe ndihma që më është ofruar nga të afërmit dhe shoqëria ime.

Do të doja të shprehja mirënjohjen më të thellë për mentorin e tezës time të magistraturës Prof.dr.Ismail Zejneli cili ka qenë mentor i tezes që më ka udhëzuar dhe ndihmuar në këtë rrugëtim. Entuziazmi, kurajo, kujdesi dhe durimi i tij gjatë kësaj kohe për mua kanë qenë shumë profitabile. Ai ishte pozitiv, gjithmonë i gatshëm për t'iu përgjigjur pyetjeve të mia dhe nuk hezitonte të më udhëzonte drejt burimeve të duhura.

Unë ofroj vlerësimin më të lartë për durimin dhe korrigjimin e shkrimeve të mia sa herë që unë kisha nevojë. Përveç kësaj, unë falënderoj edhe të gjithë profesorët e mi të mëparshëm për mundin dhe përpjekjet e tyre që nga shkolla fillore e deri në studimet post-diplomike.

I jam shumë në borxh prindërve të mi të cilët dhanë mund dhe bënë shumë sakrifica për të arritur këtë sukses. Gjithashtu falënderim i veçantë shkon edhe për kolegët, shoqërinë, emrat e të cilëve nuk do të bëhen publike, por përpjekjet e tyre do të vlerësohen nga unë gjithmonë. I jam gjithashtu mirënjohëse administratave komunale dhe institucioneve publike të cilat aspak nuk hezituan për të më paisur me të dhëna në lidhje me çështjen time.

Përveç kësaj, kompletimi i këtij hulumtimi nuk do të kishte qenë i mundur pa përkrahjen e familjes time:, prindërve të mi, burrit tim, fëmijëve të mi, vëllaut tim si dhe të gjithë anëtarëve tjerë të familjes time. Ndihesha shumë komfort kur e dija se ata do të luteshin dhe do të më përkrahnin mua gjatë gjithë kësaj kohe. Kurajo që ata më jepnin mua kur ndonjëherë gjërat më përkeqësoheshin do të çmohen përgjithmonë nga ana ime.

I jam shumë në borxh për përkrahjen e tyre emocionale, morale, financiare si dhe për dashurinë dhe kujdesin ndaj meje. Ata meritojnë dashurinë e pastër dhe falemenderimin më të thellë.

QËLLIMET E HULUMTIMIT

Punimi mendohet të ketë një rëndësi të veçantë shkaku se përveç problemeve dhe sfidave që Ky punim synon të jetë një kontribut në fushën e së drejtës penale në Maqedonin e Veriut, sepse mund të shërbejë në plotësimin dhe ndryshimin e mangësive ligjore saj përket femrave dhe përdorimi i tyre në vepra penale.

Femrat si autore të veprave penale kanë qenë jashtë vëmendjes së studimeve kriminologjike deri në vitet '60 pasi i atribuoheshin rolet femërore për faktin se në atë kohë ato kryenin shumë më pak krime se burrat. Supozohet se femrat trajtohen më butë se burrat në sistemin e drejtësisë, kjo sepse krimet e tyre vijnë si pasojë e faktorëve të ndryshëm që i shtyjnë t'i kryejnë ato.

Çështja është se gratë nuk dënohen vetëm nga sistemi i drejtësisë por kanë edhe një dënim informal nga familja dhe opinionin shoqëror duke vuajtur kështu një dënim të dyfishtë, shpeshherë edhe të padrejtë.

Në shoqërinë tonë gratë dhe vajzat kryejnë vepra penale për shkak të faktorëve që i penalizojnë si faktorët ekonomik, psikologjik dhe social. Përfshirja e femrave në krim është një çështje që adresohet nga cdo shtet për shkak të rëndësisë që ka roli i saj në një shoqëri si grua, si nënë, si edukuese e brezave dhe mbrojtja e tyre nga veprimtaria kriminale dhe përfshirja në aktivitet kriminal është detyrë dhe përgjegjësi e cdo shteti dhe shoqërie.

Isabel Allende ka thënë: "The poorest and most backward societies are always those that put women down." Përfshirja e femrave në kriminalitet është rritur në Maqedoni, llojet dhe rrezikshmëria e veprave penale që ato kryejnë janë bërë më serioze, gjë që kërkon një adresim të ri në qasje dhe politikë.

Ky punim synon të evidentojë se cilët janë faktorët që i shtyjnë femrat të përfshihen në sjellje kriminale dhe si ndikojnë këto faktorë në kriminalitetin e tyre.

Gjithashtu ajo që është e rëndësishme të evidentohet është trajtimi që i bën legjislacioni ynë penal kësaj kategorie, marrja parasysh e nevojave të vecanta dhe mundësia e trajtimit të tyre konform këtyre nevojave. Dhe ajo që

është më e rëndësishme, punimi synon të propozojë zgjidhjet dhe mundësitë që procesi i integritetit të femrave në shoqëri të jetë sa më eficient.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Në këtë punim studimor do të shfrytëzohet një metodologji e tillë hulumtimi që nisat nga e përgjithshmja tek konkretja. Në radhë të parë jepen objektivat e përgjithshme dhe specifike se çfarë pretendohet të arrihet në këtë studim, metodat dhe teknikat që do të përdoren, të dhënat e përgjithshme dhe specifike të këtij studimi, analiza e tyre si dhe në fund interpretimi i rezultateve.

Rezultatet e gjetura nuk kanë për qëllim përgjithësimi. Në këtë punim do të analizojmë legjislacionet vendore dhe ndërkombëtare që flasin rreth femrave si subjekte të veprave penale.

Një ashtu do të përdoren Metodatat statistikore-përmes tabelave dhe grafikoneve do të jepen të dhëna relevante sasore për gjendjen e femrave si subjekte të veprave penale sipas legjislacionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe rrintegrimin e tyre në shoqëri.

Metodologjia e përdorur është ajo krahasuese siç përmenda edhe më lartë. Metodatat që janë përdorur përmendim metodën cilësore, analizuese, ku do të trajtohen format e krimit dhe sanksionet përkatëse, format e implementimit dhe sesi ka evoluar ky krim tek gjina femrore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Kosovë dhe Shqipëri.

Po ashtu si metodologjia përkatëse në punimin tim të magjistraturës do të jetë edhe analiza nga praktika gjygsore në Gjykatën Themelore të Tetovës rreth rasteve që janë paraqitur ku duket femra si subjekt i ndonjë veprave penale.

Po ashtu, do të marrim disa statistika rreth numri të femrave të kyqura në vepra penale për disa vite në RMV.

Ky studim u hartua dhe zbatua sipas një përjasjeje metodologjike të kombinuar:

- a) Rishikim dokumentacionesh e raportesh (desk research)
- b) Studim cilësor studim sasior.

Metodologjia e përdorur na jep mundësinë të kemi një kuptueshmëri më të thellë të gjendjes aktuale në aspektin e arsytimeve, perceptimeve, qëndrimeve dhe sjelljeve të komunitetit dhe aktorëve kryesorë dhe, në të njëjtën kohë, sasinë / volumin e këtyre rezultateve.

Metoda e përdorur për realizimin e studimit u hartua për të bërë të mundur përfshirjen e plotë në të, të të gjitha grupeve të pafavorizuara, marginalizuara, minoriteteve dhe grupeve etnike. Perspektiva gjinore është ruajtur dhe trajtuar plotësisht, sikurse edhe të gjitha format e diversitetit.

RËNDËSIA E PUNIMIT

Ky hulumtim shkencor ka rëndësi të madhe në vendin dhe kushtet të cilat në jetojmë sot. Ky punim do jetë një kontribut me interes timin që të marr gradën Magjistre e Diplomuar dhe audiencën të cilën do ta lexojnë në vazhdim që të njihen edhe më së shumti rreth çështjes së femrave si subjekt i veprës penale në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë dhe riintegrimin e tyre në shoqëri.

Po ashty ky punim është i rëndësishëm se hollë hollë do të analizohen edhe rekomandimet për Republikën e Maqedonisë së Veriut rreth mangësive ligjore dhe doktrinale si dhe përafrimin e legjislacionit tonë me atë të Shqipërisë dhe Kosovës.

1. HYRJE

Në kriminologji është pranuar përgjithësisht, teoritikisht dhe empirikisht parandalimin e përgjithshëm dhe arritjen e një suksesi të krimit në përgjithësi. (Арнаудовски, 2005)

Femrat si autore të veprave penale kanë qenë jashtë vëmendjes së studimeve kriminologjike deri në vitet '60 pasi i atribuoheshin rolet femërore për faktin se në atë kohë ato kryenin shumë më pak krime se burrat. Supozohet se femrat trajtohen më butë se burrat në sistemin e drejtësisë, kjo sepse krimet e tyre vijnë si pasojë e faktorëve të ndryshëm që i shtyjnë t'i kryejnë ato.

Cështja është se gratë nuk dënohen vetëm nga sistemi i drejtësisë por kanë edhe një dënim informal nga familja dhe opinionin shoqëror duke vuajtur kështu një dënim të dyfishtë, shpeshherë edhe të padrejtë.

Ky punim synon të jetë kontribut në fushën e të drejtës penale, në vendin tonë. Punimi ka një rëndësi të madhe shkak i sfidave dhe problemeve që ka e drejta penale në vendin tonë. Shpesh herë mendojmë se femra trajtohen më butë se burrat,

Qëllimi që ndërmora këtë punim qëndron në faktin se krimet që kryejnë femrat deri diku janë autore të veprave penale. Femrat trajtohen më butë se burrat ata dënohen edhe nga opinion shoqërorë.

Ky punim ka 4 kapituj ku do të analizohen format që përmbëjnë femrat si subjekte të veprave penale sipas legjislacionit të RMV-së si u bë njohur kjo situatë dhe nga mori shkas, si dhe si parashikohet në legjislacionin tonë ky subject për veprat penale.

Pyetjet kërkimore që synohet t'i japim përgjigje është:

Cili është përgjithësisht profili i grave të cilat janë në konflikt me ligjin dhe janë në kujdesin e institucioneve penale në Europë?

Qëllimi i këtij punimi është pikërisht evidentimin e cilëve faktorëve që i shtyjnë femrat në përfshirjen e sjelljes kriminale.

KREU I

1. Kuptimi (nacioni) i kriminalitetit

Kriminalistika te ne, rëndom kuptohet si shkencë e cila i studion, i hulumton dhe i përmirëson metodat, mjetet shkencore të mbështetura në përvojat praktike, të cilat janë më të përshtatshme për të zbuluar dhe për të

zbardhur veprat penale, të gjejë dhe të nxjerrë para sanksioneve penale kryerësin e tyre, të sigurohen dhe të fiksohen të gjitha provat për të përcaktuar të vërtetën objektive si dhe të pengohet kryerja e veprave penale të ardhshme të planifikuara dhe të paplanifikuara.¹

Me fjalë të tjera kjo është shkenca mbi teknikën, taktikën dhe metodikën rreth masave hulumtuese gjyqësore e të tjera, si dhe për pengimin e kriminalitetit.²

Është fakt se kriminaliteti i shkaktuar qoftë nga femrat apo nga meshkujt është dukuri negative shoqërore e cila nuk ka qenë dhe aktualisht nuk është immune në asnjë shoqëri pa marrë parasysh kohën e veprimit të saj dhe pa marrë parasysh rregullimin shoqëroro politik të saj. Edhe sot secila shoqëri njerëzore e organizuar në shtet nëpërmjet institucionet të ndryshme ndërmerr masa preventive me të cilat synon të pengojë kryerjen e veprave penale.³

Sjellja kriminale definohet si sjellje anti sociale, gjegjësisht sjellje që i shkel ligjet e miratuara dhe së këndejmi bartë edhe dënime të caktuara. Në të njëjtin kuptim duhet vështiruar edhe qëndrimin sipas të cilit krimi, juridikisht, definohet si “shkelje e ligjit penal, që do të thotë se asnjë vepër nuk është krim nëse nuk është ndaluar me normat penale”.⁴

Deri me tani nga shumë shkencëtar janë bërë shumë përpjekje teorike për definimin e kriminalitetit. Në këtë drejtim, dallojmë tri fusha të cilat në mënyrë të tërësishme studiojnë fenomenologjinë dhe esencën e kriminalitetit:⁵

- a) Pikëpamjet juridike,
- b) Sociologjike dhe
- c) Kriminologjike.

¹ Horvatiq, ZH., „Kriminologjia Elemntare“, -, Libri Shkollor“, Zagreb, 1993

² Shih, V. Vodineliq: Krininalistika, të gjitha botimet. Këtë përkufizim kriminalistët e ish shtetit jugosllav e kishin përkrahur në tërësi. Shih edhe tek B. Simonoviq, Kriminalistika, Kragujevac, 2004,3

³ Ismail Zejneli, E drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, 2017, fq.1

⁴ Horvatiq, ZH., „Kriminologjia Elemntare“, -, Libri Shkollor“, Zagreb, 1993

⁵ Krivokapiq, V.: „Preventiva e Kriminalitetit“– qasje teorike kriminalistike, FSHK, Sarajevë, 2006.

Definicioni juridik i kriminalitetit fillon nga norma e legjislacionit penal material. Ajo dallohet me theksimin e shkeljes së ligjit. Delikuent janë personat të cilët shkelin normat e ligjit penal me anë e të cilit janë të mbrojtura vlerat dhe interesat themelore shoqërore. Disa madje në mënyrë eksplicite pohojnë se vepër penale është ajo me sjellje të cilën e ndalon ligji gjegjësisht, pa ligj penal”nuk ka krim”.⁶

Janë bërë shumë përpjekje teorike për definimin e kriminalitetit. Në këtë drejtim, dallojmë tri fusha të cilat në mënyrë të tërësishme studiojnë fenomenologjinë dhe esencën e kësaj dukurie shoqërore. Këto janë pikëpamjet juridike, sociologjike dhe kriminologjike.

Definicioni juridik i kriminalitetit fillon nga norma e legjislacionit penal material. Ajo dallohet me theksimin e shkeljes së ligjit. Delikuent janë personat të cilët shkelin normat e ligjit penal me anë e të cilit janë të mbrojtura vlerat dhe interesat themelore shoqërore. Në këtë kuptim, shumë autorë, edhe e definojnë kriminalitetin.⁷

Sipas disave, krime janë “të bërat apo të pabërat e individit të cilat shoqëria e organizuar i ka ndaluar në një formë mjaftë serioze”. Pra sjellja kriminale definohet si sjellje anti sociale, gjegjësisht sjellje që i shkel ligjet e miratuara dhe së këndejmi bartë edhe dënime të caktuara.⁸

Në të njëjtin kuptim duhet vështruar edhe qëndrimin sipas të cilit krimi, juridikisht, definohet si “shkelje e ligjit penal, që do të thotë se asnjë vepër nuk është krim nëse nuk është ndaluar me normat penale”. Një numër i autorëve thekson se fenomeni kriminologjik në kuptimin juridik ekziston vetëm nëse ekzistojnë kushtet e parapara me ligj, gjegjësisht nëse veprimi është “i kundërt me rendin publik dhe “ekziston vetëm nëse ekzistojnë kushtet e parapara me ligj”.⁹

Definimi i këtillë juridik, sipas tyre, nga aspekti i të drejtës penale dhe sistemit ndëshkues në përgjithësi, është i domosdoshëm sepse fjala është për

⁶ Po aty

⁷ Krivokapiq, V.: „Preventiva e Kriminalitetit“– qasje teorike kriminalistike, FSHK, Sarajevë, 2006.

⁸ Krivokapiq, V.: „Preventiva e Kriminalitetit“, - „Akademia Policore“, Beograd, 2002.

⁹ Po aty

pasojat të cilat drejtpërdrejt i godasin njerëzit. Sipas këtij definicioni, është e domosdoshme që formalisht çdo veprë penale të përcaktohet në mënyrë precize ashtu që p.sh. gjyqtari të mos ketë mundësi të shumta për interpretime dhe arbitraritet në këtë fushë shumë të ndjeshme.¹⁰

Ndërkaq, ky definicion mbi kriminalitetin është i pamjaftueshëm dhe në esencë është formal dhe e redukton atë në këndvështrimin e nocionit juridik gjegjësisht në veprimtaritë të cilat janë të inkriminuara në ligjin pozitiv. Krahës kësaj, në literaturë, ky limitim penalo-juridik i kriminalitetit shpesh edhe stërmadhohet.

Duke u nisur nga ana e tij e rëndësishme dhe e pakontestueshme, disa autorë të së drejtës e hedhin çdo tentim definimi duke konsideruar definicionin juridik si më adekuatin dhe si të vetmin të mundshëm.¹¹

Që të mund të flitet për kriminalitetin duhet të arrihet deri tek praktika kriminale, gjegjësisht deri tek akti kriminal. Pra, kërkohen veprime apo mosveprime të caktuara që janë të inkriminuara në normat pozitive dhe vetëm atëherë mund të flitet për sjelljen kriminale.

Prandaj, të gjitha këto veprime (sjellje), të cilat në intervale të caktuara kohore rrezikojnë ndonjë person apo të mirën në kuptimin material dhe moral që i takon atij personi, organeve të ndryshme shoqërore dhe organizatave si dhe shoqërisë në tërësi, kurse janë të inkriminuara në normat penale juridike në fuqi të një vendi, në pikëpamje juridike trajtohen dhe konsiderohen si kriminalitet në atë hapësirë dhe kohë. Krahës definicionit juridik të kriminalitetit ekziston edhe mendimi sociologjik i cili e shpjegon sjelljen kriminale si produkt të jetës shoqërore në përgjithësi.¹²

Mirëpo, as ky mendim nuk është unik por, si i tillë, manifestohet në frymën e disa teorive sociologjike dhe është heterogjen. Sipas disa sociologëve kriminaliteti në kuptimin e gjerë paraqet aktin e një individi të cilin e gjykojnë anëtarët e grupit të cilit ai i përket. Pra dispozita e kriminalitetit është e varur

¹⁰ Po aty

¹¹ Krivokapiq, V.: „Preventiva e Kriminalitetit“, - „Akademia Policore“, Beograd, 2002.

¹² Pavishiq, B., Modly. D.: „Kriminalistika“, Fakulteti Juridik, Rijekë, 1999.

nga mendimi i grupit dhe vetëdija e tij etike dhe aksiologjike. Sjellje kriminale do të thotë sulm i personave të caktuar mbi vlerat e grupit të cilit ata i përkasin dhe me këtë fakt ata pushojnë të jenë besnik ndaj atij grupi.¹³

Duke e konsideruar fenomenin kriminal si realitet social dhe njerëzor disa sociolog dhe kriminolog theksin e tyre e vënë në antisocialen e cila mund të rrjedh nga vetë jeta dhe sjellja e individit në bazë të së cilës mund të gjykohet se ai herët a vonë mund të kryej vepër penale.

Pra mu në këtë qëndron edhe kuptimi i qasjes sociologjike në përcaktimin e nocionit të kriminalitetit. Kriminaliteti është ndodhi e hapur në jetën e individit prandaj për këtë arsye është ngushtë i lidhur për personalitetin e kryesit të veprimit të inkriminuar. Ai manifestohet me sjelljet dhe veprimet individuale të disa personave. Në këtë kuptim ai përbëhet nga tërësia e veprimeve të tilla inkriminuese të kryera në suazat e caktuara kohore dhe hapësinore.¹⁴

Prandaj, studimi i kriminalitetit, pa kurrfarë dyshimi, është ngushtë i lidhur me studimin e personalitetit të delikuentit, sikurse në procesin e formimit të tij në personalitet delikuent ashtu edhe në kohën e kryerjes së aktit të inkriminuar.¹⁵

Megjithatë, ekziston lidhje e ngushtë ndërmjet definimit juridik dhe sociologjik të kriminalitetit sepse kriminaliteti në të njëjtën kohë është kategori edhe juridike dhe sociologjike.

Pa njohjen e dispozitës formale juridike nuk do të mund të bëhej çdoherë dallimi ndërmjet kriminalitetit dhe formave tjera të sjelljes devijante, prandaj për këtë shkak edhe do të krijohet mundësia për dukurinë e arbitraritetit e cila nuk është e dobishme as në pikëpamje shkencore, as në pikëpamje praktike.

Sikurse edhe çdo disiplinë tjetër shkencore edhe politika e luftimit të kriminalitetit bazohet në parimet e caktuara. Kjo disiplinë përpiqet që strategjinë shoqërore të kundërvënies së kriminalitetit ta vendos në parimet e

¹³ Po aty

¹⁴ Po aty

¹⁵ Pavishiq, B., Modly. D.: „Kriminalistika“, Fakulteti Juridik, Rijekë, 1999.

caktuara të cilat nuk do të jenë ndërmjet veti kontradiktorë pa marrë para sysh se vetvetiu përmbajnë segmente të ndryshme të realitetit shoqërorë.¹⁶

Kjo larmi e segmenteve të realitetit shoqërorë pasqyrohet në atë se politika e luftimit të kriminalitetit i bashkon një varg të tërë pikëpamjesh të ndryshme dhe qëndrimesh mbi kriminalitetin duke filluar prej atyre të përgjithshme – filozofike dhe teorive sociale dhe vështirimit të problemit të kriminalitetit deri tek ato të cilat rezultojnë nga shkencat të cilat mëren me këtë problem si lëndë të tyre të hulumtimit, pra me tërë përmbajtjen e tyre.¹⁷

Për arsyet e përmendura siç do ta shohim në vazhdim shumë parime të politikës së luftimit të kriminalitetit janë të natyrës së përgjithshme, gjithëpërfshirëse, dhe paraqesin të arriturat unike të civilizimit njerëzor. Kështu që sot në literaturë mund të hasen parimet në vijim, mbi të cilat mbështetet qasja shkencore e luftimit të kriminalitetit, kurse me to paraprihet kjo discipline shkencore:

1. Parimi e shtetit juridik,
2. Parimi e ligjshmërisë (legalitetit),
3. Parimi i legjitimitetit,
4. Parimi i kufizimit të dhunës penalo-juridike,
5. Parimi i individualizimit,
6. Parimi i drejtësisë,
7. Parimi i humanitetit,
8. Parimi i politikës shkencore të luftimit të kriminalitetit.¹⁸

Duhet theksuar posaçërisht se disa nga këto parime janë nxjerr nga disiplinat tjera shkencore sidomos nga ato si motra me politikën e luftimit të kriminalitetit siç është e drejta penale, shkenca penitensiare etj. Këto janë p.sh. Parimi i individualizimit dhe parimi i kufizimit të dhunës penalo juridike.

Sipas autorit Ismail Zejneli ¹⁹kemi sqarimin e këtyrë parimeve një nga një. Koncepti themelore i së drejtës penale të RMV-së dhe esencën e institutive

¹⁶ Pease, K., „Crime Prevention, Oxford Handbook of Criminology“, Oxford, 1994.

¹⁷ Po aty

¹⁸ Pease, K., „Crime Prevention, Oxford Handbook of Criminology“, Oxford, 1994.

të saj e përcaktojnë mbi disa parime mbi të cilët është bazuar e drejta penale bashkëkohore. Me rëndësi parimore është parimi i ligjshmërisë nuk ka kryer vepër penale nuk ka dënim apo sanksion tjetër penalo-juridik pa ligj. Sipas Kodit Penal të RMV-së²⁰ askuj nuk mundi ti shqiptohet dënim ose ndonjë sanksion tjetër penal për vepër e cila para se të kryhet nuk ka qenë e caktuar me ligj apo me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e RMV-së.

Sipas qasjes legalo formale, parimi i ligjshmërisë shpjegohet mbi bazën e ndërlidhjeje në mes parimit të legalitetit dhe legjitimitetit: legjitime është cdo gjë që është legale.²¹ Nga pozitat e së drejtës positive, shteti e legjitimon lirinë absolute në përcaktimin e ndalesave juridiko-penale.²²

Po ashtu Ismail Zejneli na përcakton edhe parimin e drejtësisë i cili, na tregon se është tregues themelorë i idesë së përgjithshme për drejtësinë si ide kryesë të së drejtës penale, si dhe të kërkesës për legjitimitet të represionit penalo-juridik.

Përvec kërkesës së ligjshmërisë formale (legalitet) ligji penal duhet të jetë legjitim dhe i drejtës. Po ashtu autori Zejneli na thekson se drejtësi do të thotë barazi. Qasja e barabartë për secilin (cdo kënd) barazi të fakteve të pabarabarta.²³

Thelbi i parimit të legjitimitetit obligon që të gjitha kufizimet e lirisë dhe të drejtave të qytetarit të jenë të harmonizuara me zbatimin e masave preventive dhe procedurave, ndërsa në anën tjetër, represioni si komponentë e politikës kriminale të jetë i bazuar në masat e detyrimit, sepse do ta humb legjitimitetin nëse masat e tilla pushojnë të jenë oportune, gjegjësisht nëse bëhen të tepërta përballë efektit

¹⁹Ismajl Zejneli, Vlado Kambovski, E drejta Penale, pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018, fq.46

²⁰ Kodi Penal i RMV-së n:1 Kushtetuata e RMV-së n.14

²¹Shih, Kambovski, 6,207;DWORKIN, 172

²²Ismajl Zejneli, Vlado Kambovski, E drejta Penale, pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018, fq.41

²³Rosijskoe, Ugolovnoe pravo – obcaja, çasthhh, Pod – redakcieje, Ë.N.Kudrjjjjavceva I A.Ë.Naumova, Moskva, 2000

Në mënyrë të barabartë duhet të trajtohen të gjithë kryerësit e veprës penale të caktuar, por nëse veprat e tyre nuk janë të barabarta, edhe veprimi i barabartë nuk do të ishte veprim i drejtës.

Përmbajtjen e këtij parimi, e plotësojnë dy elemente:

1. Barazia para ligjit
2. Drejtësia e dënimit dhe sanksioneve të tjera penale-juridike.²⁴

Të tjerat janë pjesë e të arriturave të civilizimit të shoqërisë njerëzore, që u përmend edhe më lartë, siç janë sidomos; parimi i shtetit juridik dhe parimi i legalitetit. Në anën tjetër, disa parime janë atribut vetëm i politikës së luftimit të kriminalitetit dhe në pikëpamje burimore janë të lidhura vetëm për këtë disiplinë shkencore. E tillë në rend të parë është politika shkencore e luftimit të kriminalitetit.²⁵

Duhet të kihet parasysh se parimi i shtetit juridik është i karakterit të dyfishtë. Në njërën anë ky e obligon shtetin dhe institucionet e tij që të veprojnë në pajtim me të drejtën dhe normat ligjore, kurse në anën tjetër, obligon secilin prej nesh që individualisht, gjithashtu, të veprojmë njësoj sipas ligjit. Ky parim si i tillë në formën juridike dhe politike të çdo shteti dhe në përgjithësi të çdo sistemi në të cilin merr pjesë individ edhe si anëtarë edhe si individ i bashkësisë është i pa shmangshëm. Vetë koncepti i shtetit juridik siç definohet shpesh përmbajtja e tij është koncept i individit të lirë, qytetarit, njeriut dhe pjesëmarrjes së tij të lirë në jetën politike.²⁶

Ky parim siç u konstatua nënkupton se çdo aktivitet që ka për qëllim luftimin e kriminalitetit duhet ndërmarr në pajtim me normat ligjore të cilat kanë të bëjnë me aktivitetet e tilla, apo me fjalë tjera çdo aktivitet në këtë fushë duhet domosdo ta ketë bazën në ligj dhe në normat tjera juridike, të cilat janë në suazat e asaj materie.

Siç u tha, shteti juridik nuk nënkupton vetëm abstenimin e shtetit nga kërkesat e tepruara ndaj lirisë qytetare, por gjithashtu edhe imperativin e

²⁴ V, Kambovski, vepra e cit.

²⁵ Radulović, Lj.: „Politika Kriminale-Politikë e Pengimit të Kriminalitetit“, Fakulteti Juridik, Beograd, 1999.

²⁶ Po aty

aktiviteteve të tij, gjegjësisht veprimin pozitiv me qëllim të mbrojtjes efikase të atyre lirive, ose mbrojtjen e kufijve, të cilët i vendos shteti juridik për liri sa më të madhe të qytetarëve të vet, që njëherazi kanë edhe “limituesin e vet me rastin e veprimit të ashtuquajturit “shtet social të cilin duhet kuptuar si personifikim të parimit të shtetit juridik.”²⁷

Konsiderohet se tradita klasike evropiane e shtetit juridik duhet të bazohet në premisat si vijon.

- b) Shteti kushtetues,
- c) Pluralizmi politik,
- d) Monopoli i dhunës,
- e) Komunikimi pozitiv ndërmjet shtetit dhe opinionit publik (i ashtuquajturi funksion i kontrollit të opinionit publik),
- f) Racionalizimi i pushtetit shtetëror,
- g) Mbrojtja e interesave të individit nga dhuna e shtetit dhe garantimi i tyre me kontroll të pavarur gjyqësor.

Ideja e shtetit juridik nënkupton grup normash të së drejtës, të cilat e disiplinojnë përdorimin e dhunës dhe në raport me forcën e dhunës pasqyrojnë objektin e rregullimit, e cila i ka katër detyra të posaçme si vijon:²⁸

- a) Të përcaktojë kushtet nën të cilat forca e detyrimit duhet ose mund të zbatohet,
- b) Të përcaktojë personat të cilët duhet dhe mund ta zbatojnë;
- c) Të përcaktojë procedurën sipas së cilës duhet të zbatohet në rrethana të caktuara dhe nga personat e caktuar;
- d) Të përcaktojë masën e forcës me të cilën duhet dhe mund të disponojë ai i cili duke respektuar procedurat e caktuara është i detyruar që në rrethanat e caktuara ta zbatojë forcën e detyrimit. Me fjalë tjera e drejta është një grup normash të cilat rregullojnë atë se kur, kush, si dhe sa e zbaton forcën e detyrimit.

²⁷ Radulović, Lj.: „Politika Kriminalne-Politikë e Pengimit të Kriminalitetit“, Fakulteti Juridik, Beograd, 1999.

²⁸ Po aty

Parimi i shtetit juridik njëkohësisht është edhe postulati më i rëndësishëm politiko-juridik i ndëshkimit bashkëkohor dhe i dënimit, gjegjësisht i politikës së luftimit të kriminalitetit.²⁹

Parimi i ligjshmërisë është njeri ndër të arriturave më të mëdha të zhvillimit civilizues të njerëzimit. Në kuptimin e tij burimor ky parim nënkupton respektimin strikt të ligjit si nga ana e shtetit ashtu edhe nga ana e qytetarëve. Në këtë kuptim parimi i shtetit juridik dhe parimi i ligjshmërisë janë në lidhje të ngushtë mes veti.³⁰

Parimi i ligjshmërisë nënkupton se çdo aktivitet i cili ka për qëllim kundërvënien ndaj kriminalitetit duhet ndërmarr në pajtim me normat ligjore të cilat kanë të bëjnë me aktivitetin e tillë, apo me fjalë tjera që çdo aktivitet në atë fushë duhet ta ketë bazën në ligj dhe në normat tjera juridike në suaza të kornizës së kësaj materie. Për politikën e luftimit të kriminalitetit ky parim është i rëndësishëm së jashtëzakonshme meqenëse, ndër të tjera, kërkon përcaktimin paraprak me ligj të veprës penale dhe të sanksionit penalo-juridik.

Dimensioni juridik i parimit të ligjshmërisë supozon se në planin legjislativ janë respektuar këto kërkesa:³¹

1. Që burim i të drejtës penale të jetë vetëm ligji
2. Që të jetë e ndaluar analogia
3. Që të jetë i ndaluar funksioni retroaktiv i ligjit penal
4. Që të jenë të formuluar qartë dhe në mënyrë precize normat penalo-juridike
5. Që sanksionet penale mund të jenë të përcaktuara vetëm me ligj.

Në sferën e politikës së luftimit të kriminalitetit, ky parim në të vërtetë nënkupton që masat e dhunës penalo-juridike të bazuara në ligj të zbatohen vetëm atëherë kur kjo është e domosdoshme dhe vetëm në masën e domosdoshme. Përcjellës i pashmangshëm i ligjshmërisë është legjitimiteti, dhe

²⁹ Po aty

³⁰ Po aty

³¹ Siegel, J.L., „Criminology“, Thomson Learning, London, 2006

me fjalë tjera ky nënkupton arsyeshmërinë e cilitdo vendim juridik të paraqitur në normën ligjore.³²

i cili dëshirohet të arrihet me to, sidomos nëse efekti i tillë nuk realizohet me anë të tyre .³³

Parimi i kufizimit të dhunës penalo juridike është në lidhje të ngushtë me parimin e legjitimitetin dhe ligjshmërisë. Në të vërtetë, në njërën anë zbatimi i detyrimit penalo juridik mund të jetë i parashikuar dhe i lejuar vetëm me ligj, kurse në anën tjetër, të njëjtat vendime ligjore me të cilat lejohet detyrimi penalo juridik duhet domosdo të jenë të arsyetuara nga pikëpamja e gjerë shoqërore civilizuese.

Ky parim i politikës së luftimit të kriminalitetit nënkupton:

- a) Zbatimin e detyrimit penalo juridik vetëm ndaj asaj sjelljeje e cila është aq e dëmshme për vlerat e mbrojtura me kushtetutë saqë mbrojtja e tyre nuk mund të realizohet pa forcën e tillë.
- b) Kufizimin për shkak të përmasave të sanksioneve penalo-juridike dhe për shkak të peshës së veprës penale.
- c) Kufizimin e përmbajtjes së sanksioneve penalo-juridike dhe mënyrës së zbatimit të tyre ndaj kryesit të veprës penale vetëm në masën e cila i përgjigjet llojit të sanksionit penalo-juridik dhe qëllimit të tij të posaçëm.
- d) Kufizimin në suaza të fajësisë dhe kohës së kryesit.
- e) Kufizimin e detyrimit penalo-juridik vetëm në suaza të kryesit të veprës penale.³⁴

Thelbi i individualizimit të sanksioneve penalo-juridike siç u cek më herët gjendët në harmonizimin e detyrimit penalo-juridik, në mënyrë që ndaj veçorive të kryesit të veprës penale të arrihet qëllimi special preventiv i sanksionit penalo-juridik ashtu që sanksioni ndaj kryesit të ndikojë që ai të mos i përsëritë veprat penale dhe që ta respektojë sistemin juridik.

³² Po aty

³³ Po aty

³⁴ Siegel, J.L., „Criminology“, Thomson Learning, London, 2006

Të themi edhe këtë se pa qasje individuale në zbatimin e dhunës penalojuridike do të ishte shumë vështirë të paramendohet koncepti bashkëkohor i krijimit të politikës së luftimit të kriminalitetit. Parimi i individualizimit, si njeri ndër të arriturat e mëdha shekullore të zhvillimit të kriminologjisë dhe të mendimit penologjik dhe të kalimit nëpër shumë aspekte të deritashme të fazave të gabueshme në koncipimin e qasjes në trekëndëshin vepër penale-kryes-sanksion penal, është shumë i rëndësishëm si segment i pikëpamjes bashkëkohore mbi kriminalitetin.³⁵

Në kuadër të politikës penale-juridike, parimi i individualizimit shfaqet në tri nivele:

1. Nivelin ligjvënës, përmes krijimit të dispozitave normative për remizimin e këtij parimi duke forcuar konceptin e pluralizmit të sanksioneve penale dhe duke definuar kushtet e posaçme të përcaktimit të sanksioneve;
2. Nivelin e politikës ndëshkimore të gjykatave në procedurën e përcaktimit të sanksioneve penale përmes përzgjedhjes së sanksionit të harmonizuar, jo vetëm me karakteristikat e veprës konkrete penale, por edhe me veçoritë e kryesit të veprës;
3. Procedurën e ekzekutimit të sanksionit penal përmes përshtatjes së mënyrës së ekzekutimit të sanksionit, personit të gjykuar, por edhe duke respektuar karakteristikat e veprës së kryer penale.

Drejtësia është njëra ndër postulatet themelore të procedurës penale bashkëkohore dhe kërkesë në të cilën kohët e fundit po insistohet me të madhe si në suaza të legjislacionit kombëtar ashtu edhe në planin ndërkombëtar. Insistimi në drejtësi ngërthen në vete të gjitha sistemet juridike bashkëkohore sidomos në pjesën e procedurës juridike, e cila nënkupton kufizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.³⁶

Kjo në rend të parë ka të bëjë me procedure penale-juridike dhe zbatimin e dhunës penale juridike. Konsiderohet se zbatimit i drejtë i dhunës penale-

³⁵ Po aty

³⁶ Lazareviq, L.J.: „Judikatura Penale si Bazë për Konstituimin e Politikës së Luftimit të Kriminalitetit“, „Informatori Juridik“, nr. 10, „Intermex“, Beograd, 2003

juridike arrihet me përzgjedhjen e mjeteve të tilla të dhunës penale juridike, të cilat i përgjigjen rrezikut të veprës penale e në funksion të mbrojtjes së vlerave kushtetuese për ç'arsye është i domosdoshëm zbatimi i asaj dhune në proporcion me peshën e veprës penale, dhunën penalo-juridike dhe aplikimi i saj vetëm ndaj personit i cili ka krye vepër penale dhe pikërisht vepër të atij lloji që kërkon masën dhe llojin e tillë të sanksionit penalo juridik i cili do të mundësojë arritjen e qëllimit të sanksioneve penalo-juridike qofshin të përgjithshme apo të veçanta, pra me individualizimin i cili nuk e ka për qëllim ta tregojë forcën e shtetit por realizimin e qëllimit të pjesës dërmuese të anëtareve të bashkësisë shtetërore, që të gjithë ta respektojnë rendin juridik dhe të mos kryejnë vepra penale.

Kërkesa për humanitet në kuadër të procedurës penale nuk është e kohës së sotme ndonëse kjo ka ardhur në shprehje të plotë vetëm në gjysmën e dytë të shek. XX kur respektimi i dinjitetit njerëzor dhe ndalimi i sjelljeve antihumane ishin bërë objekt normativ i shumë dokumenteve ndërkombëtare dhe pjesë përbërëse e dispozitave kushtetuese të shteteve demokratike të kohës.³⁷

Nga pikëpamja e politikës së luftimit të kriminalitetit zbatimi i parimit human ka karakter të dyfishtë. Parimi i humanitetit në kuadër të politikës së luftimit të kriminalitetit përmban kërkesën për sjellje njerëzore (humane) si në pikëpamje të përmbajtjes së detyrimit penalo-juridik, ashtu edhe në pikëpamje të aplikimit të dhunës.

Ky parim kërkon që ndaj të dyshuarit, të akuzuarit dhe të gjykuarit të veprohet në mënyrën e cila nuk e rrezikon dinjitetin njerëzor dhe e cila në masë të plotë e mbron integritetin psiko-fizik dhe shëndetin e personave në fjalë. Imperativi i veprimit human është e domosdoshme të jetë i zbatuar pa marrë parasysh peshën dhe pasojat e sjelljes së dënueshme.

Kur janë në pyetje masat preventive në luftimin e kriminalitetit theksohet fakti se kriminaliteti paraqet atak shumë agresiv në të mirat dhe vlerat

³⁷ Po aty

njerëzore, por kjo megjithatë nuk e arsyeton aplikimin e dhunës, gjegjësisht çfarëdo agresiviteti. Në anën tjetër në aplikimin e masave represive gjatë luftimit të kriminalitetit rendi juridik parasheh dhe lejon forma të caktuara të kufizimit të këtyre lirive dhe të drejtave të njeriut.

Nuk thuhet pa arsye se qasja kriminale-politike dhe penale-juridike e fenomenit të kriminalitetit në pjesën e saj të doktrinës dhe praktikës, sot, duhet të jetë tepër e sofistikuar, sinkronizuar, komplementare dhe konzistente në të gjitha pjesët e saj por edhe si tërësi.³⁸

Pikërisht duke e zhvilluar veprimtarinë e vetë shkencore dhe duke u shërbyer me rezultateve e përpjekjeve të shkencave tjera dhe me të arriturat e tyre në këtë fushë, politika e luftimit të kriminalitetit sot duhet të ofrojë zgjidhje të bazuara shkencore në pasqyrimin e këtij fenomeni dhe të propozojë masa të përshtatshme për aktivitet konkret të shoqërisë në luftimin e tij. Ky parim, së drejti, përmban kërkesën për profilizimin e politikës së luftimit të kriminalitetit si disiplinë shkencore.

Për ta fituar statusin shkencor, çdo disiplinë është e domosdoshme ta ketë lëndën e saj të studimit dhe qëllimin e hulumtimit si dhe metodat e veta të studimit.

Politika bashkëkohore e luftimit të kriminalitetit këtë e posedon sot pa kurrfarë dyshimi. Shikuar në prizmin e zhvillimit historik, mund të konstatohet se kjo disiplinë, në periudhat e ndryshme kohore, ka pasur statute të ndryshme në grupin e disiplinave, të cilat janë marrë me problematiken e kriminalitetit dhe me sjelljet që ishin të dënueshme.³⁹

Parimet e politikës së luftimit të kriminalitetit të cilat kemi pasur rastin t'i analizojmë në këtë punim, na sigurojnë se kjo disiplinë në qasjen ndaj lëndës së saj shkencore gjithmonë është në rrugë të drejtë, në rrugë ligjore, humane dhe shkencore të luftimit të problemit të kriminalitetit sot dhe sugjeron forma të tilla të masave preventive dhe represive përballë sjelljeve të

³⁸ Eliot, M., „ Krimi në Shoqëritë Bashkëkohore“, Sarajevë, 1962

³⁹ Po aty

dënueshme, të cilat në asnjë aspekt nuk do të pasqyrojnë zgjidhje të papranueshme për shoqërinë e civilizuar.⁴⁰

Janë bërë shumë përpjekje teorike për definimin e kriminalitetit. Në këtë drejtim, dallojmë tri fusha të cilat në mënyrë të tërësishme studiojnë fenomenologjinë dhe esencën e kësaj dukurie shoqërore. Këto janë pikëpamjet juridike, sociologjike dhe kriminologjike. Definicioni juridik i kriminalitetit fillon nga norma e legjislacionit penal material.

Ajo dallohet me theksimin e shkeljes së ligjit. Delikuent janë personat të cilët shkelin normat e ligjit penal me anë e të cilit janë të mbrojtura vlerat dhe interesat themelore shoqërore. Në këtë kuptim, shumë autorë, edhe e definojnë kriminalitetin.

Sipas disave, krime janë “të bërat apo të pabërat e individit të cilat shoqëria e organizuar i ka ndaluar në një formë mjaftë serioze”. Pra sjellja kriminale definohet si sjellje anti sociale, gjegjësisht sjellje që i shkel ligjet e miratuara dhe së këndejmi bartë edhe dënime të caktuara. Në të njëjtin kuptim duhet vështruar edhe qëndrimin sipas të cilit krimi, juridikisht, definohet si “shkelje e ligjit penal, që do të thotë se asnjë vepër nuk është krim nëse nuk është ndaluar me normat penale”.

1.1. Femrat si subjekt i veprës penale në RMV

Vepra penale e kryer nga femrat është kategori qendërore në sistemin e së drejtës penale. Ajo legjitimon të drejtën e ndëshkimit dhe e përcakton hapësirën e represionit penal-juridik kurse nga nocioni i tij nxirren dhe kategoritë tjera themelore, përgjegjësia penale dhe dënimi.

Konventa e Stambollit i përkufizoi disa terme kyçe në të cilat bazohet akti: dhunën ndaj grave, dhunën në familje, gjininë, dhunën e bazuar gjinore viktimën dhe gratë. Me qëllim që të zhvillohet dhe të përpunohet strategji

⁴⁰ Po aty

përkatëse për zbatimin e dispozitave të Konventës së Stambollit në Maqedoninë e Veriut, duhet të vlerësohet mënyra në të cilën do të rregullohen termet dhe konceptet që i definon ajo.

Çështja e dhunës ndaj grave ishte rregulluar në bazë të ligjeve të ndryshme dhe akteve nënligjore, veçanërisht në kuadër të Ligjit për familjen, ndërsa dhunën në shtëpi apo në familje deri më tani legjislatura e Maqedonisë e rregullonte me akt të veçantë në Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen e dhunës në familje (LPMDHF).⁴¹ i miratuar në vitin 2014.

Ky ligj i njohu termat gjini dhe dhunë të bazuar gjinore, por edhe krahas përkufizimit, nuk përdorej me to. Dhuna shtëpiake (në familje) në fillim ishte përkufizuar si dhunë në marrëdhënie familjare dhe martesore, ndërsa më pas u elaborua në kornizë të plotë politike dhe juridike e cila e përbën Strategjinë kombëtare për parandalin nga dhuna në shtëpi⁴² e cila ka për qëllim të vendosë sistem efektiv të mbrojtjes dhe parandalimit nga dhuna në shtëpi dhe

Ligj për parandalim dhe mbrojtje nga dhuna në familje ⁴³ me të cilin u parapa kriminalizimi i dhunës në shtëpi dhe vendosi protokollre sipas të cilave vepron policia, punëtorët shëndetësorë dhe socialë në rastet e dhunës në familje. Pasi trajtuam pjesë ku flitet për femrat si objekt i veprave penale do të theksojmë në këtë pjesë edhe femrat si subject të veprave penale. Femra nuk mund të jetë subjekt i vepres, por ajo mund të jetë vetëm bashkpuntore, ndihmëse apo shtytëse.⁴⁴

Sipas Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë, neni 1 i Kodit Penal flet se askush nuk mund të dënohet me një vepër penale, ose më një vepër të kryer pa

⁴¹Ligji për Parandalim dhe Mbrojtje nga Dhuna në Familje (LPMDHF), në dispozicion në <http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/Zakon%20za%20prevencija%20semejno.pdf>

⁴²Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje, në dispozicion në: http://www.semejnonasilstvo.org.mk/Root/mak/_docs/Nacionalna_strategija_za_zashtita_od_semejno_nasilstvo.pdf

⁴³ Ligji për parandalim, ndalesë dhe mbrojtje nga dhuna në familje, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.138/2014, 33/2015, 150/2015 në dispozicion në: <http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/zakoni/Zakon%20za%20prevencija%20semejno.pdf>

⁴⁴ Kodi Penal i RM-së, "Gazeta Zyrtare e RM"-së nr. 37/96, 80/99, 48/01, 4/02, 16/02, 43/03, 19/04, 81/05, 50/06, 60/06, 73/06, 7/08, 139/08, 114/09, 51/11, 135/11, 142/12 dhe 166/120

u paraparë më ligj ose tractate ndërkombëtarë të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën e RMV-së.

Po ashtu sipas nenin nr.2 përgatitja e veprës penale mund të përcaktohet me ligj si vepër e vecantë penale ose ligji mund të përcaktojë dënimin për përgatitjen e veprës së caktuar penale. Femra në RMV si autore ose viktimë e veprës penale. Veprat penale në përgjithësi kryehen edhe nga femrat edhe nga meshkujt. Sipas qasjes të ekspozuar formale-materiale dhe objective-subjektive strukturën e nocionit të veprës penale e përbëjnë këto elemente, për të thënë se një vepër është kryer duhet ti plotësojë disa kushte, veprimi, përcaktueshmëria në ligj, kundërligjshmëria, faji dhe dënueshmëria.

Personi që kryen vepër penale (në rastin tonë femra) quhet subject i veprës penale kryes i veprës penale cdoherë është person fizik kurse nën kushte të caktuara edhe person juridik.⁴⁵

Po ashtu theksohet se me novelën e KPM-së të viti 2004, është paraparë përgjegjësia penale dhe për personat juridik dhe system të posacëm të sanksioneve penale.

Sociologët arsyetojnë se prezenca e dhunës në familjen shqiptare është e lidhur edhe me faktin se akoma jemi në një periudhë tranzitore ku familja vazhdon të jetë autoritariste, piramidë e ndërtuar mbi pushtete të mbivendosura dhe në njëfarë mënyre kemi akoma shfaqje të sundimit të mashkullit mbi femrën si një autoritet vertikal. Sipas Kodit Penal të RMV-s neni 122 paragrafi viktimë e veprës penale është secili persona që ka pësuar dëm, duke përfshirë dëmtimin fizik ose psikik dëmim emocional, humbjen material ose dëmtim tjetër ose rrezikim të të drejtave themelore të njeriut si pasojë e kryerjes së veprës penale – definicion i cili konsiderohet edhe si nocion më i ngushtë për viktimën.⁴⁶

Dallimi i nocionit viktime (në rastin tonë femra) është relevante në rastet kur statusi i të dëmtuarit nuk nënkupton edhe status të viktimës në kuptim më të ngushtë ashtu p.sh nëse gjatë kryerjes së vrasjes me aktivizimin e

⁴⁵Ismajl Zejneli, Vlado Kambovski, E drejta Penale, pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018, fq.85

⁴⁶Ismajl Zejneli, Vlado Kambovski, E drejta Penale, pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018, fq.86

bombës është shkaktuar dëm i sendeve pronari i sendeve merr statusin e të dëmtuarit edhe pse vetë dëmtimi i sendeve nuk dënohet për arsye se si vepër sekondare është konsumuar nga vepra kryesore.

Femrat në RMV si popull që në gjenezën e tyre kanë treguar një karakter maskilist që fillon që në ngjizjen e një fëmije e deri në fund të jetës së tij. Përgjithësisht, aktorët e dhunës dhe krimin janë meshkujt e familjes shqiptare.

Babai vret vajzën, djali vret babain, djali vret nënën, burri vret gruan, ama rastet kur nëna vret fëmijën janë shumë të rralla. Problematik dhe në tendencë rritjeje është rasti kur gruaja vret burrin. Shumica e këtyre femrave që janë autore të një krimi të tillë janë viktima të një dhune sistematike psikologjike dhe fizike ndaj tyre dhe fëmijëve, të shtrirë në periudha të gjata kohore.⁴⁷

Ky argument nuk shërben për të shfajësuar autorin e një veprë penale, i cfarëdo kategorizimi qoftë gjinor, racor, ekonomik a social është ai, por për të kuptuar që për t'u trajtuar si të barabartë përpara ligjit, para së gjithash duhet t'i ofrohen kushte të gjithëve për të qenë të barabartë.

“Krimi në familje” po shndërrohet në një gangrenë të shoqërisë tonë dhe niveli e tipologjia e tij, mënyra e realizimit dhe intensiteti me të cilin po shfaqet cënon interesat e shoqërisë dhe pengon rritjen dhe zhvillimin e një shoqërie të shëndetshme e shteti të konsoliduar.⁴⁸

Nëse do merrnim në konsideratë anën subjektive apo motivet që shtyjnë një femër të përfshihet në kriminalitet, e drejta penale mban një qëndrim të ftohtë dhe të prerë. Pra, një femër kryen një krim në familje dhe meriton një dënim të parashikuar në Kodin Penal për veprën penale konkrete, pavarësisht nëse krimi është kryer në kushtet e një vështirësie ekonomike apo për t'i dhënë fund vuajtjeve dhe dhunës periodike që mund të jetë ushtruar mbi të. Ajo do të vuajë dënimin e përcaktuar nga ligji pavarësisht nëse ishte në kushtet e

⁴⁷ Bloom, B., & O'Leary, B., & Covington, S., (2003). Strategjitë e ndjeshme gjinore: kërkime, praktika dhe drejtim, parimet për gratë e privuara nga liria. Uashington, D. C.: Departamenti i Drejtësisë, Instituti Kombëtar i Korrektimeve.

⁴⁸ Administrimi i institucioneve sociale në sistemin e drejtësisë fq.14, qasje aktuale : https://myla.org.mk/wp-content/uploads/2020/03/STUDIJA_Pristap-do-Pravda_A4_ALB_ËEB.pdf

tronditjes së fortë psikike apo jo, faji ishte direkt apo indirekt, ekziston elementi i dashjes apo jo.

Në gjykimin tim, pavarësisht se gjykata e quan atë fajtores dhe me të drejtë sepse i referohet normave të së drejtës penale, nëfund femra në RMV del viktimë e një fajtori më të madh që nuk merr dënim siç është shoqëria ku jetojmë.

1.2. Femrat si viktima te veprës penale

Lidhur me termin kryesor viktima, mund të thuhet se rregullohet në sistemin juridik të Maqedonisë dhe në Kodin Penal me ndryshimet dhe plotësimet në vitin 2013. Neni 122⁴⁹termin „viktimë“ e përkufizon si çdo person i cili ka pësuar humbje apo dëm, duke e përfshirë edhe lëndimin fizik apo mental, vuajtjen emocionale, humbjen materiale, si edhe çdo rrezikim apo kanosje për të drejtat e saj apo të tij dhe që rezulton me vepër penale. Me këtë Kodi Penal bën dallimin midis viktimave dhe palëve të dëmtuara.

Viktimat në procedurë i kanë të drejtat e tyre, si për shembull: të drejtën e informimit, mbrojtjen, ndihmën, kujdesin dhe mbështetjen, kompensimin dhe ndërmjetësimin. Sipas prof. Stojanka Mirçeva, me ndryshimin e Ligjit „viktimat e dhunës së bazuar gjinore fituan qasje drejt më shumë instrumenteve juridike në procedurën penale“⁵⁰

Në mënyrë plotësuese, në nenin 53 të Ligjit për Procedurë Penale²⁸ janë përcaktuar të drejtat kryesore të viktimave, në mesin e të cilave e drejta e të dëmtuarit në procedurë që i mundësohet të marrë pjesë në përndjekje apo kërkesën për kompensimin e dëmit, kujdes i veçantë dhe mbrojtje , mbrojtje

⁴⁹ Neni 122, paragrafi 22 i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e RM-së numër 80/99, numër 4/2002, numër 43/2003, numër 19/2004, numër 81/2005, numër 60/06, numër 73/06, numër 7/08, numër 139/08, numër 114/09, numër 51/11, numër 135/11 , 185/11, numër 142/12, numër 166/12, numër 55/13, numër 82/13, numër 14/14, numër 27/14, numër 28/14, numër 115/14 dhe numër 132/14

⁵⁰ Stojanka Mirçeva, Bogdanço Gogov: Analizë e harmonizimit të legjislaturës së Republikës së Maqedonisë së Veriut me Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje: (Konventa e Stambollit): studim bazik – Shkup 2013: Lidhja e organizatave të grave të Republikës së Maqedonisë

nga gjykata, e drejta e ndihmës psikologjike dhe ndihmës tjetër profesionale, si edhe mbështetje prej institucioneve relevante etj.

Sipas paragrafit 2, është e rëndësishme viktimat t'i gëzojnë të drejtat e tyre, ndërsa policia, prokuroria dhe gjykata kanë obligim ligjor ta njoftojnë viktimën për të drejtat e veta, si edhe të veprojnë në interes të saj në vendimmarrje për përndjekjen e të akuzuarit.

Ky veprim fillon menjëherë sapo viktimat ta bëjnë kontaktin e parë me sistemin juridik dhe gjyqësor, të cilët zakonisht janë policia, pastaj edhe Qendrat për punë sociale. Megjithatë, të dhënat primare prej diskutimeve në fokus grupe tregojnë se Qendrat për punë sociale zakonisht nuk shtrojnë procedura ligjore (aktakuza) para gjykatave kundër autorëve, ndërsa një prej shkaqeve është bara financiare, taksat administrative të cilat duhet t'i paguajnë, edhe pse shuma nuk është aq e madhe që të paraqesë barë serioze financiare për institucionet.⁵¹

Në interes të mbrojtjes së të drejtave të viktimave është policia të bëjë raport nga vendi i ngjarjes kur ka ndodhur dhuna. Por, sipas avokatëve, lihet anash për arsye se mbrojtësit juridik janë të pamundësuar të shtrojnë aktakuza në gjykatë për shkak të mungesë së dëshmisë, në këtë rast, raportit policor.

Të drejtat e viktimave në procedurë rrezikohen edhe prej mungesës së vetëdijes dhe njohurive tek gjykatësit, veçanërisht gjykatësit meshkuj, të cilët nuk e shohin në mënyrë objektive dhunën në familje apo atë gjinore ndaj grave, në vend se t'i zbatojnë procedurat ligjore në mënyrë të paanshme dhe sipas rregullave gjyqësore, ata shpesh angazhohen të ndërmjetësojnë në procesin e pajtimit midis partnerëve dhe këshillimin e viktimës të kthehet në shtëpi me autorin.⁵²

Në këtë kuptim nevojitet ndërtim i kapaciteteve të institucioneve për zbatimin e të drejtave të viktimave por edhe në përgjithësi për ngritjen e

⁵¹ Neni 53 i Ligjit penal, Gazeta zyrtare e RM-së numër 150/2010

⁵² Diskutim në fokus grupin e mbajtur më 17.07.2018, i cili përbëhej prej përfaqësuesve dhe avokatëve të viktimave, të cilët i theksuan mangësitë në sistem kur bëhet fjalë për mbrojtjen e viktimave dhe sigurimi i ndihmës për ta është përndjekje penale e autorit

vetëdijes për Konventën e Stambollit që të mundësojnë zbatimin, por edhe t'i referohen Konventës gjatë interpretimit të legjislaturës kombëtare në pajtim me Konventën.⁵³ Me emancipimin dhe kyçjen gjithnjë më të madhe të femrës në të gjitha sferat e jetës dhe të punës vërehet edhe shtimi dhe rritja e pjesëmarrjes së saj në aktivitetet kriminale, kontribut të madhe në lidhje me këto shënime ka dhe autorja Freda Adler.

Përfshirja e femrave në veprimtari kriminale është kthyer në një problem social më së shumti gjatë viteve të fundit, por ajo që vihet re është një mungesë e të dhënave të mirëfillta mbi tendencat e kriminalitetit femëror, nga ana e institucioneve që merren me rritjen e kriminalitetit.

Nga burimet zyrtare ka pak të dhëna në lidhje me kriminalitetin e femrave dhe mungojnë të dhëna lidhur me statusin, përgjegjësinë prindërore, faktin nëse janë autore apo viktima, punësimi i tyre, historia familjare etj. Ekzistojnë disa faktorë të rëndësishëm si ekonomik, social, psikologjik, të cilët bëhen shkaktarë të këtij fenomeni me tendenca rritjeje.

Kodi Penal dhe legjislatura tjetër tërësisht janë të verbra lidhur me termin gjini. Përveç përkufizimit të gjinisë si bazë për diskriminimin, gjinia nuk është aspak e rregulluar as me Kodin Penal, e as me Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna familjare. Mosnjohja e gjinisë pamundëson që të njihen rrethanat dhe gjeneza e dhunës ndaj grave që del prej roleve gjinore. Akoma më shumë, Kodi Penal është tërësisht i verbër për gratë.

Kodi përdor terma në denominimin e meshkujve si neutral apo që vlejnë për dy gjinitë dhe nuk njeh burra dhe gra, edhe pse në një pjesë të mirë prej veprave penale të cilat i rregullon njohja mund të sigurojë mbrojtje më të mirë dhe realizim të të drejtave të viktimave të dhunës si edhe implementim efektiv të Konventës së Stambollit.

Tërpe Stojanovski dhe Iskra Andreeva në Vlerësimin e ndikimit të Konventës së Stambollit ndaj legjislaturës së Maqedonisë rekomandojnë përgatitjen dhe sjelljen e një Ligji të ri për parandalimin dhe mbrojtjen e

⁵³ Po aty

dhunës së bazuar gjinore, i cili në tërësi dhe në mënyrë të qartë do t'i shprehë qëllimet, vëllimin e zbatimit, obligimet dhe masat e parapara në Konventë.

“Por, duke e pasur parasysh faktin se praktika nomoteknike përfshin edhe parashikimin e veprave penale edhe me ligj të veçantë dhe jo me Kodin Penal, duke e pasur parasysh zhvillimin e të drejtës penale në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përvojat me rregullimin e veprave penale të reja dhe zbatimin e dispozitave ligjore, rekomando het veprat penale të cilat janë paraparë me Konventë të rregullohen në mënyrë përkatëse në Kodin Penal”⁵⁴

Përfshirja e femrave në krim është një çështje që adresohet nga cdo shtet për shkak të rëndësisë që ka roli i saj në një shoqëri si grua, si nënë, si edukuese e brezave dhe mbrojtja e tyre nga veprimtaria kriminale dhe përfshirja në aktivitet kriminal është detyrë dhe përgjegjësi e cdo shteti dhe shoqërie.

Literatura e zhvilluar dhe studimet shkencore kanë treguar se faktorë të natyrës individuale, familjare, edukimi, shkollimi dhe shoqërorë kanë ndikim të pamohueshëm në formimin e individëve që përfshihen në kryerjen e veprave penale, prandaj këto elemente duhet të merren parasysh nga politikëbërësit në hartimin dhe përmirësimin e politikave duke kërkuar përgjigje dhe metoda të reja ndërhyrjeje me qëllimin kryesor: uljen e kriminalitetit dhe përmirësimin e një shoqërie ku cdo individ trajtohet si qenie njerëzore dhe respekton shtetin e së drejtës me ligjet e tij.⁵⁵

2. Kriminaliteti i femrave në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Punimi synon të pasurojë më tej studimet juridike dhe kriminologjike mbi vepruesit e veprave penale në RMV. Vepra penale të kryera nga ana e femrave ka si qëllim goditjen e atyre sjelljeve njerëzore të cilat prekin të mira që

⁵⁴ Plani veprues për zbatimin e konventës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në shtëpi i Republikës së Maqedonisë së Veriut 2018-2023, në dispozicion në Plani veprues për zbatimin e konventës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në shtëpi i Republikës së Maqedonisë së Veriut 2018-2023

⁵⁵ Prof.Dr. Vasilika Hysi "Kriminologjia", shtëpia botuese Kristalina-KH ISBN 978-99956-43-20-1, Tirane 2010, fq.43

kanë një vlerë themelore për të gjithë shoqërinë. Veprat penale mund të ndahen sipas kriterëve të ndryshme. Disa autor veprat penale i grupojnë duke u nisur në ndërmarrjen e veprimit, shkaktimin e pasojës, figurës së veprës penale, sipas mënyrës së kryerjes sipas fazave të kryerjes së saj.⁵⁶ Në punimin tonë të masterit do ti japim një theks të vecantë femrave si vepruese në vepër penale.

Karakteristika e kriminalitetit të femrave është edhe fakti se ato më tepër marrin pjesë në kryerjen e krimeve si ndihmëse, shtytëse e më pak si kryerëse e drejtpërdrejtë apo organizatore të krimeve të caktuara.⁵⁷

Pjesëmarrjen e vogël të femrave në kriminalitet, disa autorë janë të prirë ta shpjegojnë dhe ta arsyetojnë me faktin se femra është një qenie biopsikike dhe biofizike më e ndjeshme, më e dobët në pikëpamje anatomiko-fizike etj.

Në këtë drejtim, veçmas theksojnë vetitë personale anatomikopsikike si për shembull, emocionalitetin e theksuar, ciklin menstrual, shtatzëninë, lindjet, klimakteriumin të cilat ndikojnë që ajo në raste të caktuara të jetë më agresive, të ketë sulme dhe paraqitje hysterike, të bie në depresione dhe gjendje të tjera psikike të cilat objektivisht mund ta shtyjnë dhe ta nxisin në veprime dhe sjellje kriminale.⁵⁸

Gjatë studimeve shkencore mbi institutet themelore që karakterizojnë kodet penale, si tentativa, përgjegjësia e tentativës, pakujdesia, bashkëpunimi, bashkërealizimi i veprave penale, mbrojtja e nevojshme, vepra penale e cilësuar nga rrethana lehtësuese apo rënduese etj; vihet re aplikimi i vazhdueshëm i një terminologjie e cila përdoret nga pjesa më e madhe e manualëve dhe komenteve të së drejtës penale të Italisë, Gjermanisë, Spanjës, Turqisë dhe vendeve të Amerikës Latine.

Më saktësisht, pjesëtarët e doktrinës së këtyre shteteve të cilët përbëjnë pjesën dërmuese të doktrinës botërore rreth “teorisë së

⁵⁶Ismajl Zejneli, Vlado Kambovski, E drejta Penale, pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018, fq.106

⁵⁷Rakip Dr. Halili, “Kriminologjia”, Prishtinë, 2000

⁵⁸Bashkim Dr. Bashkim Dr. Selmani, “Kriminologjia dhe penologjia”-Kolegji, Fama”-Prishtinë, 2013

përgjithshme të së drejtës penale”, e cila tashmë është pjesë e kulturës ndërkombëtare edhe të RMV-së vendeve tjera të Ballkanit, përdorin shprehjen “mënyrat e shfaqjes së veprës penale”.¹

E drejta penale i shpall disa sjellje të njerëzve si vepra penale, duke paraparë për kryerësit e tyre llojin e caktuar të masës së Dënimit ose sanksionit tjetër penal. Nga kjo del edhe qëllimi i kësaj dege të drejtësisë.

Dhe se në të vërtetë përbëhet nga ndikimi në sjelljet njerëzore, duke i orientuar se çka është e palejueshme dhe e ndaluar të veprohet dhe çka jo, që do të thotë se ndikon që njerëzit të sillen në harmoni me ligjet dhe rregullat juridike. Sipas kësaj, qëllimi i të drejtës penale nuk është vetëm në zbatimin e Dënimit ndaj të padëgjueshmëve.⁵⁹

Edhe përkundër këtij definicioni materialo-formal të nocionit të së drejtës penale, në teorinë e të drejtës penale, na paraqiten definicione të njëanshme formale ose materiale. Sipas kodit penal, vepra penale mund të kryhet me veprim ose me mosveprim¹⁴. Mënyra nëpërmjet të cilës manifestohet veprimi i kryerjes së veprës penale, në të dr. penale njihen dy lloje të veprave penale: vepra penale të kryera me veprim dhe me mosveprim.

Disa autorë, mendojnë se disa sjellje kriminale janë tipike femërore. Në këtë drejtim flitet për krimin e vrasjes së të porsalindurit, pjesëmarrjen në prostitucion, mashtrimet dhe krimet tjera. Disa të tjerë theksojnë mënyrat dhe metodën e veçantë të kryerjes së krimeve nga personat e gjinisë femërore.⁶⁰

Kësisoj, flitet për aftësinë e femrës që ta vejë në lajthim viktimën, për shfrytëzimin e vetive të saj fizike, për dinakërinë dhe për përdorimin e disa mjeteve të veçanta të kryerjes së veprave penale etj.

Pa marrë parasysh të gjitha, këto pikëpamje të autorëve të njohur mund të thuhet se edhe personat e gjinisë femërore janë të kyçur në kryerjen e krimeve të ndryshme dhe se ato, këto krime i kryejnë nën

⁵⁹ Bashkim Dr. Bashkim Dr. Selmani, “Kriminologjia dhe penologjia”-Kolegji, Fama”-Prishtinë, 2013

⁶⁰ J. Papandile dhe I. Mandro, “Kriminologji - Penologji”, Tiranë: Ilar 2002

ndikimin e rrethanave të caktuara shoqërore, ekonomike të cilat pak a shumë janë identike edhe për gjininë mashkullore.

Femra merr pjesë më pak në kryerjen e sjelljeve të ndryshme kriminale nga se ajo në të kaluarën ka qenë më pak e përfshirë në aktivitetet e ndryshme në shoqëri. Pra, pjesëmarrja më e vogël mund të kërkohej në pozitën e saj shoqërore, familjare, ekonomike, politike të cilën e ka pasur ose e ka sot në shoqëri.

Dihet mirëfilli se femrat deri vonë, pra deri në shoqërinë bashkëkohore, nuk kanë qenë të kyçura në proceset e përgjithshme të jetës. Ato, më tepër, kanë qenë të preokupuara në lindjen, rritjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve dhe anëtarëve të familjes e më pak janë marrë me aktivitete dhe punë jashtë familjes, të cilat domosdo do t'i futnin në situata të ndryshme që do të sillnin deri te kriminaliteti i tyre. Me emancipimin dhe kyçjen gjithnjë e më të madhe të femrës në të gjitha sferat e jetës dhe të punës, vërehet edhe shtimi dhe rritja e pjesëmarrjes së saj në aktivitetet kriminale.⁶¹

Kështu që, dukshëm vihen në pyetje disa konstatime të mëhershme teorike në kriminologji se gjoja kriminaliteti është dukuri tipike e meshkujve dhe se femrat për shkak të konstitucionit të tyre biofizik dhe biopsikik, objektivisht, kryejnë më pak krime.

Kontribut të veçantë në ndriçimin e pjesëmarrjes së femrave në kryerjen e krimeve të ndryshme ka dhënë autorja e njohur amerikane Freda Adler e cila i ka demantuar disa koncepte që ekzistonin më parë mbi shpjegimin e shkaqeve të krimit të femrave në teorinë dhe literaturën kriminologjike.⁶²

Veprat penale të kryera me veprim – Në kuptimin penalo-juridik, veprimi është lëvizje trupore e vullnetshme e njeriut me të cilin kryhet vepra penale (p.sh. shkrepija me armë të vepra penale e vrasjes, marrja e sendit të huaj të vepra penale e vjedhjes etj.).

⁶¹ J. Papandile dhe I. Mandro, "Kriminologji - Penologji", Tiranë: Ilar 2002

⁶²Po aty

Me anë të veprave penale të kryera me veprim apo siç quhen ndryshe, delikte komosive, cenohen normat penalo-juridike të cilat e ndalojnë veprimin e caktuar. Këto norma ndryshe quhen norma prohibitive.⁶³

Veprat penale të kryera me mosveprim – Veprat penale me mosveprim, apo siç quhen ndryshe delikte omisive, kryhen me mos ndërmarrjen apo abstenimin nga veprimi që ka qenë i detyruar ta ndërmarrë.

Kjo mënyrë e kryerjes së veprës penale shprehet si qëndrim pasiv i njeriut në rrethanat e caktuara, për shkak të cilit qëndrim shkaktohet pasoja e ndaluar në botën e jashtme. Si vepër penale e kryer me mosveprim është p.sh. mosdhënia e ndihmës mjekësore. Me veprat penale me mosveprim cenohen normat të cilat urdhërojnë apo obligojnë që të ndërmerret veprimi i caktuar.

Këto norma quhen norma imperative apo perceptive. Si thamë edhe më larte veprat penale ndahen në vepra penale formale dhe material. Veprat formale të kryera nga ana e femrave janë ata vepra që janë kryer me faktin e ndërmarrjes së veprimi të kryerjes. Përkundë faktit të veprës penale formale nuk shkaktojnë pasoja në kuptimin real apo si dukuri fizike në botën e jashtme.⁶⁴ Veprat materiale të kryera nga ana e femrave janë ata vepra për ekzistimin e të cilaveligji parasheh shkaktimin e pasojës së caktuar, vepra të tilla kemi plotë.

Veprat penale kanë rrezik të ndryshëm për shoqërinë, duke marrë parasysh se janë të drejtuara në të mirat e vlerave të ndryshme për bashkësinë shoqërore. Sipas rrezikut të përgjithshëm shoqëror, ligjdhënësi e përcakton llojin dhe masën e dënimit për secilën vepër penale në pjesën e posaçme të ligjit penal¹⁸

Të dhënat statistikore në fushën e drejtësisë i referohen autorit të krimit, me disa marka. Ndiqet për një periudhë më të gjatë kohore, struktura gjinore e kryerësve të krimeve në Republikën e Maqedonisë karakterizohet nga një ndryshim i dukshëm midis grave dhe burrave. Nga

⁶³ Hyrje në të drejtën evropiane, Desche Stiftung für Internationale Rechtliche Zusammenarbeit E.V., Magor, SHPK, Shkup

⁶⁴ Ismajl Zejneli, Vlado Kambovski, E drejta Penale, pjesa e përgjithshme, Tetovë, 2018, fq.100

gjithsej 10,603 autorë të rritur të njohur të krimeve të raportuara në vitin 2017, 945 ose 9% janë gra, dmth 9,658 ose 91% janë burra. Midis të pandehurve, nga gjithsej 7,423, 677 ose 9% janë gra, dhe 6,746 ose 91% janë burra. Nga një total prej 6,273 të dënuarish, 550 ose 9% janë gra dhe 5,723 ose 91% janë burra.⁶⁵

Nga gjithsej 578 kryerës të fëmijëve të raportuar në vitin 2017, 26 ose 5% janë gra, dmth 552 ose 95% janë burra. Nga gjithsej 554 shkelës të fëmijëve të akuzuar, 19 ose 3% janë gra dhe 535 ose 97% janë burra.

Nga gjithsej 368 fëmijë të dënuar për krime, 14 ose 6% janë gra dhe 354 ose 94% janë burra. Ky raport i grave dhe burrave është i pranishëm dhe monitorohet nga të gjitha grupet kriminale punon Për shembull, nga një total prej 664 autorësh të rritur të krimeve kundër jetës dhe trupit, 42 ose 6% janë gra dhe 622 ose 94% janë burra.

Midis krimeve kundër pronës, nga një total prej 2,427 autorësh, 258 ose 11% janë gra dhe 2,169 ose 89% janë burra.⁶⁶

3. Aspekte krahasimore-femrat si subjekt i veprave penale

3.1 Kriminaliteti i femrave në Republikën e Kosovës

Krimi në Kosovë është shqetësim për organet e rendit dhe qytetarët. Lloje të veçanta të krimit janë përhapur pas luftës së fundit. Shteti shpesh hasë në vështërsi në luftimin e krimit për shkak të korrupsionit.⁶⁷ Vërehet se femrat marrin pjesë në kryerjen e krimeve kundër nderit dhe dinjitetit njerëzor, kundër jetës dhe trupit, procese dhe veçmas janë të shprehura në aktivitetet kriminale që kanë të bëjnë me prostitucionin etj, ndërsa raste tjera veprojnë si ndihmëse, shtytëse në kryerjen e aktiviteteve kriminale.

⁶⁵ Кирил Ангелов, Жените и мажите во Северна Македонија, ISBN 978-608-227-318-1, Население - Полова структура - Македонија - 2019 - Статистика COBISS.MK-ID 109805066, mundësuar nga: <http://www.stat.gov.mk/Publikacii/Gender2019.pdf>

⁶⁶ По аты

⁶⁷Ahmeti, Nadie (2 shkurt 2013). ["Krimi i organizuar dhe korrupsioni ngufasin Kosovën"](#)

Bazuar në këto statistika në qoftë së bëjmë një krahasim me statistikat e vendeve tjera ku përfshirja e femrës në aktivitete kriminale arrin shkallën e përfshirjes së femrës prej 8-10%, na del se Kosova në këtë rast paraqitet të jetë në një pozitë shumë më të favorshme.⁶⁸

Ky mobilitet ka të bëjë me ndryshimet në shoqëri, si në aspektin horizontal gjithashtu edhe aspektin vertikal. Zhvillimi hovshëm ekonomik, industrializimi, urbanizimi, rritja dhe zgjerimi i rrjetit të komunikacionit, përsosja e mjeteve të komunikimit publik, aplikimi i teknologjisë elektronike dhe kompjuterike, kanë nxitur sot transformime të mëdha, të cilat reflektohen edhe në forma e paraqitjes së sjelljeve kriminale.

Fenomenologjia kriminale është pjesë e kriminologjisë dhe merret me studimin e formave të paraqitjes së kriminalitetit, me strukturën dhe dinamiken e tij. Gjithashtu me trajtimin dhe studimin e kriminalitetit është e domosdoshme të studiohet dhe ndriçohet dinamika e lëvizjes së kriminalitetit në periudha kohore dhe në vende të ndryshme.

Shikuar në këtë prizëm, fenomenin bashkëkohor kriminal dhe pasojat nga kriminaliteti në shoqërinë bashkëkohore, pikërisht, sot ekziston një numër i madh kriminologësh të cilët e parashtrojnë këtë pyetje në një mënyrë më ndryshe si për nga objekti i studimit ashtu edhe për nga metodat e veprimit.⁶⁹

Në pjesën e dytë të Kodit Penal të Kosovës kemi sqarimin e veprave penale, Veprat penale janë të drejtuara kundër të mirave apo vlerave të cilat janë të mbrojtura me sistemin juridik të vendit dhe me të drejtën ndërkombëtare. Të mirat juridike që janë të mbrojtura me të drejtën penale janë edhe objekt i veprës penale.

Përveç atyre që drejtpërsëdrejti ndërmarrin veprimin e kryerjes, subjekt i veprës penale konsiderohen edhe;

- Shtytësit,

⁶⁸ Stojanka Mirçeva, Bogdanço Gogov: Analizë e përputhshmërisë së legjislacionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut me Konventën e Këshillit të Evropës për parandalim dhe luftë kundër dhunës ndaj gruas dhe dhunës familjare: (Konventa e Stambollit): Studim bazik – Shkup 2013: Lidhja e organizatave të grave e Republikës së Maqedonisë

⁶⁹ Rakip Dr. Halili, “Kriminologjia”, Prishtinë, 2000, fq.33

- Ndhmësit dhe
- Organizata kriminale, ngase edhe këta kontribuojnë në kryerjen e veprës penale.

Subjektet aktiv të veprës penale ndahen edhe sipas kategorive të mëposhtme. Subjekt pasiv është personi që është dëmtuar apo rrezikuar me vepër penale, ai quhet edhe viktimë e veprës penale. Subjekt pasiv mund të jetë personi fizik dhe juridik. Në pjesën e dytë të Kodit Penal të Kosovës kemi sqarimin e veprave penale, Veprat penale janë të drejtuara kundër të mirave apo vlerave të cilat janë të mbrojtura me sistemin juridik të vendit dhe me të drejtën ndërkombëtare. Personi (në rastin tonë femrat) që kryen vepër penale quhet subjekt i veprës penale. Përveç atyre që drejtpërsëdrejti ndërmarrin veprimin e kryerjes, subjekt i veprës penale konsiderohen edhe;

- Ndhmësit dhe
- Organizata kriminale, ngase edhe këta kontribuojnë në kryerjen e veprës penale.

Subjektet aktiv të veprës penale ndahen edhe sipas kategorive të mëposhtme.⁷⁰

Kategoritë e veprave penale nga ana e femrave në Republikën e Kosovës	2015	2016	2017	2018	2019
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Mashtrim	6.943	6.634	-4.5%	6.632	0.03
Falsifikim i dokumentave	140	323	-16.3	213	10.6
Krime	5.003	4.983	50.5%	5.002	11.1%

⁷⁰ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Republika e Kosovës Republika Kosova/Republic of Kosovo Instituti Gjyqësor i Kosovës/Kosovski Institut za Pravosudje/Kosovo Judicial Institute, Prishtinë, nëntor 2016

kundër jetës					
Vjedhje	342	364	6.7%	377	3.5%
Prostitucion	385	579	50.4%	643	11.1%

Burimi: Statistika e krimeve dhe drejtësia penale nga viti 2015 deri në vitin 2019

3.2 Kriminaliteti i femrave në Republikën e Shqipërisë

Me çështjen e fenomenologjisë kriminale janë marrë shumë autorë. Duhet theksuar se në këtë drejtim dallohen autorët gjermanë dhe austriakë. Pjesa më e madhe e autorëve që e kanë trajtuar problemin e fenomenologjisë kriminale, theksojnë se ajo është shkencë mbi manifestimin e krimit. Kësisoj, këta autorë vërtetojnë se fenomenologjia kriminale duhet të koncentrohet në studimin e statikës, dinamikës dhe tipologjisë së formave të manifestimit të krimit dhe sjelljeve delikuate.

Po ashtu, sipas tyre, ajo duhet të merret edhe me përshkrimin e mënyrës së kryerjes së krimeve të ndryshme, me studimin dhe njohjen e personalitetit të kryerësve respektivisht me studimin e jetës së delikuentëve dhe, në fund, me tipologjinë dhe klasifikimin e kriminelëve.⁷¹

Kriminaliteti i femrave si dukuri mjaft komplekse, paraqet një fenomen që kërkon një angazhim të veçantë në hulumtimin dhe studimin e tij. Në këtë drejtim, veçmas shtrohet nevoja e studimit dhe analizës së vëllimit të tij në një shoqëri. Me vëllim, si dihet, nënkuptojmë aspektin kuantitativ të përhapjes dhe pranisë së krimit në shoqëri të ndryshme.

Po ashtu, në trajtimin dhe studimin e kriminatetit është e domosdoshme të studiohet dhe ndriçohet dinamika e lëvizjes së kriminalitetit në periudha kohore dhe në vende të ndryshme. Prandaj, si detyrë e veçantë e fenomenologjisë kriminale është edhe njohja me dinamikën e përhapjes dhe shtrirjes së kriminalitetit në një vend të caktuar. Në kuadër të trajtimeve fenomenologjike, vend të veçantë zënë edhe analiza dhe studimi i strukturës

⁷¹ Bashkim Dr. Selmani „Kriminologjia dhe penologjia”-Kolegji “Fama”-Prishtinë, 2013

dhe ndryshimeve strukturale të kriminalitetit dhe sjelljeve delikumente në një shoqëri. Në këtë drejtim posaçërisht kujdes i veçantë i kushtohet edhe. analizës dhe studimit të personalitetit të delikuentit, përkatësisht analizës dhe trajtimit të vetive individuale dhe personale të kryerësve të veprave të ndryshme penale.⁷²

Kategoritë e veprave penale nga ana e femrave në Republikën e Kosovës	2015	2016	2017	2018	2019
	Nr	Nr	Ndryshimi %	Nr	Ndryshimi %
Mashtrim	187	322	30.6%	223	10%
Falsifikim i dokumentave	532	622	39%	872	66%
Krime kundër jetës	233	434	77%	776	43%
Vjedhje	333	545	76%	222	65%
Prostitucion	777	675	66%	665	44%

Burimi: Statistika e krimeve dhe drejtësia penale nga viti 2015 deri në vitin 2019 **Shqipërisë**

3.3 Riintegrimi i grave të dënuara në Kosovë – Shqipëri

Krahasuar më burrat vlerësojmë se shumë rëndë është për gratë e dënuara të integrohen në shoqëri. Është thelbësore se midis shumë ndryshimeve është se burrat zakonisht kthene në familje pa ndonjë problem vazdhojnë jetën e tyre ashtu si e kanë pasur.

⁷² L. Glick vepra e cituar f. 36-40; Joseph Shetey etj. vep. e cit. f. 56-57, 60-64, 65-70.

Sipas autorit Belkalp kur një grua lirhet ajo shpesh duhet të rindërtojë një shtëpi, rolet e saj në familje dhe të rimarrë kujdestarinë e fëmijëve të saj, të sigurojë një punë dhe të paguaj të ardhmet e saj. Për shumë gra që largohen nga burgu, pengesat me të cilat përballen janë të pakapërcyeshme, gjë që reflektohet në numrin e madh që kanë kontakte të mëvonshme me sistemin e drejtësisë penale.

Vlerësimet e fundit të recidivizmit ndër-shtetëror tregojnë se 58 përqind e grave të burgosura janë rimarrë, 38 përqind janë dënuar dhe 30 përqind janë kthyer në burg në tre vitet pas lirimit.⁷³

Disa studiues feministë argumentojnë se kriminaliteti dhe recidivizmi i femrave formohen nga viktimizimi. Shumë nënvizojnë numrin joproporcional të shkelësve femra që kanë përjetuar abuzim fizik dhe seksual ⁷⁴dhe arrijnë në përfundimin se viktimizimi si fëmijë dhe gjatë moshës së rritur është i lidhur me shkeljen pasuese .⁷⁵

Qëllimi im është të siguroj një analizë të hollësishme të rrugëve që gratë marrin në krim, sfidat me të cilat përballen pas lirimit, strategjitë që gratë përdorin për t'u integruar me sukses ose pa sukses në komunitet, arsyet e përsëritjes së tyre, motivuesit dhe metodat e përdorura për të hequr dorë nga krimi, si dhe për të kapur kuptimet e përvojat e tyre.

Fokusi kryesor i këtij disertacioni është të shqyrtojë përvojat e grave që dalin nga burgu. Megjithatë, para diskutimit të përvojave të hyrjes së grave, është thelbësore të kuptohet fillimi i tyre në krim pasi përvojat e kaluara të grave mund të formojnë kalimin e tyre nga krimi. Studiuesit kanë dokumentuar rrugët gjinore të krimit dhe burgim.⁷⁶

⁷³ Deschenes, Elizabeth P., Barbara Owen, and Jason Crow. (2007). Recidivism among Female Prisoners: Secondary Analysis of the 1994 BJS Recidivism Data Set, Final Report. Washington, DC: National Institute of Justice.

⁷⁴ Greenfeld, Lawrence A. and Tracy L. Snell. (1999). Women Offenders. Washington, DC: Bureau of Justice Statistics.

⁷⁵ Chesney-Lind, Meda. (1997). The Female Offender: Girls, Women, and Crime. Thousand Oaks, CA: Sage.

⁷⁶ Blakeley, Sharrell. (1995). California program to focus on new mothers. Corrections Today, 57: 128-130.

Dallimet e dallueshme midis jetës së grave dhe burrave formojnë modelet e tyre të veprës penale. Provat empirike tregojnë se viktimizimi, marginalizimi ekonomik dhe abuzimi me substancat ndikojnë në mënyrë disproporcionale në gratë dhe luajnë role unike në formësimin e kriminalitetit femëror.⁷⁷

Një nga parimet më të spikatura të kriminologjisë feministe është lidhja, ose kufijtë e paqartë, midis viktimizimit dhe ofendimit të grave. Hulumtimet tregojnë se abuzimi i fëmijëve është i lidhur drejtpërdrejt me delikuencën, varësinë dhe kriminalitetin pasues.⁷⁸

Shumica e shkelësve femra kanë histori paraprake të abuzimit fizik dhe seksual, dhe nivelet e abuzimit me partnerin intim të të rriturve janë shumë më të larta sesa për gratë në popullatën e përgjithshme ose për burrat në burg.⁷⁹

Jo vetëm që viktimizimi është më i zakonshëm në mesin e shkelësve femra, por gjithashtu është zbuluar se abuzimi fillon më herët dhe zgjat më shumë⁸⁰kështu, duke kontribuar më tej në ofendimin pasues.⁸¹

Kuadri i rrugës për krim të Daly⁸²identifikon disa rrugët për në forma të ndryshme të krimit; megjithatë, shumica e rrugëve specifikojnë statusin e dobët ekonomik si një karakteristikë jetësore.

Bursa të tjera kanë vërtetuar se një numër disproporcional i grave të ofenduara janë pakica që vijnë nga lagje të trazuara ekonomikisht⁸³, të cilat zakonisht ofrojnë pak mundësi punësimi.⁸⁴

⁷⁷ Daly, Kathleen. (1998). Gender, crime, and criminology. In *The Handbook of Crime and Justice*, ed. Michael Tonry. Oxford: Oxford University Press.

⁷⁸ Blakeley, Sharrell. (1995). California program to focus on new mothers. *Corrections Today*, 57: 128-130.

⁷⁹ Chesney-Lind, Meda. (2002). Imprisoning women: The unintended victims of mass imprisonment. In *Invisible Punishment: The Collateral Consequences of Mass imprisonment*, eds. Marc Mauer and Meda Chesney-Lind. New York: The New Press.

⁸⁰ Chesney-Lind, Meda. (2002). Imprisoning women: The unintended victims of mass imprisonment. In *Invisible Punishment: The Collateral Consequences of Mass imprisonment*, eds. Marc Mauer and Meda Chesney-Lind. New York: The New Press.

⁸¹ Daly, Kathleen. (1994). *Gender, Crime, and Punishment*. New Haven, Conn.: Yale University Press.

⁸² Daly, Kathleen. (1992). A women's pathway to felony court: Feminist theories of lawbreaking and problems of representation. *Southern California Review of Law and Women's Studies*, 2: 11-52.

⁸³ Richie, Beth E. (2001). Challenges incarcerated women face as they return to their communities: Findings from life history interviews. *Crime and Delinquency*, 47: 368-389.

Kështu, kushtet strukturore në të cilat jetojnë gratë, shoqëruar me rritjen e presionit ekonomik, shtyn shumë gra të përfshihen aktivitetet e paligjshme për të mbijetuar.

Nuk është për t'u habitur, përkeqësimi i situatës ekonomike - ose "feminizimi i varfërisë" - i grave të marginalizuara ka të bëjë me rritjen e niveleve të shkeljeve të grave.⁸⁵

Përdorimi i substancave është gjithashtu kritik për të kuptuar rrugët e grave drejt krimit. Hulumtimet tregojnë se gratë që përdorin drogë ka shumë më tepër gjasa të përfshihen në krim.⁸⁶ Gratë në burgun shtetëror raportojnë nivele të larta të përdorimit të drogës në kohën e burgimit ⁸⁷dhe shumica kanë probleme me abuzimin e substancave.⁸⁸

Shumë bursa feministe pohojnë se gratë përdorin ilaçe për të përballuar dhimbjen e abuzimit.⁸⁹

Punimi merr përsipër të ofrojë jo vetëm një studim të krahasuar për statusin e grave në konflikt me ligjin, por shërben, gjithashtu, për të provokuar diskutimin si i trajton shoqëria këto gra në mënyrë që të gjejë dhe të zbatojë masa më njerëzore dhe efektive për zgjidhjen e konflikteve dhe të përmirësojë jetët e grave të cilat përbëjnë një nga grupet më të shpërfillura të shoqërisë.

Për më tepër, ky punim ka si qëllim të mundësojë sistemin e burgjeve shqiptare dhe të institucioneve të zinxhirit të drejtësisë penale të përfitojë nga qasjet europiane në hartimin dhe zbatimin e politikave me perspektivë gjinore.

⁸⁴ Daly, Kathleen. (1994). *Gender, Crime, and Punishment*. New Haven, Conn.: Yale University Press.

⁸⁵ Heimer, Karen. (2000). Changes in the gender gap in crime and women's economic marginalization. In *Criminal Justice 2000: The Nature of Crime, Continuity and Change*, Vol. 1, ed. Gary LaFree. Washington, DC: National Institute of Justice.

⁸⁶ Merlo, A. and Joycelyn Pollock. (1995). *Women, Law, and Social Control*. Boston, MA: Allyn and Bacon.

⁸⁷ Glueck, Sheldon and Eleanor Glueck. (1940). *Juvenile Delinquents Grown Up*. New York: Commonwealth Fund.

⁸⁸ Daly, Kathleen. (1998). Gender, crime, and criminology. In *The Handbook of Crime and Justice*, ed. Michael Tonry. Oxford: Oxford University Press.

⁸⁹ Daly, Kathleen. (1994). *Gender, Crime, and Punishment*. New Haven, Conn.: Yale University Press.

Personat e dënuar me hjekje lirie	Angli	Francë	Gjermani	Hungrari	Itali	Spanjë
Të arrestuar ose të dyshuar % grave	16%	14%	17%	13.5%	13.5%	10%
Të dënuar % grave	17.6%	9.7%	18.4%	12%	18.4%	6.5%
Të dënuar me burgim % grave	7.6%	4.7%	23%	5.8%	3.5%	3.4%
Të burgosur me paraburgim % grave	6%	4%	4.8%	6.1%	4.5%	8%

Të dhënat për Francën për të dënuarit, Franca metropolitane për të dhënat për të dyshuarit dhe të dënuarit me burgim. Gjermania Perendimore për popullatën e dënuar e gjithë Gjermania për të dyshuarit dhe të dënuarit me burgim. Hungaria të dhënat përfshijnë vetëm ato për të dënuarit e rritur të dënuar me burgim.

KREU II

Faktorët dhe motivet që dërgojnë në përfshirjen e femrave në kriminalitet

Ky punim ka për qëllim të studiojë gratë në konflikt me ligjin në përgjithësi dhe në veçanti ato në kujdesin e institucioneve të paraburgimeve dhe burgjeve shqiptare, krahasuar me disa vende të Bashkimit European. Fenomenologjia kriminale studion format nëpërmjet të cilave manifestohet krimi., sic janë vëllimi, struktura, ecuria etj, kurse etiologjia studion shkaqet dhe faktorët e kriminalitetit. Krimi - shkaqet e krimit kanë qenë të varura nga shkalla e civilizimit, orientimit ideor dhe përcaktimit profesional. Kriminaliteti si dukuri shoqërore negative nuk është karakteristikë vetëm për meshkujt ai është bërë karakteristike edhe më femrat. Shpesh herë si kryes të veprave penale paraqiten personat e mitur femra.

Është fenomen shoqërore që qysh në shoqërinë primitive vërehen orvatjet e luftimit të krimit, historia e civilizimit është e lidhur edhe me historinë e krimit, për shkak se historia e krimit për herë ka zgjuar frikë, pasiguri dhe tmerr ndër qytetarë e në te njëjtën kohë interesim. Krimi dhe sjelljet e ndryshme kriminale në botën e sotme janë bërë temë e mediave të shkruara e elektronike.

Programet filmike, TV-të, video-klubet janë përplot me tema dhe përmbajtje të krimeve, dhunës, vrasjeve e sjelljeve patologjike e që sjellin porosi negative duke zgjuar instinkte të ulëta e ideja për krim, për këtë arsye shtrohet pyetja prej nga i gjithë ky interesim dhe opinion i preokupuar të cilin e shpjegojmë me anën e disa faktorëve që vijnë më poshtë.

Faktorët subjektiv dhe emocional - sipas autorëve të njohur Barnes & Beteres interesimi për krim vjen nga ndjenja e frikës për sigurinë jetës, integritetit moral e seksual, kënaqjes së epsheve nga dëshira e imitimit të krimit.⁹⁰

Nga shume anketa, analiza, kërkime kriminologjike të bëra në shume vende të botës vërtetojmë se frika nga krimi ndër qytetarë është në vend të II-të,

⁹⁰ Adamoli, S., Di Nicola, A., S., Savona, E., etc., (1998), organized Crime around the World, HEUNI, Helsinki: 4-7.

ndërsa frika nga kataklizmi e lufta në vend të I-rë, e nga sëmundjet në vend të III-të. Sipas disa autorëve dhe teorive çdo njeri është kriminel potencial

. Kriminologu Bemelen konkludoi se interesimi për krim vjen si rezultat i shtytjeve të brendshme të individëve të ndryshëm që në nënvetëdijen e tyre të identifikohen me kryerësit e krimit, e këtë mendim e kontestoi amerikani Jonson duke thënë se njerëzit nisen nga ana humanitare e jo nga ndjenja e krimit.⁹¹

. Autori poeti Gete ka thënë “Nuk ka krim të cilën një dite nuk do te isha i aftë ta kryej”, këtë mendim e vërtetojmë përmes Metodës së Vetakuizmit ku shume njerëz kanë bërë krime të cilët kurrë nuk janë përgjigjur për to e as nuk është ditur kurrë, nga kjo e dhënë del se numër i errët i sjelljeve kriminale është i madh dhe prirja për të kryer krim është shumë e shprehur.

Ish - presidenti i SHBA-ve Klinton deklaroi se sot është rrezik i madh nga sundimi i Kleptokratisë d.m.th nga qeverisja e hajnave, pra shumë autorë e vërejnë se këtu qëndron arsyeja e interesimit të madh të krimit dhe frikës së madhe meqë janë të përfshirë edhe ata që duhet ta mbrojnë shoqërinë nga kriminaliteti.

Faktori objektiv ose rreziku real nga atakimet e krimit - në grupin e II-të bëjnë pjesë faktorët që nxisin interesimin për dukurinë e krimit si rrezikimin e vlerave dhe të mirave elementare të njeriut; jeta, liria, rrezikimi i rendit të caktuar ekonomik - shoqërore, rrezikimin e normave etiko - morale etj, të gjitha këto vlera dhe norma në çdo shoqëri atakohen dhe janë të rrezikuara nga veprimet e ndryshme kriminale ku krimi iu hap rrugën kaosit, korrupsionit, konflikteve midis qytetareve etj.⁹²

Faktorët ekonomik e material - grupi i III-të ku bëjnë pjesë humbjet dhe dëmët e mëdha materiale që pëson shoqëria - individit drejtpërdrejtë nga aktiviteti kriminal. Harxhohen para të mëdha në pengimin e terrorizmit ndërkombëtar, krimit të organizuar etj, ku nga të gjitha këto akte kriminale shkaktohen dëme materiale. Interesimi me qëllim të mbrojtjes & vetëmbrojtjes -

⁹¹ Elezi, I., Hysi, V., (2006)“Politika kriminale”, Pegi, Tiranë

⁹² Elezi, I., Hysi, V., (2006)“Politika kriminale”, Pegi, Tiranë

grupi i IV-të i faktorëve që zgjojnë interesim në opinion e cila mundohet përmes mediave, televizioneve të shpjegoj se si të ruheni nga krimi pra, ta parandalojmë atë mirëpo nga ana tjetër përmes këtyre faktorëve mund të ketë anë negative të nxisin - imitojnë krimin. ⁹³

Disa pikëpamje në kuptimin e Kriminologjisë - disa nga këto kuptime tentojnë Kriminologjinë ta paraqesin si shkencë gjithëpërfshirëse mbi krimin e disa tjera përkufizojnë atë si disiplinë të specializuar mbi shkaqet e krimit.

Rafello Garafallo ka theksuar se kriminologjia është shkencë që merret si akt i cili cënon ndjenjat elementare morale të një bashkësie njerëzore e ashtu quajtur - krimi natyror (shih faqe 16-17).

Blumi, Oueni dhe Kavingtoni⁹⁴ theksojnë gjashtë parime nga ku udhëhiqen politikat e drejtësisë penale, përfshirë edhe praktikën në sistemin penitenciar, parime të cilat janë të ndjeshme ndaj përkatësisë gjinore:

Gjinia: prano që përkatësia gjinore bën diferencën: Hapi i parë në zbatimin e programeve të ndjeshme ndaj përkatësisë gjinore është të kuptohet drejt fakti që gratë e dënuara me heqje lirie janë shumë të ndryshme nga burrat me të njëjtin status.

Programet dhe ndërhyrjet në gjithë sistemin e drejtësisë penale zbatohen dhe vlerësohen duke pasur parasysh shumicën e popullatës në institucionet e mbyllura – pra duke pasur parasysh burrat- dhe pak vëmendje u jepet kategorive të tilla, si gratë në burgje.

Administrata që punon në institucionet e ndryshme të drejtësisë penale dhe sidomos në institucionet e mbyllura penale, duhet të kuptojë drejt karakteristikat e grave të dënuara me heqje lirie si edhe perspektivat teorike të parashtruara më lart, të cilat lidhen ngushtësisht me sjelljen e tyre dhe historinë e tyre kriminale. ⁹⁵

⁹³ Gligori, H., (2007), “Për Të Vërtetën Në Procesin Penal”, Revista “Tribunë Juridike”, n. 63

⁹⁴Bloom, B. Owen, B. dhe Covington, S.: Strategjitë e ndjeshme gjinore: kërkime, praktika dhe drejtim, parimet për gratë e dënuara me heqje lirie, Washington, D.C.: Departamenti i Drejtësisë, Instituti Kombëtar i Korrektimeve, 2003.

⁹⁵Kassebaum, P.A. (1999): “Trajtimi zëvendësues i substancave për gratë e dënuara me heqje lirie – Udhëzues drejt praktikave premtuese”, departamenti i SHBA-së për shëndetin dhe shërbimet njerëzore.

Personeli i këtyre institucioneve duhet të ketë për qëllim të sigurojë shërbime që u përgjigjen rrezikshmërisë dhe nevojave që paraqesin profilet e grave në kujdesin e tyre. Nëse arrihet në bindjen se përkatësia gjinore bën diferencën, kjo do të çojë në hartimin e programeve dhe të politikave të hartuara për gratë duke filluar të bëhen ndryshime në mënyrën si jepet drejtësia për gratë në konflikt me ligjin, si edhe si trajtohen ato nga gjithë administrata e institucioneve të drejtësisë penale.

Klima: krijo një klimë bazuar mbi sigurinë, respektin dhe dinjitetin. Bazuar te përvojat e tyre në të kaluarën, shumë gra të dënuara me heqje lirie përballeshin me institucionet e drejtësisë penale duke mbartur ndjenjën e frikës. Shumë prej tyre vijnë nga një e kaluar ku kanë përjetuar dhunën, janë viktimizuar nga njerëz shumë të afërt të familjes së tyre dhe shpesh kanë përjetuar traumë si rrjedhojë e viktimizimit. Profesionistët e sistemit të drejtësisë penale duhet të jenë të ndjeshëm ndaj këtyre rrethanave specifike dhe, për rrjedhojë, nuk duhet të përsëritin modelet e viktimizimit të mëtejshëm.

Marrëdhëniet: harto politika, praktika dhe programe të cilat krijojnë lidhje të shëndetshme me fëmijët, familjen, njerëzit e tjerë të rëndësishëm për gratë dhe komunitetin ku ato do të rikthehen:

Duhet kuptuar rëndësia e madhe që ka për gratë vendosja e marrëdhënieve dhe mbajtja e lidhjeve me personat e tjerë.

Nëse politikat, strategjitë dhe programet ndërtohen nga personeli i institucioneve të drejtësisë penale me këtë kuptueshmëri në mendje, atëherë ndërhyrjet do të jenë të suksesshme te këto gra. Hartimi i trajtimit të tyre duhet të mbajë parasysh përgjegjësitë prindërore. Sa të jetë e mundur, duhet përforcuar lidhja e tyre me fëmijët dhe, për rrjedhojë, nuk duhet shkatërruar kjo marrëdhënie nga kërkesat ose nga mungesa e vëmendjes së administratës së institucioneve penale, për përgjegjësitë prindërore të grave dhe për nevojat e fëmijëve. Të gjitha marrëdhëniet e tjera të rëndësishme me familjen, të afërmit etj., duhet të inkurajohen.

Shërbimet dhe mbikëqyrja: adresoj problemet e ndryshme që kanë gratë, si: trauma, problemet e ndryshme të shëndetit mendor, varësitë e mundshme

nëpërmjet shërbimeve bashkëkohore të integruara dhe të përshtatura me realitetin dhe kulturën e një vendi. Këto shërbime duhet të mbikëqyren në mënyrë të përshtatshme nga një personel i mirëtrajnuar i institucioneve penale.⁹⁶

Gjendja social-ekonomike: krijo mundësi për gratë të përmirësojnë gjendjen e tyre sociale dhe ekonomike. Duhet mbajtur parasysh se gratë i janë drejtuar rrugës së krimit në shumë raste për shkak të gjendjes së tyre të keqe social-ekonomike. Shpeshherë rehabilitimi i tyre varet nga aftësimi i tyre për t'u bërë ekonomikisht të pavarura.

Gratë, duke mos pasur mundësi të mbajnë vetveten dhe fëmijët e tyre, detyrohen të vazhdojnë të jenë të lidhura në aspektin ekonomik dhe atë social me bashkëshortët/partnerët ose të afërmit e tyre edhe pse marrëdhëniet e tyre nuk janë të shëndetshme, madje shpeshherë janë abuzive.

Komuniteti: krijo një sistem të mbikëqyrjes në komunitet dhe rikthim të suksesshëm të grave pas lirimit së bashku me shërbimet/strukturat e tjera jashtë sistemit penal.

Kjo do të thotë që zhvillimi dhe më pas zbatimi i programeve të ndjeshme ndaj përkatësisë gjinore për gratë e dënuara me heqje lirie kërkon bashkëpunim dhe bashkërendim midis një sërë institucioneve të sistemit të drejtësisë, si: shërbimi i provës, prokuroria, gjykatat, policia, bashkitë dhe komunat, shërbimi ligjor falas, zyrat rajonale të punësimit, zyrat vendore të shërbimeve sociale, institucionet e kujdesit të fëmijëve, strehëzat, institucionet arsimore dhe ato të formimit profesional, institucionet shëndetësore, OJF-të që ofrojnë shërbime të ndryshme etj.

Secili nga këto institucione është një partner i mundshëm në procesin e bashkëpunimit për të garantuar shërbimet në kuadër të një programi të caktuar, në nivel institucioni ose në nivel të rastit individual për secilën grua.

Bazuar në një vlerësim individual bëhet një planifikim për secilin rast ku hartëzohen të gjitha lidhjet e grave me familjen dhe komunitetin dhe

⁹⁶Kassebaum, P.A. (1999): "Trajtimi zëvendësues i substancave për gratë e dënuara me heqje lirie – Udhëzues drejt praktikave premtuese", departamenti i SHBA-së për shëndetin dhe shërbimet njerëzore.

ravijëzohen institucionet me të cilat duhet vendosur bashkëpunimi. Në këtë kuadër, gjithë aktorët e duhur punojnë së bashku për të krijuar vazhdimësinë e shërbimeve dhe të mbështetjes së grave të dënuara me heqje lirie dhe fëmijët e tyre dhe në këtë mënyrë maksimizojnë burimet dhe shërbimet ndaj tyre edhe pasi gratë kanë përfunduar vuajtjen e dënimit dhe janë rikthyer në shoqëri.

1.1 Gjendja ekonomike

Sipas literaturës kriminologjike, lidhur me faktorët kriminogjenë paraqiten tri pikëpamje dhe teori - teoria e faktorit, teoria funksionaliste, si dhe teoria e kauzalitetit. Teoria e faktorit paraqet pikëpamjen më të përhapur në litareaturën kriminologjike lidhur me faktorët kriminogjenë, dhe sipas kësaj teorie në paraqitjen e kriminalitetit ndikojnë rrethana të ndryshme. Kjo teori, shkakton e kriminalitetit i shpjegon në bazë të dy versioneve. Versioni i parë quhet monist ose teori e një faktori apo e monofaktorit. Sipas kësaj teorie, kriminalitetin në shoqëri e shkakton vetëm një faktor kryesor. Kështu, pikëpamjen e monofaktorit e përfaqëson teoria antropologjike, mandej teoria biologjike, dhe ajo psikologjike, të cilat njërin nga faktorët e merrnin si vendimtar në paraqitjen e kriminalitetit (Halili, 2011:237)

Bazuar në statistikat e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, Prokurorisë së Përgjithshme, krimet kryesore të kryera nga femrat janë ato për arsye ekonomike.

Kjo sepse statusi i gruas në familje nuk ka vlerën e duhur dhe ajo shihet si një mjet përfitimi.

Gjithashtu duke marrë përgjegjësinë për të gjithë familjen ajo ndjen të nevojshme që duhet të jetë pikërisht ajo që të sigurojë të ardhurat e mjaftueshme për rritjen e fëmijëve. Kjo është e lidhur dhe me faktin që disa nga burrat e këtyre femrave që kryejnë vepra penale për arsye ekonomike, shfaqin probleme të alkolizmit, lojrave të fatit, bixhozit etj.⁹⁷

Një nga veprat penale, që femrat kanë tendencën të kryejnë më shumë për të shpëtuar nga vështirësitë ekonomike është ushtrimi i

⁹⁷ Vasilika Hysi "Penologjia" Tiranë 2010

prostitucionit. Shpeshherë mungon elementi volitiv (dashja) si element i kryerjes së veprës penale.

Ato, duke qenë kryesisht në një moshë me luhatje më të forta të emocioneve dhe pa formim të plotë të karakterit të tyre, mund të bien shumë lehtë pre e mashtrimeve të personave të cilët kanë qëllime të tjera ndaj tyre. Duke u ndodhur në kushte më të vështira ekonomike, nën ndikimin e faktorëve të tjerë në varësi të rrethanave, ato janë gjithnjë e më shumë në tendencë për të kërkuar një jetë më të mirë.

Pikërisht këtë moment shfrytëzojnë personat e caktuar që kanë për qëllim t'i përdorin këto kategori femrash par shfrytëzim prostitucioni. Kjo është një histori tipike e femrave shqiptare që kanë pasur një fat të tillë në numër të konsiderueshme sidomos gjatë viteve '90-2000, që njihet edhe si periudhë tranzitore.⁹⁸

Herë të tjera ato e zgjedhin vetë të kryejnë një vepër të tillë, me vullnet të lirë dhe duke njohur gjithashtu faktin që përbën vepër penale të dënueshme. Në shumicën e rasteve, si motiv shërben gjendja ekonomike.⁹⁹

Për ilustrim të një fakti të tillë, shërben edhe një vendim i Gjykatës së Apelit Shkup, konkretisht: "*Shkaqet e parashtuara në ankim nga e pandehura Zerina M.'...Duke patur parasysh **se arsyeja e vetme që e coi të pandehurën në kryerjen e veprës penale ka qenë nevoja ekonomike dhe ky fakt duhet të merret parasysh në dhënien e vendimit përfundimtar si një rrethanë lehtësuese...***"

1.2 Papunesia

Papunësia dhe varfëria në Maqedoni vazhdon të jenë një problem social për faktin se ajo çdoditë e më tepër po ndikon në rritjen e kriminalitetit të organizuar, të korrupsionit, ej.

⁹⁸ A.Mandro, Dhuna në familje, E drejta familjare, botimi i parë, Tiranë, Dhjetor 2006, fq 264

⁹⁹ Prof.Dr. Vasilika Hysi "Kriminologjia", shtëpia botuese Kristalina-KH ISBN 978-99956-43-20-1, Tirane 2010

Sipas ekspertëve për çështje sociale, Qeveria aktuale nuk ka strategji të veçantë për tëparandaluar apo për të ndërmarrë masa për parandalimin e këtyre dukurive që po marrinpërmasa të mëdha.

Papunësia dhe varfëria në Maqedoni vazhdon të jenë një problem socialpër faktin se ajo çdo ditë e më tepër po ndikon në rritjen e kriminalitetit, të korrupsionit, tëprostitucionit, etj.

Ekspertët të cilët merren me studimin e këtyre fenomene vlerësojnë seskamja dhe varfëria po ndikojnë në rritjen e krimit në shoqërinë tonë, sepse të gjitha strategjitëe deritanishme qeveritare për uljen e papunësisë dhe rritjen e punësimit pothuajse kanëëdështuar.Eksperti dhe studiuesi i këtyre fenomeneve shoqërore, prof.dr. Metush Sulejmani deklaroi sepapunësia, gjegjësisht faktori ekonomik ndikon direkt në rritjen e kriminalitetin në shoqëri.

“Rritja e kriminaliteti si dukuri sociopatologjike ndikohet nga shumë faktor, por më peshë më të madhe në paraqitjen e tij ka faktori ekonomik. Shifrat alarmante të papunësisë do tëndikojnë që në të ardhmen të shtohen veprat kriminale në vend. Kohëve të fundit posaçërishttrinia e vendit më shumti është e prekur nga ky fenomen.Eksperti i çështjeve juridike, Osman Kadriu thekson se varfëria ka ndikim në rritjen e veprav kriminale në shoqëri.¹⁰⁰

“Është evidente se varfëria ka ndikim në paraqitjen e kriminalitetit dhellojeve të tij të ndryshme, por nga ana tjetër varfëria nuk mund të vlerësohet nga analehtësuese dhe rrethana e arsyeshme për kriminalitetin.

Shteti juridik nëpërmjet organeve të tijnë vend të parë organet për ndjekje penale dhe gjyqësori është përgjegjës për eliminim dhe luftimin e kësaj dukurie tejet negative të kësaj shoqërie demokratike”.¹⁰¹

Shkalla e papunësisë është 41.5%, ndërsa pjesa më e madhe e popullsisë punon në industri (43.1%); sektori i shërbimeve është gjithashtu shumë i

¹⁰⁰ Intervistë në gazetën ditore “Nova Makedonija” me Osman Kadriun, profesor i drejtësisë, Shkup 10 korrik 2010, në dispozicion në: <http://novamakedonija.com.mk/NeësDetal.asp?vest=71010856167&id=9&prilog=0&setIzdanie=22030>.

¹⁰¹Po aty

rëndësishëm, i cili përfshin 36.7% nga numri i përgjithshëm i të punësuarve; ndërsa pastaj vjen bujqësia, si sektori i tretë në të cilin angazhohen 20% nga të punësuarit.

Shumica e personave të punësuar janë në qytet, për shkak të pozicionimit të kapaciteteve të industrisë dhe institucioneve publike. Shkalla e papunësisë në Berovë është 31.9%.

Nga gjithsej 2681 persona të papunësuar, 1114 (41.6%) janë femra. Papunësia e popullatës së re në moshë prej 15-24 vjeç është 67.3%. Regjioni lindor i të cilit komuna vshtë pjesë është me shkallë më të ulët të papunësisë tek popullata e re në krahasim me regjionet e tjera në Republikën e Maqedonisë.¹⁰²

Tjetër karakteristikë e papunësisë është papunësia afatgjate. Pjesa më e madhe e personave të papunësuar janë punëtorë të pakualifikuar (41.4%), me arsim të mesëm teknik janë 26.9% ndërsa pjesa më e vogël (9.7%) janë persona me arsim të lartë dhe universitar.

Analiza e shkallës së papunësisë sipas grupeve moshore tregon shpërndarje relativisht të barabartë, gjegjësisht në moshë prej 20-29 vjeç të papunësuar janë 575 (21.4%), në moshë prej 30-39 vjeç janë 644 (24%), në moshë prej 40-49 vjeç të papunësuar janë 617 (23%), në moshë prej 50-59 vjeç të papunësuar janë 599 persona (22.3%) nga numri i përgjithshëm i të papunësuarve.

Në moshë mbi 60 vjeç të papunësuar janë 193 persona, ose 7.2% nga numri i përgjithshëm i të papunësuarve. Në Berovë ekonomia e zezë nuk është shumë e përfaqësuar.¹⁰³

1.3 Varferia

¹⁰² Studim për varfërinë dhe ç'kyçjen sociale në Republikën e Maqedonisë: Probleme dhe nevoja sociale në nivel lokal Shkup, mars 2011, fq.100

¹⁰³ Po aty

Varfëria, në kuptimin më të thjeshtë dhe më të logjikshëm nënkupton një gjendje apo një lloj statusi të njerëzve të cilëve u mungojnë mjetet elementare të riprodhimit biologjik e social, apo që gjenden në vazhdimësi në buzë të ekzistencës fizike.

Sot në botën shpjegimeve ekskluzive shkencore, çështja e përkufizimit të kësaj problematike është një mënyrë adresë valide për të kuptuar shkallën dhe statusin e shtresave sociale të një shoqërie bashkëkohore.

Sociologët, duke qenë mjek të këtyre fenomeneve dhe dukurive, varfërinë përpiqen ta identifikojnë më tepër si pjesë të shoqërive marginale, e unë do shtoja edhe shoqërive që gjenden në procesin e transicionit. Shtrohet pyetja përse vendeve të tranzicionit?

Arsyeja e parë ka të bëjë me çështjen kuptimit të varfërisë si mjet mbijetese i shtresave dhe grupeve të ndryshme marginale që secila shoqëri i ka në ambientet e veta, pa marrë parasysh shkallën e zhvillimit dhe emancipimit social, kulturor e ekonomik.

Arsyeja e dytë, ka të bëjë kryesisht me peshën e shtresëzimit të kategorive shoqërore, proces ky që është i natyrës së përkohshme edhe për faktin se këto kategori gjithnjë atakohen nga:

a) Mënyra e rehabilitimit të statuseve ekonomike dhe shtresëzimit social që vjen shkak i procesit tranzitiv në të cilin gjenden ato;

b) Procesit të seleksionimit social (kjo vlen sidomos për vendet postkomuniste që nuk kishin përvojë të segregacionit ekonomik prej nga prodhohen klasat që thënë me gjuhën marksiste e identifikojnë formacionin kapitalist).

2.Dhuna në familje

Krimi në familje është një nocion kriminologjik, i cili nuk shpreh një kriminalitet apo vepër penale të vecantë. Ai përfaqëson tërësinë e kriminalitetit që ndodh në një hapësirë dhe kohë të caktuar në familjet shqiptare. Familja si bashkësi shoqërore ka detyrë dhe funksione të shumëfishta kur bëhet fjale për të miturit përprkundrazi me formimin e tyre dhe zhvillimin e tyre. Përvec sigurimit material dhe kushteve tjera objektive të jetës së femrave ose

meshkujve familja paraqitet edhe si një ndër grupet primare ku realizohet procesi i edukimit dhe socializimit të vepruesve penal.¹⁰⁴

Në shoqërine tonë martesë dhe familja gëzojnë mbrojtje të vecantë gjë që garantohet edhe me kushtetute. Sipas Autorit Zejneli në librin e tij *Delikuenca e të miturve*¹⁰⁵ flitet se si familjet dhe raportet e shëndosha familjare janë gjeneratë e rë e sukseshme për një shoqëri stabile.

Si sjellje dhune në familje ose si kriminalitet të dhunës në familje në literature kriminologjike, zakonisht cilësohen disa forma të dhunës që manifestohen me dhunë në martesë dmth me dhunë në familje.

Në RMV dhuna në familje është e rregulluar me Amandamentet për Kodin Penal të RMV-së pas vitit 2004, në nenin 122, paragrafi 19, sipas të cilës dhuna në familje përkufizohet si torturë, lëndim i rëndë , cënim i siguris, lëndim fizik, lëndim gjinor ose fizik që paraqet frikë, pasiguri ndaj bashkëshorëve, prindërve ose fëmijëve, etj.¹⁰⁶

Dhuna në familje sipas autorit Zejneli thuhet se është degradim i raporteve të gruas dhe burrit shpiejn edhe tek abuzimi i fëmijëve, po ashtu autori në fjalë thekson se prania e dukurive patologjike të prindërve si psh.tek alkoholi, droga, bixhozi, prostitucioni, bredhja dhe sjelljet tjera destructive në dëm të fëmijëve.

Me këtë nocion, sipas kulturës popullore, kuptohen vetëm krimet e vrasjes në familje, kur në fakt ai ka kuptim shumë më të gjerë dhe në të përfshihen të gjitha format e kriminalitetit që mund të ndodhin në atë strukturë shoqërore, qëkonsiderohet familje.¹⁰⁷

Krimi në familje, jo vetëm kohët e fundit, por gjatë viteve të fundit është bërë një dukuri e zakonshme. Në strukturën e këtij kriminaliteti përfshihen një sërëveprash penale si: fyerje, dhunime verbale, fizike, psikologjike e seksuale,

¹⁰⁴R. Halili, *Kriminologji*, Prishtinë, 2016, fq.176

¹⁰⁵ Ismail, Zejneli, *Delikuenca e të miturve*, Tetovë, 2018, fq. 83

¹⁰⁶Po aty, fq.84

¹⁰⁷ Anastasi, A., etj., (2012). *Barazia gjinore dhe mos-diskriminimi*. Tiranë: Botimet Pegi. Fq. 121, 124, 141, 154-155.

plagosje e lehtë apo e rëndë, vjedhje, grabitje, kanosje, marrëdhënie seksuale në gjini, braktisje të foshnjës e deri vrasje.

Kriminaliteti në familje, paraqet një sërë dukurish në vecanti për vendin tone si: egërsia e ashpërsia e mekanizmit kriminal, duke përfshirë motivimin, format, metodat dhe mjetet e kryerjes së krimit; pabesinë, ekzistencën e shkaqeve dhe faktorëve ordinerë deri nëbanalë, ekzistencën e konflikteve të mëparshme, të përsëritura e të njohura, por të pazgjidhura nga faktorët ndikues në familje, shoqëria dhe strukturat shtetërore, të krijuara me ligj, posacërisht për këtë qëllim, gjë që kanë lejuar gjenerimin e këtyre konflikteve deri në ekstrem, vrasjen.

Motivet kryesore që përbëjnë edhe shkaqet kryesore të këtij kriminalitetit janë: xhelozia, ligësia, dëshira e përfitimit të padrejtë e të jashtëligjshëm, prirja për njëjetë parazitare, patriarkalizmi, egoizmi dhe sedra e sëmure, etj.


Viktimat kryesore të krimit në familje në tërësi dhe vrasjeve në vecanti kanë qenë femrat dhe të rinjtë, gjë që nuk përkon me traditën shqiptare, por nuk kanë munguar edhe rastet që këto viktimat të jenë edhe meshkuj.

Ligji për parandalimin e dhunës në familje dhe institucionet në këtë funksion duket se nuk e kanë dhënë ende ndikimin në këtë drejtim.¹⁰⁸ Problemi i parandalimit të krimit në familje, nuk mund të zgjidhet me një shkrim në gazetë.

Për këtë qëllim kërkohen studime të hollësishme kriminologjike dhe investim të gjithanshëm financiar, shoqëror e shtetëro.¹⁰⁹ Është interesante të theksohet se deri në vitet '70, rastet e dhunës spontane të kryera nga gratë përgjithësisht janë shpërfillur nga autoritetet zbatuese të ligjit kudo në botë. Gjatë viteve '70 të shek XX vihet re se u bë një lidhje mes lëvizjes së grave për emancipim dhe një valë të re të dhunës së kryer nga gratë.

¹⁰⁸ Revistë ndërkombëtare e Terapisë së të dënuarve dhe kriminologjia krahasuese, 49, fq. 325-342.

¹⁰⁹ Sofokli Duka-Kriminolog



Burimi: www.moi.gov.mk

Të dhënat statistikore janë ndarë sipas gjinisë së viktimës dhe ushtruesit të dhunës, relacionit mes të dyve, llojit të veprës penale dhe shkeljes dhe sipas vendit ku është raportuar rasti.

Në grafikonin nr. 1 janë prezantuar autorët e rasteve të raportuara të dhunës në familje të ndarë sipas gjinisë. Është e dukshme që në rastet e raportuara, ushtrues dominant të dhunës janë persona të gjinisë mashkullore, ndërsa pjesëmarrja e grave në rastet e raportuara është simbolike në raport me numrin e burrave.

Megjithëse¹¹⁰ faktet nuk i mbështesin këto mendësi, është nxjerrë përfundimi se shumë gra dhe vajza po kryejnë krime të dhunshme për shkak të dëshirës së tyre për të qënë të barabarta me burrat.

Sistemi i Drejtësisë së të rinjve mbështetet në një histori të gjatë të paternalizimit, praktikisht nëse vajzat nuk i nënshtrohen autoritetit atëror dhe largohen nga shtëpia, atëherë mbi to mund të ushtrohen masa sanksionuese më të ashpra në krahasim me djemtë të cilët kryejnë të njëjtat veprime.

Jo në të gjitha rastet shkak i dhunës në familje është faktori ekonomik.

¹¹⁰ Revistë ndërkombëtare e Terapisë së të dënuarve dhe kriminologjia krahasuese, 49, fq. 325-342.

Familja për fat të keq akoma vazhdon të paguajë borxhet e traditës së saj. Fakt i pamohueshëm dhe jashtëzakonisht prezent është që gratë dhe fëmijët po paguajnë haracin kryesor të deformimit të familjes.

2.1 Marrëdhënia e femrave të dënuara me familjarët, fëmijët, bashkëshortin

Një nga problemet me të cilat përballen shoqëritë bashkëkohore sot është paqartësia mbi rolin e gruas dhe të burrit. Gruaja ka rol shumë të rëndësishëm në zhvillimet dhe ndryshimet kulturore në një shoqëri, gjithashtu dhe ndikon drejtpërdrejtë në zhvillimin dhe përparimin e racës njerëzore sepse ajo ka kontakt shumë më të afërt me fëmijët.

Gruaja ka një rol të pazëvendësueshëm në procesin e kujdesit, ajo ka mandatin e të qenit nënë i cili percillet brez pas brezi në mënyrën se si shoqëri të ndryshme socializojnë fëmijët vajza duke bërë që tek ato të lindin apo të shfaqen prirjet e roleve të tyre në tëardhmen si përkujdesëse, mbështetëse etj.¹¹¹

Femrat e dënuara për vrasje rezulton të kenë qënë viktimat të dhunës sistematike në familje. Marrëdhënia me bashkëshortin ka qënë ajo që ka ndikuar më shumë, një marrëdhënie që përkeqësohet gjithnjë e më shumë me kalimin e kohës në ndryshim me raportet me fëmijët apo familjarët e tjerë. Ndërsa të dënuarat për mashtrim dhe për trafikim të lëndëve narkotike kryesisht karakterizohen nga marrëdhënie të mira me pjesëtarët e familjes.

Duke njohur faktin që roli i grave është esencial në proceset demokratike për reformimin, përtëritjen dhe modernizimin e shoqërisë është e domosdoshme që ato të jenë më të përfshira në të gjitha fushat dhe nivelet e përfaqësimit duke i dhënë shanse të barabarta, por edhe duke respektuar realisht të drejtat e tyre, prandaj duhet një përfshirje e të gjithë aktorëve

¹¹¹ Benda, B.,B (2005). Ndryshimet gjinore në teorinë e recedivizmitl një analize për mbijetesë, Revistë ndërkombëtare e Terapisë së të dënuarve dhe kriminologjia krahasuese, 49, fq.325-342

politikë, ligjor, social dhe ekonomik.

Ndërsa në vendin e punës apo në komunitet të gjitha veprimet e mosveprimet janë më të dukshme dhe të prekshme, sepse zbatimi i ligjit varet thjesht nga vullneti pozitiv i drejtuesit apo zbatuesve të tij, pa neglizhuar aspak rolin e individit të cenuar, respektimi i të drejtave të vajzave dhe grave brenda familjes vazhdon të jetë edhe më i vështirë.

Kjo e fundit, edhe për një arsye tjetër, sepse ndërsa për të parën janë rregulla unike dhe të njëjta për të gjithë, brenda familjeve të ndryshme funksionojnë rregulla të pashkruara, por që zbatohen duke u trashëguar brez pas brezi dhe ndryshimet pozitive rezultojnë të jenë shumë të ngadalta.

3.Arsimi

Shkalla e arsimit dhe përgatitjes shkollore ka rëndësi themelore madje të dorës së parë në luftë kundër kriminalitetit, pasi që arsimi sensibilizon njeriun për të dalluar se çka është e mirë dhe çka është e keqe. Me ngritjen e arsimimit, kriminaliteti në forma të ndryshme zvogëlohet.

Janë të rrallë personat me arsimim të lartë që kryejnë vepra penale kundër jetës dhe trupit, kundër lirive dhe të drejtave të njeriut, kundër nderit dhe autoritetit, integritetit seksual, kundër martesës dhe familjes, shëndetit publik, kundër ekonomisë, sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë, mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore, fetare, sigurisë së trafikut publik e tjera (perjashtohen perfaqësuesit politik) i cili konstatim është vërtetuar dhe hulumtuar nga kërkimet empirike që janë kryer nga teoricienët e ndryshëm të shkencave juridike dhe të punëtorëve gjyqësor – gjyqtareve.

Kësisoj theksohet se, edhe në RMV, numrin më të madh të veprave penale e kryejnë personat me arsimim të ulët dhe analfabetë dhe në anën tjetër janë të rrallë personat me arsimim të lartë që kryejnë vepra penale dhe në përgjithësi të prirë për kriminalitet.¹¹²

¹¹²Amir Ymeri, Me arsimim pa kriminalitet, 2009, Shkup fq.77

Pas luftës të vitit 1999, tashti në mileniumin e ri, në kryerjen e kriminalitetit të organizuar me forma të ndryshme tipike të kriminalitetit, flet edhe fakti se në kushtet bashkëkohore që po e karakterizon rritja e arsimit të përgjithshëm dhe të atij privat e shkallës kulturore, nuk e zvogëlon përqindjen e kriminalitetit të disa persona të korruptuar nga arritja e lartë e kulturës materiale dhe të prirë në spekulime, mallverzime dhe makinacionet e ndryshme afariste jashtëligjore që konsiderohen organizator të kriminalitetit kolektiv – kriminel të jakës së bardhë që gjenden kryesisht në radhët e qarqeve të arsimuar më parë në sistemin komunist nga të cilët po ngulfatën reformat e reja demokratike bashkëkohore në RMV.

Në botën bashkëkohore, në kryerjen e kriminalitetit të organizuar në fusha të ndryshme, po rritet pjesëmarrja e bosave të rrezikshëm të cilët kanë njohuri dhe përgatitje të gjithanshme ekonomike, në rrjetin e telekomunikacionit të personave që njohin mirë teorinë e komunikacionit rrugor dhe të transportit, të shërbimeve doganore dhe në veçanti përcjellin njohuritë e ndryshme politike dhe sistemet e komplikuar teknike teknologjike.

Kriminaliteti i organizuar në forma të ndryshme, me rritjen e arsimit të mirëfilltë dhe të shkallës së civilizimit demokratik e të qytetërimit, kriminalitetin në forma të ndryshme e zvogëlon.¹¹³

Pavarësisht, çka do që të thuhet për arsimin dhe kriminalitetin, është një vërtetë e pamohueshme, se të dhënat e ndryshme të statistikave gjyqësore e prokurorive të shumë vendeve tregojnë se pjesëmarrja e personave të paarsimuar ose me shkallë të ulët të arsimit është e madhe në kryerjen e sjelljeve kriminale në shumë vende të botës se sa të ata që janë të arsimuar.¹¹⁴

Mjedisi arsimor e mëson personalitetin si të sillet në familje e në shoqëri. Arsimimi si dukuri shoqërore dhe faktor i përgatitjes shkollë ndihmon përparimin e arritjeve kulturore të gjeneratave në fazën e arsimit dhe inteligjenca si shtresë shoqërore që përbëhet nga personalitete të ndryshme me

¹¹³Amir Ymeri, Me arsimim pa kriminalitet, 2009, Shkup fq.77

¹¹⁴Amir Ymeri, Me arsimim pa kriminalitet, Shkup, 2009, fq.77

aftësi mendore për të dalluar të mirën dhe të keqën në atë shkallë që arrin njeriu në zhvillimin mendor.

Ata persona që veprojnë mirë gjatë jetës, nuk ka arsye që t'i frikësohen të keqes, nëse luajnë me të keqen – jetën nuk do ta kenë të mbarë, por me kriminalitet në forma të ndryshme.

Sipas literaturës kriminologjike janë shpreh pikëpamjet që moti për çështjen e marrëdhënies ndërmjet arësimit dhe aktivitetit kriminal duke u nisur kryesisht nga përgatitja shkollore dhe shkalla e arsimit si kriter të personi që ka arsim e kulturë e i edukuar. se me anë të arsimimit të njerëzve luftohen shumë të këqija shoqërore.¹¹⁵ Me rritjen e arsimimit dhe të shkallës së civilizimit e të qytetimit, kriminaliteti në forma të ndryshme zvoglohet.

Kjo ide dominon në literaturën e (E Ferit, Fergusonit, Mannheimit, Gibbstit, Glueckit etj.). Fergusonit shkon aq larg sa mendon se shkalla e ulët e përgatitjes shkollore përbën faktorin më të fuqishëm të sjelljes delikuede që e përbën shkalla e ulët e përgatitjes shkollore”.

Autorë të tjerë nuk i jepen arsimimit të lartë rëndësi antikriminale, por, përkundrazi mendojnë se arsimimi i lartë mund të jetë faktor i kriminalitetit me veprimtari antiligjore në forma të ndryshme.¹¹⁶

Poashtu, sipas disa autorëve, mjedisi arsimor e pajis personin me njohuri dhe dije të nevojshme për të zhvilluar format e ndryshme të kriminalitetit në disa forma shumë të rrezikshme, ndërsa rrymat optimiste mendojnë se shkalla e arsimit dhe përgatitjes shkollore ka rëndësi themelore madje të dorës së parë në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit, pasi arsimimi sensibilizon njeriun se cilat janë veprimet inkriminuese, kush janë shkatarrët e sjelljeve devijante dhe të kriminalitetit në përgjithësi në format e saj.¹¹⁷

¹¹⁵ Dr. Halili, RAGIP, Kriminologjia, fq.260, Prishtinë, 2011,

¹¹⁶ Po aty, fq.260

¹¹⁷ Dr. Bicaj, KADRI, “SHKENDIJA” – arsimore pedagogjike shoqërore, shkurt 2003

KREU III

1.1 Veprat penale më të përhapura në Republikën e Maqedonisë së Veriut nga ana e femrave

Veprat penale me të përhapura janë Mashtrimi, falsifikimi i dokumenteve, Krimet kundër jetës, vjedhja, prostitucioni.

1.2 Mashtrimi

Punimi nxjerr në pah se veprat penale që kryhen shpesh nga gratë, janë ato që njihen ndryshe si veprat penale të varfërisë, si: mashtrimet, falsifikimet, veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit etj. Fokusi i shumë veprave penale të jakës së bardhë¹¹⁸ është mashtrimi. Megjithatë, mashtrimi nuk është një krim me elemente të përshkruara. Në sistemin federal, nuk ka aktakuzë ose dënim për mashtrim.¹¹⁹ Përkundrazi, si në ligjin anglez, termi "mashttrim" është një "koncept" në thelb të një larmie të statuteve penale.¹²⁰ Krimet e mashtrimit janë konsideruar si vepra penale të cilat dënohen me ligj. Kjo vepër penale prek marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar paprekshmërinë e të drejtës

¹¹⁸ Abraham S. Goldstein, Conspiracy to Defraud the United States, 68 YALE L.J. 405, 408 (1959) (observing that the terms "conspiracy" and "defraud" have taken on very broad and unspecific meanings); Peter Henning, Maybe It Should Just Be Called Federal Fraud: The Changing Nature of the Mail Fraud Statute, 36 B.C. L. REV. 435, 438 (1995) (explaining the expansive nature of the mail fraud statute).

¹¹⁹ ANTHONY ARLIDGE ET AL., ARLIDGE & PARRY ON FRAUD 33 (2d ed. 1996) (introducing a section entitled "The Concept of Fraud," which considers the types of dishonest conduct that may amount to criminal fraud).

¹²⁰ Po aty

së pronës nga pronari ose poseduesi i ligjshëm i saj, në mënyrë që ai ta gëzojë e disponojë atë sipas vullnetit të lirë të tij.

Këto marrëdhënie juridike për vetë rëndësinë e madhe që paraqesin gjejnë mbrojtje para së gjithash në Kushtetutë. Kështu, kushtetuta sanksionon në nenin 11 se prona private, ekonomia e tregut dhe liria e veprimtarisë ekonomike janë shtyllat e sistemit tonë ekonomik. Gjithashtu, në paragrafin 2 të tij sanksionohet se prona private dhe publike mbrohen njëllë me ligj. Pra, si prona private dhe publike gëzojnë një mbrojtje të barabartë. Në vazhdim të mbrojtjes që gjen prona në kushtetutë përmendim nenin 41 që sanksionon se e drejta e pronës private është e garantuar si një nga të drejtat themelore të individit. Po kështu dhe në nenin 42 parashikohet se: Liria, prona dhe të drejtat e njohura në Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

Mashtrimi është një vepër me rrezikshmëri shoqërore jo vetëm nga rëndësia e marrëdhënieve që prek, por edhe nga mënyra se si kryhet kjo vepër, mënyrat që përdoren për të evituar pasurinë. Mashtrimi bën fjalë për një mënyrë më të avancuar, më dinake, të shtënies në dorë të asaj që dëshiron. Pra, vetë mashtrimi përbën një nga shembujt e evoluimit të kriminalitetit që, me forcë ose me dhunë cila do qoftë origjina, bëhet në vazhdim më e mprehtë. Pikërisht edhe kjo temë merr përsipër të trajtojë këtë vepër penale, duke u ndalur veçanërisht në vështrimin historik të kësaj vepre, në kuptimin e kësaj vepre sipas legjislacionit të sotëm, dhe duke u ndalur edhe në problemet që kanë dalë në praktikën tonë gjyqësore.

Sipas profesor Ismet Elezi¹²¹ me mashtrim kuptohet marrja ose hedhja në dorë me anë të gënjeshtërsisë ose të shpërdorimit të besimit, të pasurisë apo të drejtave pasurore të personit fizik, juridik ose të shtetit, të kryera me dashje dhe me qëllim të përfitimit material për vete ose për të tjerë. Kështu siç e shikojmë esenciale në këtë figurë është gënjeshtëria ose shpërdorimi i besimit me anë të së cilës personi (i dëmtuari) shtyhet që të kryejë një veprim, pozitiv ose

¹²¹ Ismet Elezi, "Zhvillimi historik i të drejtë penale", Tiranë 1999.

negativ, që sjell si pasojë një pakësim të pasurisë së tij dhe njëkohësisht një përfitim në favor të mashtruesit ose të një personi tjetër. Ajo që e karakterizon këtë figurë dhe që e dallon nga vjedhja është pëlqimi i dhënë nga viktimat (i rrëmbyer kjo me anën e mashtrimit). Ndërsa tek vjedhja kalimi i pasurisë nga pronari i ligjshëm tek subjekti kriminal realizohet në mungesë dëshire flagrante të pronarit të ligjshëm.

Nëse flasim rreth mashtrimeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut më së shumti janë të përhapura këto lloje:

Femrat në RMV kryejnë mashtrime në subvencione, mashtrime në sigurime, mashtrime në kredi, mashtrime për vepra të artit dhe kulturës, botime të veprës së tjetrit me emrin e vet, riprodhimi i pa të drejtë i veprës së tjetrit.

Për arsye exploruese kemi marrë disa informata në Gjykatën Themelore të Tetovës rreth kësaj çështje.

Mashtrimi	2015	2016	2017	2018	2019
Në subvencione	22	32	13	88	333
Në sigurime	3	2	44	2	55
Në kredi	2	4	2	2	22
Për veprat e artit dhe kulturës	1	0	0	2	4
Botime	1	0	0	2	2

të veprës së tjetrit me emrin e vet					
Ripodhi mi i së drejtës së tjetrit	2	3	1	0	0

Burimi: informata e marrë nga Gjykata Themelore e Tetovës për lëndën mashtrimi gjatë viteve 2015-2019 për qëllime masteri

Rast studimi : Mashtrimi

Krimet kundër pronës janë një formë e veçantë e krimit që konsiston në veprime kriminale të orientuara drejt pasurisë dhe të drejtave të qytetarëve si dhe personave juridikë.

Autorët e këtij lloji të krimeve priren të kërkojnë pronë në emër të tyre, ose të dikujt tjetër dhe për këtë shkaktajnë dëme materiale.

Akti kriminal sa i përket pasurisë kanë origjinën nga kohërat antike, që nga shfaqja e pasurisë personale. Pothuajse nuk ka shoqëri ku ato nuk janë të pranishme, sepse siç u përmend më parë, këto janë veprime kriminale të orientuara drejt pasurisë, e cila nga rruga është e nevojshme për ekzistencën e njerëzve.

Prandaj, aktet kriminale kundër pronës janë të inkriminuara në legjislaturën penale të çdo vendi.

Sipas Kodit Penal të RMV-së¹²² neni 38 kemi vjedhjen e pasurirë më anë të mashtrimit.

Në vendimin nr.122 Data:21.08.2018, Gjykata Themelore e Tetovës ka konstatuar: nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore i pandehuri dhe personi i dëmtuar kanë rënë dakord që ky i fundit t'i jepte të pandehurit një shumë të konsiderueshme të hollash për blerjen e një anije me të cilin do të

¹²² "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 37/96, 80/99, 4/2002, 43/03, 19/04 dhe Vendimi i Gjykatës Kushtetuese: Sl. gazeta 48/01

zhvillonte aktivitet privat, duke marrë përsipër i pandehuri që të kthentetë gjithë shumën e marrë për këtë qëllim.

Pavarësisht se pranohet se anija për të cilën u kërkua shuma e mësipërme u ble prej të pandehurit rezulton se ai nuk e ktheu asnjëherë shumën e marrë prej personit të dëmtuar, pavarësisht se në mënyrë të vazhdueshme, siç rezulton edhe prej dy deklaratave noteriale, ka pranuar marrjen e shumës dhe shlyrjen e detyrimit në mundësinë e parë që do t'i jepet ...Vepra penale e “Mashtimit”, quajtur ndryshe edhe “pandershmëri e llogaritur përtë përfituar”, duhet të konsiderohet e konsumuar kur arrihet të provohet se veprimete të pandehurit përfshijnë elementë të natyrës së mëposhtme: - deklarata e rreme e një fakti material; - dijeninë nga ana e të pandehurit se deklarata është e pavërtetë; - qëllimi i të pandehurit për të mashtruar viktimën e supozuar; - bazueshmëria e justifikuar e viktimës së supozuar në deklaratën e të pandehurit; dhe - dëmi i shkatuar viktimës së supozuar prej mashtrimit.

Të gjithë këta elementë përgjithësisht duhet të ekzistojnë së bashku në momentin e lidhjes së marrëveshtjes me personin e dëmtuar. Deklarata e rreme duhet të lidhet me një fakt material dhe njëkohësisht duhet të ndikojë në mënyrë thelbësore në vendimin e një personi përtë hyrë në një marrëdhënie/kontratë, apo ndjekur një rrjedhë të caktuar veprimi.

Një deklaratë e rreme mbi një fakt, e cila nuk ndikon në mënyrë thelbësore mbi transaksionin/marrëdhënien, nuk do të konsiderohet mashtruese. I pandehuri duhet ta dijë që deklarata është e rreme.

Një deklaratë që është thjeshtë e gabuar nuk është mashtruese. Për të qenë mashtruese, një deklaratë e rreme duhet të bëhet me qëllim për të mashtruar viktimën. Gjatë gjykimit të çështjes prej gjykatave të të dyja palëve, i pandehuri vazhdimisht ka pretenduar se nuk ka dashur të përfitoj pa të drejtë shumën e dhënë prej personit të dëmtuar. Ai ka pranuar se, pavarësisht mungesës fillimisht të një kontrate formale midis palëve, ata kanë pasur një marrëveshtje huamarrje dhe se ai vazhdimisht ka njohur dhe pranuar detyrimin që buron prej saj nëpërmjet akteve noteriale të hartuara e nënshkruar më pas mosshlyerja e detyrimit prej tij ndaj personit të dëmtuar ka

ardhur vetëm për shkak të pa mundësisë objective që ai ka pasur për shlyerje (paafëtësisë së tij të paguese)dhe jopër shkak të mungesës së vullnetit. Marrëveshtja midis paleve ka elementët tipikë të një marrëdhënie juridiko civile, kontrate huamarrje,detyrimet e të ciles nuk janëpërmbushurprejpalës huamarrëse.Mungesa e shlyerjessë detyrime prej huamarësit,të pandehur,qoftë edhe me keqebesim,nuk çon në konsumimin e veprës penale te mashtrimit pasi nuk vërtetohet ne asnjë moment fakti se i pandehuri “me dashje dhe nëpërmjet gënjeshtërs ose shpërdorimit të besimit” t’i ketë vjedhur pasurinë të personit të demtuar.Pavarësisht marrjes së shumës prej personit të demtuar nuk rezulton e provuar se në momentin e bërjes së propozimit për marrjen e shumës apo dhe në momentin e marrjes së saj,i pandehuri të ketë parashtruar faktet të pavërteta materiale meqëllim vjedhjen e përsoneit të dëmtuar.¹²³

Shënim: Në vendimin e mëposhtëm i pandehuri është deklaruar fajtor pasi nëpërmjet mashtrimit ka marre para kundrejt premtimit për të kaluar jashtë kufijve shtetërore përsonea të ndryshëm duke gënjyer se do ti paiste me viza.

1.2 Falsifikimi i dokumentave

Falsifikimi i dokumentit të identitetit është procesi me të cilin kopjohen dhe / ose modifikohen dokumentet e identitetit të lëshuara nga organet drejtuese nga persona të paautorizuar për të krijuar dokumente të tilla ose për t'u përfshirë në modifikime të tilla, me qëllim të mashtrimit të atyre që do të shikonin dokumentet në lidhje me identitetin ose statusin të bartësit.¹²⁴Termi përfshin gjithashtu veprimtarinë e marrjes së dokumenteve të identitetit nga organet drejtuese duke falsifikuar dokumentacionin e kërkuar mbështetës për të krijuar identitetin e dëshiruar. ¹²⁵ Duhet të bëhet një dallim midis përdorimeve të ndryshme të një dokumenti identiteti. Në disa raste, letërnjoftimi i rremë mund të duhet të kalojë vetëm një inspektim të

¹²³ Ismet Elezi, “Zhvillimi historik i të drejtë penale”,Tiranë 1999.

¹²⁴ Buchanan, James D. R.; Cowburn, Russell P.; Jausovec, Ana-Vanessa; Petit, Dorothée; Seem, Peter; Xiong, Gang; Atkinson, Del; Fenton, Kate; Allwood, Dan A.; Bryan, Matthew T. (2005). ["Fingerprinting' documents and packaging"](#). *Nature*. **436** (7050): 475. doi:10.1038/436475a. ISSN 1476-4687. PMID 16049465.

¹²⁵ Bennett, Colin John; Lyon, David (2008). [Playing the Identity Card: Surveillance, Security and Identification in Global Perspective](#). Routledge. ISBN 9780415465632.

përkohshëm, siç është ndezja e një karte identiteti plastike për një roje sigurie. Në ekstremin tjetër, një dokument mund të duhet t'i rezistojë shqyrtimit nga një ekzaminues i trajnuar i dokumentit, i cili mund të jetë i pajisur me mjete teknike për të verifikuar biometrinë dhe leximin e veçorive të fshehura të sigurisë brenda kartës. Për ta bërë falsifikimin më të vështirë, shumica e ID-ve moderne përmbajnë karakteristika të shumta të sigurisë që kërkojnë pajisje të specializuara dhe të shtrenjta për t'u kopjuar. ID-të e shkollës zakonisht janë më të lehta për t'u falsifikuar, pasi ato shpesh nuk kanë të njëjtin nivel të masave të sigurisë me ID-të e lëshuara nga qeveria.¹²⁶

Kartat moderne false të identitetit pothuajse gjithmonë mbajnë një fotografi të përdoruesit të autorizuar, një formë e thjeshtë dhe efektive e identifikimit biometrik. Sidoqoftë, falsifikimi i kartave themelore të fotografisë fotografike është bërë i thjeshtë në vitet e fundit me disponueshmërinë e printerëve, skanerëve dhe softuerëve për redaktimin e fotove me rezolucion të lartë. Kartat themelore të rreme të identitetit bëhen zakonisht duke përdorur një printer me bojë ose lazer për të shtypur një dokument kopje i cili më pas petëzohet për t'iu ngjajtur një karte ID të vërtetë. Shumica e dizenjove bëhen duke përdorur programe kompjuterike, duke rikrijuar kopjet e skanuara të licencës.

Tanimë dihet botërisht se në Republikën e Maqedonisë janë prodhuar dhe janë dhënë në mënyrë të paligjshme me mijëra letërnjoftime të falsifikuara, me të cilat janë pajisur mijëra persona nga Pusteci, disa vendbanime të tjera në Republikën e Shqipërisë dhe nga vendet tjera fqinje, të cilat janë përdorur me qëllim të mbushjes së Listës së përgjithshme të votuesve në Maqedoni.

Dyshohet se me letërnjoftime të dyfishta, të falsifikuara, janë pajisur edhe një pjesë e madhe qytetarëve vendës, duke u evidentuar nga dy herë në listat e votuesve, në vendlindjet e tyre dhe në vendbanimet ku kanë jetuar, ose vazhdojnë të jetojnë aktualisht.

Sipas organeve kompetente, raste të shumta janë zbuluar në Kërçovë, Resnje dhe qytete të tjera, ku sipas këtyre dokumenteve të identifikimit, atyre u

¹²⁶ Bennett, Colin John; Lyon, David (2008). *Playing the Identity Card: Surveillance, Security and Identification in Global Perspective*. Routledge. ISBN 9780415465632.

është caktuar edhe vendbanimi i rrejtshëm. Shumë raste të këtilla janë zbuluar, si në shtëpinë e një funksionari partiak në Prespë (P.T.), në shtëpinë e të cilit janë regjistrojnë 20 persona, në shtëpinë e drejtorit të gjimnazit të Kërçovës (B.S.) janë regjistruar 18 persona, në Komunën Qendër të Shkupit, në disa adresa janë regjistruar 424 persona vetëm nga Pusteci, si dhe shumë raste të tjera.¹²⁷

Sa është numri i saktë i këtyre personave të pajisur me letërnjoftime të falsifikuara, këtë përgjigje nuk mund ta japin as organet e pushtetit, pa u zhvilluar hetime të hollësishme në lidhje me këtë skandal.¹²⁸

Edhe institucionet kompetente në Maqedoni kanë pranuar publikisht se bëhet fjalë për një numër të pa verifikuar të letërnjoftimeve të falsifikuara, me këtë edhe parashtrohet dilema se ku qëndron arsyeja që numri i votuesve është gati i barabartë me numrin e përgjithshëm të popullsisë në Maqedoni.

Mediumet vendëse deri më tani kanë dhënë shumë dëshmi konkrete për numrin e votuesve nga brenda dhe jashtë vendit, të cilët ditën e votimit qarkullojnë nëpër Maqedoni duke votuar disa herë.

Tashmë është vërtetuar se në Maqedoni janë dhënë në mënyrë të paligjshme një numër i madh i letërnjoftimeve, edhe pse zyrtarisht flitet për një numër prej vetëm 30 mijë sosh, dyshohet se ky numër është shumë më i madh dhe shkon deri në disa qindra mijë.¹²⁹

Në bazë të parashikimeve nga ekspertët e fushës përkatëse, numri i letërnjoftimeve të falsifikuara mund të jetë mbi 200 mijë, për aq sa është dallimi mes numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe numrit të votuesve në Listën e përgjithshme të votuesve në Maqedoni.¹³⁰

Nga organet kompetente në Maqedoni është bërë publik gjithashtu edhe skandali me prodhimin e paligjshëm të pasaportave, të cilat jenë përdorur nga votues të paligjshëm, edhe atë, në disa cikle zgjedhore në të kaluarën. Kjo praktikë edhe pse është zbuluar gjatë këtij viti, besojmë se nuk është risi në

¹²⁷ Po aty

¹²⁸ Draft, Falsifikimi i dokumentave në Maqedoni, praktikë e kahershme në vendin tonë

¹²⁹ Po aty

¹³⁰ Po aty

këtë vend, duke pasur parasysh parregullsitë e shumta të evidentuara në ciklet zgjedhore të mëhershme.¹³¹

Prodhimi i këtyre dokumenteve të falsifikuara, letërnjoftimeve dhe pasaportave, nga organet kompetente thuhet se është realizuar në një fabrikë brenda vendit dhe tanimë është lëndë e hetimeve nga Prokuroria Publike Speciale.

Tanimë është pranuar edhe botërisht se skandali me numrin e madh të letërnjoftimeve dhe pasaportave të falsifikuara e dëmton rëndë procesin zgjedhor në Maqedoni, e komprometon shtetin në arenën ndërkombëtare dhe me këtë vihet në pikëpyetje procesi i integritetit të vendit në strukturat euroatlantike.

Si mund të shpjegohet ky skandal me prodhimin dhe pajisjen me letërnjoftime dhe pasaporta të falsifikuara disa mijëra personave nga jashtë, kurse nuk u jepet shtetësia dhe pajisja me këto dokumente personale e afër 50 mijë qytetarëve vendës, të cilët e meritojnë atë sipas ligjit? A mos vallë kjo ndodh vetëm pse ata janë shqiptarë?!

Pushteti në Maqedoni njihet edhe për shumë forma dhe teknika të tjera për falsifikimin e zgjedhjeve. Në fillim të këtij viti, ndërmjetësi i Bashkimit Evropian për zgjidhjen e krizës politike në Maqedoni, Piter van Hojte, i cili u shpall person i padëshirueshëm (non grata) nga pushteti aktual në Maqedoni, pat deklaruar se Maqedonisë i duhen së paku dy vjet për eliminimin e këtyre anomalive për krijimin e kushteve normale për zgjedhje të lira, të drejta dhe demokratike, ndërsa udhëheqësit e subjekteve politike të shqiptarëve u ngutën se kush më parë të merr pjesë në zgjedhjet parlamentare dosido, të 11 dhjetorit 2016, vetëm sa për t'u instaluar në organet e pushtetit, pa i llogaritur pasojat e mëvonshme për qytetarët që ata do t'i mbështesin me votën e tyre në këto zgjedhje!

¹³¹ Po aty

Sipas kësaj që u tha më lartë mund të themi se në punimin tim të masterit kemi marrë një drejtim të falsifikimit të dokumenteve ku kemi hasur femra që kanë realizuar këtë veprër penale.

Sipas të dhënave të marra në Gjykatën Themelore të Tetovës rreth falsifikimit të dokumentavë gjatë periudhës 2015-2018 kemi hasur 177 raste ku vepruesit kanë qenë femra.

Mendojmë që realizimi i këtyre veprave penale është realizuar si shkas i keqpërorimit të detyrës.

	2015	2016	2017	2018
Letërnjoftime	33	22	50	22
falso				

Burimi: dokument i marrë nga Praktika Gjygjësore në Tetovë, për falsifikimin e dokumenteve (rastet janë marrë për qëllim të këtij punimi master)

1.3 Krime kundër jetës

Në këtë punim kemi realizuar idenë tonë kryesore rreth krimeve kundër jetës që janë paraqitur në vendin tonë. Pikë së pari kemi sqaruar nocionin e krimeve kundër jetës pastaj kemi rishuar raste të krimeve kundër jetës që kanë realizuar femrat. Veprat penale kundër jetës dhe trupit janë vepra më të rënda në krahasim me veprat e tjera sepse ato çënojnë të drejtën për të jetuar si një drejtë më e çmueshme dhe një e drejtë më themelore e garantuar me kushteture si dhe me akte ndërkombëtare.

Më këto vepra penale shkelet e drejta më e çmuar e njeriut e ajo është e drejta për të jetuar e cila mund të merret nga dikush tjetër me dashje ose me pakujdesi. Jeta e njeriut vihet në rrezik sikurse më armë zjarri poashtu edhe me mjete tjera të rezikshme duke filluar nga armët e ftohta e deri tek helmet e ndryshme.¹³²

Krimet ndaj jetës dhe trupit në shekncën juridiko-penale dhe atë kriminologjike cilësohen si një ndër format më të rënda të atakimit të vlerave

¹³² Ismail, Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë, 2018, fq. 75

dhe të mirave me të shtrejta të njeriut megjithëse ato në masën e përgjithshme të krimeve nuk janë edhe aq massive.¹³³

Vrasja në Kodin Penal të RMV-së është përkufizuar në formë të thjeshtë si privimi i jetës nga personi tjetër. Ai që tjetrin e privon nga jeta dënohet me burgim prej së paku 5 vite.¹³⁴

Në kodin penal të RMV-së janë paraparë disa forma të vrasjeve, vrasje në mënyrë tinzare, vrasje me dashje, me çrast rrezikohen jeta e personave, vrasja me qëllim të fitimi të dobisë pasurore, vrasja me qëllim të kryerjes apo fshehjes së ndonjë veprë tjetër penale, vrasje nga hakmarrja etj,¹³⁵

Kërcënimi për jetën e njeriut është ndër më të mëdhenjtë që bota ndonjëherë ka hasur gjatë historisë, dhe ai po zhvillohet me një ritëm të hatashëm. Me anë të këtij punimi unë do të provoj të japë një shpjegim dhe analizë të këtij fenomeni rrezikues që sa vjen e rritet numri i veprave penale të rënda kundër jetës dhe trupit të njeriut.

Përmbajtja e punimit do të jetë e tillë, që deri në një masë të krijohet një ide se çka është ky fenomen në pikëpamje krahasuese cilët janë faktorët që ndikojnë në shuarjen e jetës së njeriut, prej nga ka ardhur ky fenomen këndvështrimin historik, çfarë ishte në fillimet e tij e çfarë është sot? Gjitha këto në një farë formë tentojnë të japin një sqarim në pikëpamje juridike dhe etiologjike të veprave penale kundër jetës dhe trupit të njeriut.¹³⁶

Gjatë studimeve të deritanishme, më duhet të pranoj se më kanë tërhequr veçanërisht disiplinat shkencore në fushën e së drejtës penale. Por, interes të posaçëm për mua paraqet disiplina qendrore në këtë fushë të së drejtës, sikurse është e drejta penale (studimi i thelluar i instituteve themelore të saj). Bazën e përgjegjësisë penale e përbën prania e veprës penale.

Ndërsa kushtin paraprak apo parakushtin e saj, e përbën përcaktimi i figurës së veprës penale konkrete, e cila parashikohet në dispozitën, konkrete

¹³³Po aty, fq.75

¹³⁴Kodi Penal i RMV-së neni 123, al.1

¹³⁵ Ismail, Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë, 2018, fq. 76

¹³⁶ Bashkim Dr. Selmani "Krimi i Organizuar dhe Terrorizmi ndërkombëtar" Botues: Universiteti parë privat „FON”- Shkup, 2008

të pjesës së posaçme të Kodit Penal ose të ligjeve të posaçme penale. Pikërisht, në dispozitën konkrete të pjesës së posaçme të Kodit Penal, të RMV-së ¹³⁷në të cilën parashikohet figura e veprës penale konkrete apo lloji konkret i veprës penale, për kryerjen e së cilës do të akuzohet personi apo personat e dyshuar si autor të veprës penale, rast pas rasti gjendet edhe lloji edhe masa e dënimit penal, e cila mund të caktohet nga gjykata, nëse, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, personi i akuzuar gjendet fajtor.¹³⁸

Por, në vetvete çfarë është figura e veprës penale? A do të konsiderohet figura e veprës penale kategori më vete e së drejtës penale, e veçantë nga kategoria tjetër e kësaj disipline të së drejtës, sikurse është vepra penale, nga e cila rrjedh, apo është plotësuese e kësaj të fundit? Pavarësisht përgjigjes, të cilat do të marrin pyetjet e mësipërme dhe, shume të tjera si këto, ajo që mendoj se duhet vënë theksi është fakti se, është pikërisht figura e veprës penale, ajo e cilagaranton zbatimin në praktikë të parimit universal, që në kohën e së drejtës Romake Siç dihet, e Drejta Penale përkufizohet si tërësia e normave juridike e cila ka për objekt studimin e veprës penale, të figurës së saj dhe të llojeve e masave të dënimit që caktohen, nga gjykata, ndaj autorëve të tyre.

Nga ky përkufizim del që e Drejta Penale merret me studimin e një fenomeni të caktuar shoqëror, fenomen ky që nuk është gjë tjetër, veçse cenimi i interesave të ligjshme të shtetit dhe të individëve, përfshirë edhe personat juridik në përgjithësi. Nuk është gjë tjetër, veçse ai që quhet ndryshe edhe “fenomeni penal”. ¹³⁹Përmbajtja e fenomenit penal përbëhet nga vlera shoqërore, cenimi i këtyre vlerave dhe reagimi i shoqërisë ndaj këtij cenimi, nëpërmjet dënimit të tyre. Mirëpo, jo cenimi i të gjitha vlerave shoqërore, përbën objekt studimi të së Drejtës Penale. Përbëjnë objekt studimi të kësaj dege të së Drejtës, cenimi i atyre vlerave, të cilat shoqëria, në një periudhë të caktuar kohe, i konsideron si vlera më të rëndësishme të saj. Pikërisht për këtë

¹³⁷ Afrim Dr.Osmani “Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë– teksti integral, i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime” Shkup, 2010.

¹³⁸Po aty

¹³⁹ Ismet Dr. Elezi & Vasilika Hysi “Politika Kriminale” Tiranë, 2001.

arsye, ajo i merr në mbrojtje në mënyrë të veçantë, nëpërmjet dënimit penal me llojet dhe masat e ndryshme të tij, të cilat parashikohen në ligj për personat që i cenojnë apo vënë në rrezik për t'i cenuar këto vlera. uhej, nullum crimen nullum poena sine lege, scripta (nuk ka krim nuk ka dënim pa ligj të shkruar).

1.4 Vjedhja

Me kriminalitet kundër pasurisë nënkuptohet të gjitha veprimet që çenojnë dhe rrezikojnë pasurinë private dhe shtetërore. Këto krime bëjnë pjesë në kriminalitetit klasik dhe kjo nuk do të thotë se format e paraqitjes së disa krimeve kundër pasurisë nuk kanë pësuar ndryshime.¹⁴⁰

Nëse flasim në mënyrë subjektive, vjedhja ndodh me dashje e cila në vete duhet të ngërthejë edhe vetëdijën e kryesit të veprës penale (femrave). Krimet kkriminologjike për dukurinë e vjedhjes vecmmas kundër pasurisë tregojnë se kryesit në të shumtën e rasteve janë persona të rinjë të mitur e në disa raste paraqiten edhe femrat.¹⁴¹

Çdo shoqëri që posedon strukturë të mirëfilltë juridike dhe rend qytetar e ka obligim që t'i studiojë dukuritë negative që e kërcënojnë rendin dhe qetësinë, në mënyrë që ta bëjë vlerësimin real të gjendjes së tyre. Këtu fillon rëndësia dhe nevoja e këtij studimi. Sepse, rritja e dukurive negative në shoqëri e, po ashtu, edhe rritja e rasteve të veprës penale, “vjedhje e rëndë”, i kërcënon vetë qytetarët, sigurinë e tyre, pasurinë e tyre, e, të cilët, në të njëjtën kohë, humbin edhe besueshmërinë në institucionet e shtetit apo te të ashtuquajturat organe të judikaturës.

Duke e pasur parasysh se vendi ynë ka kaluar në një tanzicion shoqëror, ekonomik dhe politik, dhe ndryshimet që janë bërë në legjislacionin penal, vërehet qartë se kryerja e veprës penale, “vjedhje e rëndë”, ka qenë një dukuri mjaft e përhapur, që, nga viti në vit, ka pësuar disa lëkundje të vogla, por, gjithmonë, si dukuri, edhe pse e ndaluar, ishte e pranishme. Në kryerjen e kësaj vepre kanë ndikuar faktorët e ndryshëm, siç janë: papunësia në shkallë të madhe, mungesa e vetëdijesimit, përgatitja e ulët arsimore, kushtet e

¹⁴⁰ Ismail, Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë, 2018, fq. 105

¹⁴¹ Po aty, fq.108

vështira ekonomike etj. Për këtë arsye, edhe sanksionet e parapara për veprat e tilla penale kanë për qëllim rehabilitimin dhe krijimin e kushteve jetësore, nëpërmjet të cilave, kryerësve të veprës penale, u mundësohet rehabilitim dhe risocializim, duke synuar rritjen e vetëdijes për t'i respektuar ligjet në fuqi.

Kërcimi në veturë (kamion-tren) derisa ai është në lëvizje dhe hedhja e sendeve dhe prapë zbritja nga ai automjet-tren, hyrja në shtëpi, banesë dhe vjedhja e pasurisë së luajtshme, kur personat nuk janë në shtëpi ose gjatë kohës sa ata janë në gjumë, hyrja në lokale të caktuara gjatë kohës kur është i hapur dhe fshehja në të, me qëllim që, kur të largohen të gjithë punëtorët, kryerësi, atëherë do ta kryejë veprën penale apo në raste kur kryerësi e thyen lokalin dhe hyn brenda për ta marrë pasurinë e luajtshme, pastaj atëherë kur vjedhja realizohet duke thyer me forcë ndërtesat e mbyllura ose duke hequr pengesat e tjera, me qëllim të përvetësimit të pasurisë së luajtshme.

Është e rëndësishme të theksohet se thyerja me forcë e hapësirave të mbyllura nënkupton hapjen, depërtimin, kapërcimin e pengesave dhe hyrjen me forcë në objektet e mbyllura apo në hapësira të mbyllura, pa vullnetin e pronarit apo poseduesit. Kjo është, p.sh., kur në një ndërtesë depërtohet brenda duke e thyer portën, duke e thyer dritaren, duke hapur ndonjë zgavër, duke e thyer drynin e valixhes, duke e hapur me forcë portën e arkës e të ngjashme. Po ashtu, si formë e kryerjes së veprës penale vjedhje e rëndë, duke u bazuar në praktikën gjyqësore dhe sipas disa autorëve të së drejtës penale, nënkupton depërtimin në hapësira të mbyllura pa e dëmtuar substancën e objektit, duke i kapërcyer pengesat, p.sh. hyrja nëpërmes ndonjë zgavre, kalim mbi mur etj. Andaj, me depërtim nënkuptohen të gjitha format e hyrjes së kundërligjshme në hapësirat e mbyllura, qoftë ato me përdorimin e forcës ose dëmtimit të pengesave, respektivisht, me kapërcimin e tyre me qëllim që në atë mënyrë të arrihet deri te pasuria e huaj, e luajtshme.¹⁴²

¹⁴² Salihu.I, Zhitija.H, Hasani.F, Komentari i Kodit Penal, Prishtinë, 2014, fq. 903

Në të thuhet: “Kryerësi i veprës penale është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia”.¹⁴³

Vjedhja e rëndë është vepër e kundërligjshme penale, pasi që, me veprime të tilla, shkelen normat e ligjit penal, që e ndalojnë ndonjë veprim apo të ashtuquajturat normat prohibitive. Sikurse te veprat e tjera penale edhe te vepra penale vjedhje e rëndë vlen e njëjta, meqë sanksioni do të shqiptohet vetëm ndaj personit, i cili në momentin e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjëshëm dhe i fajshëm, pra ka qenë i vetëdijshëm dhe nuk i ka munguar elementi intelektual dhe volitiv për t’i kuptuar veprimet e tij.

	2015	2016	2017	2018
Vjedhja	2112	321	2311	1233

Burimi: document i marrë nga Praktika Gjygjësore në Tetovë, për vjedhje (rastet janë marrë për qëllim të këtij punimi master)

1.5 Prostitucionit

Fenomeni i prostitucionit në shoqërinë tonë para dhe pas formimit të shtetit kombëtar, nuk është bërë objekt trajtimi nga studiues dhe, si pasojë, fondi i studimeve për këtë temë është thuajse i zbrazët. Fenomeni i trafikimit të qënieve njerëzore përbën anën më të erët që ka shoqëruar dhe po shoqëron proceset globalizuese.

Si një formë veçanërisht abuzive e krimit ekonomik, tiparet themelore të kësaj dukurie kanë mbetur të pandryshuara këto vitet e fundit; viktimat rekrutohen nga vendet e pazhvilluara nga pikpamja ekonomike dhe transportohen në vendet e destinuara që janë më të pasura, ose në vende ku janë vendosur të pasurit e vendeve të destinacionit.¹⁴⁴

Format e shfrytëzimit, nga të cilat burojnë fitimet e jashtëzakonshme, janë nga më të ndryshme, por të gjitha ato kanë në bazë të tyre ushtrimin e

¹⁴³ Salihu. I, vep.e.cit., fq. 277.

¹⁴⁴ ["Prostitution – Definition and More from the Free Merriam-Webster Dictionary"](#). Merriam-Webster. Retrieved 19 September 2013.

shfrytëzimit dhe të abuzimit të qënieve njerëzore. Këto forma mund të variojnë nga shfrytëzimi për qëllime seksuale apo pune, në shërbime skllavëruese si punëtore shtëpijake, punëtore nëpër agjensi kriminale, për dhurim organesh, për shërbimin ushtarak të detyruar apo shërbime të tjera të detyruara dhe martesë të ndërmjetësuar.¹⁴⁵

Trafikimi për shfrytëzim seksual mbetet kategoria më e gjerë që e përbën këtë krim, për arsyen e thjeshtë që ky shërbim gjithmonë do të gjenerojë të ardhurat më të mëdha për trafikantët. Ndërsa format e tjera të trafikimit, si shfrytëzimi i punës, futja në një agjensi kriminale dhe dhurimi i organeve vazhdojnë të rriten, fakt mbetet që shfrytëzimi i një femre të re dhe i fëmijëve në industrinë e seksit të vendeve më të pasura, gjeneron shumë më tepër të holla se sa shfrytëzimi i qënieve njerëzore si skllavër pune, apo se një pagesë e njëhershme për heqjen e një veshke.

Përtej rekrutimit, fazat pasuese e këtij procesi është përgatitja psikologjike dhe fizike për të ushtruar profesionin e prostitutës, lëvizja drejt destinacionit, mbërritja dhe fillimi i aktivitetit. Pavarësisht nga mënyra e rekrutimit, synohet kalimi në këto faza për të realizuar përgatitjen graduale të femrës për të ushtruar profesionin e ardhshëm.

Si mjete ndihmuese për arritjen e këtij qëllimi janë përdorimi i drogës dhe vartësia prej saj, përfshirja në aktivitete seksuale të dhunshme e në grup, përfshirja në vepra të lehta penale, apo të pamoralshme, dhuna fizike, apo psikike, etj. Është ky një proces që trafikantët e quajnë degjenerim, për ta pasur më të lehtë përdorimin e viktimës së trafikuar si mjet shfrytëzimi dhe pasurimi për ta.

Lëvizja për qëllim trafikimi parakupton marrjen e femrës nga vendbanimi dhe përgatitja e kushteve për të realizuar mbërritjen në destinacion. Këtu hyjnë angazhimet për të siguruar dokumentet më të domosdoshme, si vizat, lejet e qëndrimit dhe vend-qëndrimet, duke i siguruar dhe mbajtur ato nën kontroll,

¹⁴⁵ Brewer, DD; Potterat, JJ; Garrett, SB; et al. (October 2000). ["Prostitution and the sex discrepancy in reported number of sexual partners"](#). *Proc. Natl. Acad. Sci. U.S.A.* **97** (22): 12385–8.

nëpër baza të sigurta. Me mbërritjen në destinacion sigurohet vend-qëndrimi, “vendi i punës” dhe detyrimi për të ushtruar profsionin.¹⁴⁶

Gjithë veprimet e përmendura janë direkt, prandaj edhe që “lenë gjurmë” ose prova në mjedisin ku kryhet. Kjo mundëson parandalimin apo zbulimin nga ana e organeve kompetente dhe vënien e tyre para drejtësisë.

Duke njohur format dhe metodat e përdorura nga trafikantët gjatë këtij procesi, shoqëria dhe sidomos vetë femrat, por edhe të afërmit apo kujdestarët e tyre, i kanë të gjitha mundësitë e kontrollit dhe vetëkontrollit, për mos lejuar viktimizimin përmes këtij lloj trafikku. Megjithatë, kultura e nevojshme në këtë drejtim ende është e mangët, prandaj në kurthet e trafikimit vazhdojnë të bien viktimat e rastit. Sa i përket tipareve social - gjeografike, përgjithësisht, mund të themi sa ato janë me arsim fillor ose tetëvjeçar, por jo se mungojnë edhe ato me arsim të mesëm e të lartë.¹⁴⁷

Niveli kulturor i tyre, pavarësisht nga arsimi, është i ulët dhe shumica kanë jetuar në mjedise familjare me probleme sociale, si p.sh., në familje të paqëndrueshme, me mungesë të njërit prind, me probleme ekonomike të rënda, me dhunë fizike apo seksuale etj.,.

Pra përgjithësisht, rezulton që familje e tyre nuk kanë qenë në gjendej të realizojnë funksionet e tyre themelore. Mosha mesatare e femrave të trafikuar rezulton 21 vjeç, gati 95% e tyre kanë qenë të pamartuara më parë, ndërsa jetën seksuale e kanë filluar herët. Fluksi i të trafikuarave ka pasur një ecuri konstante gjatë gjithë viteve, me një mesatare të përafërt prej 30 në vit. Madje, pas kthimit të tyre masiv nga policia italiane, e disi më pak nga ajo greke, në vend që ky numër të pësonte ulje, u rigjallërua, gjë që tregon se mjaft nga të rikthyerat u ricikluan nga rekrutuesit apo tutorët e tyre.¹⁴⁸

¹⁴⁶ Brewer, DD; Potterat, JJ; Garrett, SB; et al. (October 2000). ["Prostitution and the sex discrepancy in reported number of sexual partners"](#). *Proc. Natl. Acad. Sci. U.S.A.* **97** (22): 12385–8.

¹⁴⁷ Bullough, Vern L.; Brundage, James A. (1994). ["Sexual Practices and the Medieval Church"](#). Prometheus Books. [ISBN 9780879752682](#).

¹⁴⁸ Castillo DN, Jenkins EL (February 1994). "Industries and occupations at high risk for work-related homicide". *J Occup Med.* **36** (2): 125–32. [doi:10.1097/00043764-199402000-00006](#). [PMID 8176509](#).

Në sistemin e tregtisë së seksit përfshihen personat që “gjurmojnë” kandidatët e përshtatshëm e që do planifikohen për rekrutim. Pastaj janë dhe personat që ndihmojnë direkt apo indirekt në këtë qëllim, ku hyjnë rekrutuesit, bashkëpunëtorët ndihmës, si transportues, shoqërues, strehues, rojet, kujdestarët, tutorët etj, mbi të cilët qëndron “kapua/kreu” apo “kupola”, që përgjithësisht është një person i padukshëm.¹⁴⁹

Nëse ekzistojnë elementet e mësipërm, në të gjitha rastet kemi të bëjmë me bashkëpunim të cilësuar kriminal, pa folur pastaj për nivelin më të lartë të organizimit kriminal. Si rregull, rrjetet e trafikut të “mishit të bardhë” përbëhen nga elemente me prije kriminale, që krahas prostitucionit kanë kryer edhe vepra të tjera kriminale, si trafikim droge, vrasje, peng marrje, grabitje etj.

Shtrirja gjeografike e elementëve të tillë është e pranishme në gjitha rrethet e vendit. Mosha mesatare e tyre varion nga 20-25 vjeç, me formim arsimor e kulturor të kufizuar ose të mangët, që shquhen për agresivitet dhe ashpërsi mendimi e veprimi. Qoftë dhe për sa më sipër, janë të gjitha shanset që këta të jenë evidentuar dhe kontrolluar nga policia, pavarësisht inefiçencës aktuale të sistemit të drejtësisë në luftën ndaj tyre.¹⁵⁰

Sidoqoftë, statistikat flasin për një optimizëm të përmbajtur. Kështu, gjatë vitit 2001 janë konstatuar 113 raste trafikimi të femrave për prostitucion, janë shpëtuar 192 femra, nga të cilat 57 të huaja . Në vitin 2002 janë evidentuar 492 vepra penale të trafikimit të paligjshëm me 778 autorë, ndërsa trafikim femrash për prostitucion janë evidentuar 203 raste me 298 autorë. Në vitin 2003, në dhjetor të këtij viti, policia organizoi disa operacione në shkallë të gjerë, kryesisht në qarqet bregdetare të vendit për të parandaluar dhe goditur trafikimin, operacione që vazhduan edhe gjashtëmujorin e parë të vitit 2004.

Sa për rolin e gjykatës, për trafikim me qëllim prostitucioni janë identifikuar 126 raste, janë marrë nën përgjegjësi penale 223 autorë, nga të cilët 36 janë arrestuar, 100 janë ndaluar, 6 ndiqen në gjendje të lirë dhe 81 janë në kërkim.

¹⁴⁹Bullough, Vern L.; Brundage, James A. (1994). *Sexual Practices and the Medieval Church*. Prometheus Books. [ISBN 9780879752682](https://www.isbn-international.org/product/9780879752682).

¹⁵⁰ Po aty

Si shfrytëzimi me qëllim prostitucioni në rrethana rënduese janë identifikuar 23 raste, me 35 autorë, nga të cilët 14 janë arrestuar, 11 janë ndaluar, 1 ndiqet në gjykim të lirë dhe 9 janë shpallur në kërkim. Mbajtja e lokaleve për prostitucion është konstatuar në 5 raste me 10 autorë, 9 të arrestuar, 1 i ndaluar, ndërsa ushtrimi i profesionit të prostitucionit është vërtetuar në 11 raste, me 19 autore, nga të cilat 19 janë arrestuar, 3 janë ndaluar, 3 janë në gjykim të lirë dhe 2 në kërkim. Në Tetovë, një qytet i banuar kryesisht nga shqiptarë në Maqedoninë veriperëndimore, mendohet se ekzistojnë rreth 30 vende ku ushtrohet prostitucion. Gjendja është e ngjashme edhe në zonat me popullsi kryesisht maqedonase. Qyteti turistik i Ohrit duket se ka një rrjet të gjerë prostitucioni, i cili ushqehet edhe nga industria e turizmit.

Në Shkup, kryeqyteti i vendosur në veri të vendit, rrjeti i prostitucionit duket se është më i sofistikuar. Mendohet se në trafik janë të përfshirë edhe shoferë taksie, të cilët marrin kërkesat me telefon dhe dërgojnë prostitutat tek klientët. Këtë vit policia ka zbuluar disa bordelle që vepronin në qytet. Në ndryshim nga zonat e tjera të vendit, pjesa më e madhe e prostitutave që janë arrestuar në Shkup vijnë nga Serbia.

Hetimet e policisë këtë vit kanë çuar në arrestimin dhe largimin nga vendi të vetëm 20 prostitutave të huaja, nga të cilat 15 ishin nga Bullgaria, katër nga Rumania dhe një nga Moldavia.

Kërkesa në rritje, fitimet e mëdha dhe përmirësimi i organizimit të rrjeteve të prostitucionit janë shenja se ky biznes do të vazhdojë të lulëzojë në Maqedoni. Vështirësitë e mëdha të policisë, përfshirë edhe korrupsionin e saj, janë një përfitim për protektorët dhe trafikantët.¹⁵¹

	2015	2016	2017	2018
Prostituticioni	233	435	1002	213

Burimi: document i marrë nga Praktika Gjygjësore në Tetovë, për vjedhje (rastet janë marrë për qëllim të këtij punimi master)

¹⁵¹ Po aty

Sipas kësaj tabele mund ti shikojmë se nr i madh i viktimave të cilat kanë kryer prostitucion, nr më i madh i këtyre veprave ka qenë në vitin 2017 kurse me pak në vitin 2018.

1.5.1 Kuadri ligjor në lidhje me prostitucionin

Ligjet luajnë një rol kryesor në formësimin e zgjedhjeve të punonjësve të seksit, tejkalimin e stigmës sociale dhe diskriminimit ndaj punonjësve të seksit dhe familjeve të tyre, zvogëlimin e dhunës dhe shfrytëzimit në punën seksuale, ose ndryshimin e kushteve të punës në industrinë e seksit.

Në Republikën e Maqedonisë, prostitucioni individual është i paligjshëm dhe është vepër administrative. Kryerja e punës seksuale, përkatësisht "prostitucioni" konsiderohet shkelje e rendit dhe qetësisë publike (neni 27 i Ligjit për kundërvajtje kundër rendit publik dhe paqes në Republikën e Maqedonisë), ndërsa disa aktivitete të tjera në lidhje me punën seksuale (joshja, inkurajimi, fitimi nga ndërmjetësimi për shërbime seksuale) trajtohen dhe dënohen si krime (neni 191 i Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë 1996)

Në realitet: "Ministria e Brendshme nuk bën dallimin midis prostitucionit dhe shfrytëzimit të prostitucionit, kështu që merr masa për" eliminimin e prostitucionit "në vend të" eliminimit të shfrytëzimit në prostitucion ", dhe për këtë arsye merr masa drastike të policisë kundër viktimave të këtij shfrytëzimi në vend se kundër shfrytëzuesve".

1.6 Vështrim i përgjithshëm, të dhëna statistikore të veprave penale nga Gjykata Themelore në Tetovë

Me shfrytëzim të prostitucionit kuptojmë shtytjen, ndërmjetësimin e femrave për të prostituar dhe marrjen e shpërblimit prej tyre për shkak të këtij aktiviteti.

Gjatë vitit 2003, gjykatat shqyrtuan 22 raste të shfrytëzimit për prostitucion, bazuar në nenin 114 të Kodit Penal i RMV-s të cilat kanë përfshirë 26 vepra penale dhe 21 persona të dënuar; 58 raste të shfrytëzimit për prostitucion në rrethana rënduese janë shqyrtuar bazuar në nenin 114/a të Kodit Penal, të cilat kanë përfshirë 61 vepra penale dhe 73 persona të dënuar. Në vijim kemi veprat penale dhe udhëheqjen e procesit penal.

PËR CILËN VEPËR PENALE UDHËHIQET

PROCESI

	353							2	359
Ko	Keq	257	2	357	2	360	3	5	Ndërmj
di	përd	Pros	7	Fal	4	Dh	5	6	e-
pe	orim	titut	9	sifi	7	ëni	4	Ke	tësim
nal	I	icio	P	kim	M	e e	Vj	qpë	jashtë
i	pozi	n	a	dok	a	sek	e	r-	ligjor
RM	tës		st	um	s	reti	d	dor	
,n.	zyrt		ri	ent	h	t të	hj	im	
nr.	are		m	esh	t	shë	e	të	
	dhe		p		r	rbi	n	pro	
	auto		a		i	mit	ë	ces	
	rizi		r		m		d	it	
	m		a				et	për	
			s				yr	fali	
			h				ë	me	
								nti	
								m	

GJITHSEJË

GJYQI THEMELORË	Gj.th	7	0	0	0	1	0	1	0	0	19
	Manastir					1					
	Gj.th	12	0	0	0	3	0	0	0	0	15
	Veles										
	Gj.th	0	0	0	0	0	0	0	0	0	6
	Kavadar										
	Gj.th.	11	0	0	0	1	0	0	0	0	12
	Koçan										
	Gj.th	3	0	0	0	4	0	0	1	0	8
	Ohër										
GJYQI THEMELORË	Gh.th	16	0	2	1	3	0	0	0	0	22
	Shkup										
	Gj.th	17	0	0	0	3	1	1	0	0	22
	Strumicë										
	Gj.th	2	1	0	0	1	0	0	0	0	4
GJYQI THEMELORË	Tetovë										
	Gj.th	0	0	0	0	0	0	1	0	1	2
	Shtip										
Gjithsej		68	1	2	1	3	1	3	1	1	110
ë						2					

Sipas kësaj table, 19 raste të veprave penale të gjetura në Gj.Th Manastir, numri më i madh i veprave penale janë gjetur në Gj.Th në Shkup dhe Strumicë, kurse më pak kemi në Gj.Th në Shtip.

Rrjetet e prostitucionit të organizuar kanë vepruar aktivisht në Maqedoni që prej të paktën një dhjetëvjeçari. Numri i prostitutave që punojnë tani në këtë vend mendohet të jetë rreth 1,500 deri 2,000. Kjo tregti mendohet se krijon fitime prej rreth 325 deri 430 milion marka gjermane në vit për organizatorët e saj.

Një pronar i një bari apo klubi nate me pesë prostituta mund të fitojë lehtësisht rreth 40,000 deri 50,000 marka në muaj. Potenciali i këtij biznesi kaq të fuqishëm për të korruptuar punonjësit e administratës shtetërore, policinë apo edhe të ndihmojë në zgjedhjen e deputetëve për në parlamentin e vendit është real. Fitimet ekonomike nga prostitucioni i organizuar janë tepër të mëdha dhe kjo gjë ka bërë që një numër gjithnjë e më i madh njerëzish të përfshihen në këtë biznes. Rrjetet ilegale që mundësojnë trafikimin e vajzave janë ngritur në të gjithë vendin. Ato verpojnë në bazë të kërkesë ofertës dhe kontrollojnë edhe shpërndarjen e prostitutave në vende të tjera, përfshirë Europën perëndimore dhe vetë Maqedoninë.

Kreu IV

Riintegrimi i grave të dënuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Të burgosurit meshkuj dhe femra përballen me pengesa për rehabilitimin e suksesshëm dhe riintegrimin shoqëror. Disa nga këto pengesa janë institucionale; të tjerët kanë të bëjnë me rrethanat individuale.

Shpesh ka mungesë të vullnetit politik dhe alokimit të buxhetit për programet e rehabilitimit, dhe burgjet nganjëherë janë të pajisura dobët dhe u

mungojnë burimet njerëzore dhe financiare për të ofruar projekte të qëndrueshme. Në shumë institucione, mundësitë për arsim dhe trajnim janë të kufizuara.¹⁵²

Të gjitha femrat e burgosura përballen më një sërrë vështirësisë gjatë riintegrit pas lirimit të tij. Burimet dhe vëmendjen e alokuar ndaj nevojave të tyre sociale, psikologjike dhe shëndetësore gjatë përgatitjes së tyre për lirin dhe vijimin e burgimit.

Bashkëpunimi midis autoriteteve të burgjeve dhe shërbimeve civile, sociale dhe shëndetësore shpesh mungon. Për më tepër, pas lirimit ish të burgosurit vuajnë nga diskriminimi në punësim dhe arsimim, për shkak të të dhënave të tyre penale dhe stigmatizimit.

Edhe pse shumë probleme me të cilat përballen gratë gjatë ri-hyrjes në shoqëri janë të ngjashme me atë të burrave, intensiteti dhe shumëfishimi i nevojave të tyre pas lëshimit mund të jenë shumë të ndryshëm. Gratë ka të ngjarë të pësojnë diskriminim të veçantë pas lirimit nga burgu, për shkak të stereotipeve sociale. Ata mund të refuzohen nga familjet e tyre dhe në disa vendet mund të humbin të drejtat e tyre prindërore.¹⁵³

Nëse ata kanë lënë një marrëdhënie të dhunshme, gratë do të duhet të krijojnë një jetë të re, e cila ka të ngjarë të sjellë vështirësi ekonomike, sociale dhe ligjore, përveç sfidave të kalimit në jetën jashtë burgut.

Një studim i kryer në një vend nxjerr në pah mirë disa nga vështirësi praktike me të cilat përballen gratë pas lirimit nga burgu. Kjo ka një ndikim të veçantë te gratë me fëmijë që janë marrë në kujdes. Humbja e strehimit për gratë mund ta bëjë detyrën e rifitimit të kujdesit për fëmijët e tyre veçanërisht të vështirë.¹⁵⁴

Nëse ata nuk kanë fëmijë në kujdesin e tyre, vështirë se do t'u jepet statusi i përparësisë nga autoritetet e strehimit. Sidoqoftë, nëse ata nuk kanë

¹⁵² Handbook for prison managers and policymakers on Women and Imprisonment, UNITED NATIONS PUBLICATION Sales No. E.08.IV.4 ISBN 978-92-1-130267-7

¹⁵³ Po aty

¹⁵⁴ Handbook for prison managers and policymakers on Women and Imprisonment, UNITED NATIONS PUBLICATION Sales No. E.08.IV.4 ISBN 978-92-1-130267-7

strehim të sigurt, atëherë fëmijët e tyre nuk do të vendosen përsëri nën kujdesin e tyre.

Mossdiskriminimi i grave të dënuara në RMV

Diskriminimi i grave të dënuara, e ngadalëson së tepërmi procesin e riintegrit të tyre në shoqëri. Në një mjedis social paragjykues, një femër e cila ka vuajtur dënimin e caktuar nga gjykata, zakonisht është e predispozuar që të vuajë edhe dënimin moral të dhënë nga shoqëria përreth.¹⁵⁵

Ajo do ta ketë më të vështirë të vazhdojë jetën në pikën që e ka lënë, do ta ketë akoma më të vështirë për të gjetur një punë dhe me siguri e humbet edhe mbështetjen e të afërmeve. Ky është dënimi i dhënë nga shoqëria dhe normalisht që ndikon negativisht në procesin e riintegrit duke marrë parasysh edhe faktin se ky dënim nuk mund të dihet me siguri se kur përfundon.

Diskriminimi pozitiv

Institucionet kompetente ballafaqohen me sfida të ndryshme lidhur me përcaktimin e bazave për diskriminim, si dhe me trajtimin e tyre. Një pjesë nga ato përfshijnë përcaktimin e përkatësisë në ndonjë grup të caktuar, diskriminimin e shumëfishtë, diskriminimin me ndërprerje, diskriminimin përmbledhës (kumulativ), diskriminimin sipas asocimit, veçorinë e supozuar, krahasuesin dhe rëndësinë e krahasuesit, shkallën/gradimin e mbrojtjes së bazës për diskriminim masat afirmative dhe masat pozitive për veprim, përshtatjen e arsyeshme, etj. Të gjithë këto parime juridike janë të rëndësishme për kuptimin, interpretimin dhe aplikimin e bazave për diskriminim, prandaj ato këtu do të sqarohen shkurtimisht.

Përkatësia në ndonjë grup të caktuar: nëse nuk ekziston arsyetimi për një qasje të ndryshme, atëherë parimi i vetë-identifikimit të personit me ndonjë grup të caktuar duhet të merret si përcaktues i përkatësisë së tij në një grup të caktuar.

Përkatësia gjithashtu mund të përcaktohet dhe përmes posedimit të një tipari personal ose statusi që lidhet me një grup të caktuar. Shpeshherë,

¹⁵⁵Brand van den J.; Boeij, C.; Papavangjeli, E.; Sufaj, F. “ Drejtimi human i burgjeve” (Manual për drejtimin e lartë në burgje), Tiranë. Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Kapitulli I, prill 2009, f. 1.

rëndësi të madhe në rastet e trajtimit të pabarabartë mban dhe perceptimi i diskriminuesit potencial për përkatësia e personit në një grup të caktuar (shihni “veçoria e supozuar” më poshtë).

Diskriminimi i shumëfishtë, diskriminimi me ndërprerje, diskriminimi përmbledhës (kumulativ): Nëse një person vuan një trajtim të pabarabartë në më tepër baza për diskriminim, gjë kjo gjatë së cilës diskriminimi paraqitet në intervale të ndryshme kohore për çdo bazë, atëherë bëhet fjalë për diskriminim të shumëfishtë.

Nëse diskriminimi është paraqitur në më shumë baza në të njëjtën kohë, atëherë bëhet fjalë për diskriminim përmbledhës (kumulativ). Dhe, nëse diskriminimi është paraqitur me më tepër baza në të njëjtën kohë, dhe ka ekzistuar një ndërlidhje e ndërsjellë dhe mosndarje midis bazave, atëherë bëhet fjalë për një diskriminim pa ndërprerje.¹⁵⁶

Diskriminimi sipas asociimit: nëse trajtimi i pabarabartë bëhet mbi një person që ka të bëjë me lidhjen e tij me një person tjetër, i cili posedon ndonjërin nga tiparet e mbrojtura personale ose statusin, atëherë diskriminimi mbi këtë person konsiderohet si diskriminim sipas asociimit.

Veçoria e supozuar: personi nuk është patjetër të posedojë një veçori të caktuar ose status për të qenë i diskriminuar në bazë të asaj. Këtu vendimtar do të jetë perceptimi i diskriminuesit potencial, i cili supozon se personi është pjesëtar i një grupi të caktuar me veçori ose status të tillë, pavarësisht nëse me të vërtetë është ashtu.

Masat afirmative dhe masat pozitive për veprim: këto masa¹⁵⁷ definoen lidhur me një bazë të caktuar për diskriminim, dhe me një qëllim konkret të promovimit të barazisë materiale, duke përfshirë këtu dhe përmes kuotave ose rregullave tjera të pranisë së grupeve pamjaftueshëm të përfaqësuara ose grupeve të përjashtuara, të cilat janë të kufizuara me kohë nga natyra e vet dhe

¹⁵⁶ Makkonen, Timo. „ Multiple, Compound and Intersectional Discrimination: Bringing the Experiences of the Most Marginalized to the Fore “ Institute For Human Rights, Åbo Akademi University (April 2002). . Qasur më: 20.09.2020

¹⁵⁷Më herët për këto masa është përdorur dhe termi “diskriminimi pozitiv”.

kanë për qëllim përmirësimin e padrejtësive historike të bëra ndaj një grupi të caktuar.

Masa të këtilla mund të jenë: politikat faktikisht neutrale por qëllimisht - inkluzive; programet përmes të cilave mund të mbërrihet/qaset deri tek grupet e diskriminuara; preferencat gjatë punësimit dhe ridefinimit të kualifikimeve të nevojitura, aktivitetet tjera konkrete për çrrënjosjen e diskriminimit.¹⁵⁸

Dënimi me burg

Burgu mund të shqiptohet edhe për vajza edhe për djem. Burgu shqiptohet t'për përgjegjësinë penale nëse ka kryer vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me burg prej pes viteve ose dënimi më i rëndë dhe nëse vepra është kryer në rrethana veçanërisht rënduese me çrast nuk do të ishte e arsyeshme të shqiptohet masa educative. Në RMV në gjykatat themelore mekompetencë të zgjeruar është formuar sektori i specializuar për kriminalitetin e të miturve i përbërë nga gjykatësi, këshiltarët.¹⁵⁹

Sipas KPM-së del se e drejta jonë e përvetëson preventivën e posaçme (speciale) dhe të përgjithshme (gjeneral) si qëllim të dënimit, në nenin 34 të Kodit Penal është përcaktuar qëllimi i përgjithshëm i dënimit. Si në legjislacionin penal të çdo shteti, ashtu edhe te ne, lloji dhe lartësia e dënimit përcaktohet sipas intensitetit dhe sasisë së të keqes që kryesi i veprës penale ia ka shkaktuar individit dhe shoqërisë. Dënimi krahas qëllimit të preventivës individuale dhe të përgjithshme duhet të përmbushë edhe qëllimin e drejtësisë duhet të jetë i drejtë, vetëm dënimi i drejtë mund të shuajë ndjenjën e hakmarrjes. Qëllimi kryesor i dënimeve dhe masave tjera alternative është që në të gjitha rastet të luftohet kriminaliteti pa u ekzekutuar dënimi me burgim.

Në shkencën e së drejtës penale njihet nocioni formal dhe material i dënimit. Nocioni formal përcaktohet duke pasur parasysh elementet juridike të dënimit, siç janë përcaktueshmëria e tij në ligj, ligjshmëria me rastin e shqiptimit, organi i cili është kompetent për shqiptimin e tij, procedura

¹⁵⁸ Sintetizuar nga: Sandra Fredman, 'Reversing Discrimination' (1997) 113 LQR 575, 575; Kristin Henrard, 'Nondiscrimination and Full and Effective Equality' in Marc Weller (ed) Universal Minority Rights (OUP 2007) 129.

¹⁵⁹ Ismail, Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë, 2018, fq. 202

gjyqësore që duhet të respektohet për të mundur të shqiptohet, etj.

Nocioni material i dënimit përcaktohet duke pasur parasysh qëllimin e tij. Sipas këtij kuptimi, qëllimi kryesor i dënimit është mbrojtja e shoqërisë nga kriminaliteti dhe preventiva me qëllim që kryesi në të ardhmen të mos kryej vepra penale dhe përmirësimi i tij, si dhe ruajtja e disiplinës së caktuar të qytetarëve në shoqëri.

Kodi Penal i përjashton femrat nga dënimi me burgim të përjetshëm, ashtu sic bën edhe me të miturit duke u shprehur në nenin 31 *“Dënimi me burgim të përjetshëm jepet me vendim të gjykatës për kryerjen e një krimi të rëndë.”*¹⁶⁰ *Dënimi me burgim të përjetshëm nuk jepet ndaj personave që në kohën e kryerjes së krimit nuk kanë mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, si dhe gratë.”*

Ambientet e vuajtjes së dënimit me burgim dhe me burgim të përjetshëm

Drejtësia është drejtësi vetëm atëherë kur ajo realizohet deri në fund, që do të thotë atëherë kur shkelësi i ligjit, ta vuaj dënimin, e tij! E drejta për ekzekutim të aktgjykimit (në rastin tonë të sanksioneve penale) është një pjesë integruese e së drejtës për gjykim të drejtë brenda kohës së arsyeshme.¹⁶¹ Ky punim, shqyrton kornizën ligjore sinë vendashtu

edhe atëndërkombëtare të zbatueshme për ekzekutimin e sanksioneve penale; punimi po ashtu shqyrton edhe zbatimin e tyre të deritashëm nga ana e institucioneve si dhe ingranazhin e përgjithshëm të procesit të ekzekutimit të sanksioneve penale.

Përgjithësisht¹⁶² jepet një trajtim analitik dhe vështrime krahasimore të ekzekutimit të sanksioneve penale në Maqedoni duke e pasuruar këtë vështrim edhe me statistika dhe raporte të punës së bartësve të ekzekutimit të sanksioneve penale si dhe duke shtjelluar penologjinë përgjithësisht, politikën penalogjike në Maqedoni në periudhën kohore, sistemin e ekzekutimit të sanksioneve penale, burgjet, ndarjen organizimin, funksionim

¹⁶⁰ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtëre nr. 139/2008, në dispozicion në: http://www.semejnonasilstvo.org.mk/Root/mak/default_mak.asp

¹⁶¹ Borislav Petroviq, E drejta e penale, Sarajevë/Prishtinë, 2006 FSK/S -14/06

¹⁶² Po aty

in

etyre, roline institucioneve siprokurorisë, gjykatës, policisë në këtë ekzekutim, të drejtat e të provuarve apo të sanksionuarve me sanksione penale.

Në vështrimin historik, legjislacioni mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ka njohur rrugën e vet të zhvillimit dhe të transformimit që nga krijimi i shtetit të pavarur shqiptare deri në ditët e sotme. Ai ka pësuar ndryshime në varësi të zhvillimeve ekonomike, shoqërore, politike ideologjike etj.¹⁶³ Duke bërë një ndarje të legjislacionit mbi ekzekutimin e vendimeve në: Legjislacioni mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale dhe Legjislacioni mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore civile.¹⁶⁴ Në Maqedoni, aktgjykimet si në rastet civile ashtu edhe në ato penale, pasi të marrin formën e prerë, përmbahen/ekzekutohen nga zyrtarë për përmbarime në gjykata, që përfshijnë gjyqtarë dhe referentë për përmbarime.

Në rastet civile, procedura përmbarimorë iniciehet nga kreditorin në mënyrë që të fitojë gëzim në të drejtë secilaveç së është njohur në aktgjykim të formës së prerë aponë ndonjë tjetër dokument origjinal. Në rastet penale, ekzekutimi i sanksioneve penale fillon me automatizëm apo aktgjykimi me të cilin është caktuar sanksioni penal merr formën e prerë dhe nuk ka pengesa ligjore për përmbarim të tij. Dënimi me burgim të përjetshëm është dënimi më i rëndë që mund ti shqiptohet kryesit i cili ka kryer vepër ma të rëndë penale, të kryer në mënyrë rënduese dhe që ka shkaktuar pasojashumë të rënda.¹⁶⁵

Ky ligj nuk mund të parasheh dënimin me burgim të përjetshëm si të vetmin dënim kryesor për një vepër të veçantë penale. Dënim i me burgim të përjetshëm nuk mund t'i shqiptohet personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i ka mbushur njëzetën 21 vjet. Po ashtu dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund ti shqiptohet edhe personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka pasur aftësi esenciale të zvogëluar mendore. Personi i dënuar me burgim të përjetshëm mund të lirohet me kusht pasi të ketë

¹⁶³ Po aty

¹⁶⁴ Po aty

¹⁶⁵ Borislav Petroviq, E drejta e penale, Sarajevë/Prishtinë, 2006 FSK/S -14/06

mbajtur dyzetë 40 vjet nga dënimi me burgim të shqiptuar. Parashkrimi është institut shumë i rëndësishëm juridik, pa dyshim ndër më të rëndësishmit e së drejtës penale përmes të cilit pamundësohet ndjekja penale si dhe ekzekutimi i sanksionit penal pas kalimit të një periudhe të caktuar kohore, qoftë nga koha e kryerjes së një veprë penale (parashkrimi i ndjekjes penale) qoftë nga koha e shqiptimit të dënimit dhe mosekzekutimi i tij (parashkrimi i ekzekutimit të dënimit). Parashikimi ligjor që femrat e kryejnë dënimin me burgim në institucione të vecuara nga burrat tashmë është kthyer në trajtën e një parimi, i cili nuk mund të konceptohet ndryshe.

Përsa i përket dënimit me burgim, një gjë e tillë është e realizueshme dhe konkretisht në RMV femrat e kryejnë dënimin me burgim në institucione të vecuara nga meshkujt. Por një gjë e tillë nuk mund të thuhet edhe për paraburgimin.

Trajtimi i femrave të dënuara me heqje lirie

Dënimin plotësues si që është heqja e të drejtës për të u zgjedhur mund të shqipton gjykata kryesit të veprës penale në një afat kohor prej një 1 gjerë në katër 4 vjet, nëse ai person me qëllim të zgjidhet në organet lokale apo qendrore (deputet, këshilltar, kryetar komune, etj) kryen ndonjë nga veprat penale kundër të drejtave të votimit, si falsifikim i listave, kërcënim i votuese, shantazhin ose vepër tjetër penale për të cilën është paraparë dënimi me më së paku dy 2 vjet burgim.

Heqja e të drejtës për tu zgjedhur shqiptohet nga gjykata krahas dënimit me burgim dhe kohëzgjatja e tij është prej një 1 gjerë në tre 3 vjet. Ekzekutimi i këtij dënimi plotësues fillon pasi i dënuari të ketë mbajtur dënimin me burgim.¹⁶⁶

Gjatë periudhës së sistemit komunist, sipas Kodit Penal dënimi me vdekje nuk jepej për femratshtatzëna, por jepej dënimi me 25 vjet burg ose kishte raste kur ligji parashikonte mundësinë e shtyrjes së ekzekutimit deri në 2 muaj pas lindjes

¹⁶⁶Halili, Ragip, (2014), Penologjia, UP. Prishtinë, Fakulteti Juridik

ose deri në 9 muaj kur e dënuara ishte me fëmijë në gji. Për femrat e mitura që kryenin krime jepeshin masa edukuese.¹⁶⁷

Pas viteve '90 vihen re ndryshime të dukshme në legjislacionin shqiptar. Ligji penal parashikon një mbrojtje të vecantë të femrës, Kushtetuta parashikon qartë të drejtat dhe liritë e personave.

Nevoja e trajnimit të veçantë të grave të dënuara me heqje lirie

Studimet dhe statistikat në fushën e drejtësisë penale dhe të sistemit të burgjeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar tregojnë se numri i grave që kryejnë krime është më i ulët se numri i meshkujve. Gjatë viteve të fundit përfshirja e grave në krim është rritur në vende të ndryshme të Europës, ndërkohë që ulje ka shënuar numri i tyre në institucionet e paraburgimit dhe në burgje. Në burgjet e shumë vendeve perëndimore numri i të dënuarve të huaj, mes tyre edhe i grave ka njohur rritje. Trajtimi i grave nuk ka shumë dallime nuk ka shumë dallime nga trajtimi i burrave.

Trajtimi i vecantë i grave të dënuara me burgim kushtëzohet nga nevojat dhe kërkesat specifike që ato kanë në kushtet e qëndrimit të tyre duke qenë se një pjesë e tyre janë nëna me fëmijë të mitur, ka prej tyre që mund të kenë qenë viktimë të dhunës fizike, psikologjike, seksuale, në familje ose jashtë saj. Heqja e lirisë së grave që kanë fëmijë të mitur ka pasoja në rritjen dhe edukimin e fëmijëve që ndodhen brenda dhe/ose jashtë institucionit të dënimit.¹⁶⁸

Nga ana tjetër, faktorët ekonomik, krizat ekonomike, pabarazia në shoqëri kanë pasoja më të shumta të gratë se sa të burrat. Studimet kriminologjike tregojnë se gratë dhe vajzat shfrytëzohen nga grupe kriminale me qëllime kriminale, dhe shpesh nga viktimë ato bëhen autore të krimeve të

¹⁶⁷ Po aty


¹⁶⁸ Halili, Ragip, (2014), Penologjia, UP. Prishtinë, Fakulteti Juridik

ndryshme, përfshirë edhe të krimeve të organizuara.

Trajtimi i grave që kanë një status të dyfishtë, pra viktimë dhe më pas autore të një veprë penale, dikton nevojën e një trajtimi të vecantë të tyre, që të mbajë parasysh nevojat për asistencë që në fillim të kontaktimit me sistemin e drejtësisë penale. Gjithashtu, sjellja e sistemeve të drejtësisë penale në shumë vende është diskriminuese ndaj grave që kryejnë një vepër penale.

Praktika Gjygjësore në Gjykatën Themelore të Tetovës në lidhje me rastet femrat si subjekte të veprave penale

Sipas burimeve të marra të Gjykatës Themelore të Tetovës, për sa i përket femrave dhe vajzave të dyshuara për kryerjen e veprave të ndryshme penale, si mashtrim, prostitucion, falsifikimi i dokumentash etj. Sipas të dhënave të përgjithshme që kemi marrë në Gjykatën themelore të Tetovës kemi rreth 4171 rast të cilat më pas do ti ndajmë në nën raste tjera. Periudha e analizuar është pikërisht nga viti 2015 deri në vitin 2019.



Burimi: document i marrë nga Praktika Gjygjësore në Tetovë, (rastet janë marrë për qëllim të këtij punimi master)

Veprat penale	Të rritura		
	2017	2018	2019
		8	

Krime kundër jetës dhe shëndetit	45	30	31
Veprat penale në fushën ekonomiko-financiare	289	250	265
Trafiqet e paligjshme	50	65	36
Vepra kundër kufijve dhe migracionit	99	37	42
Totali³⁵	483	382	374

Burimi: document i marrë nga Praktika Gjyqësore në Tetovë, (rastet janë marrë për qëllim të këtij punimi master)

Sipas kësaj table mund të shikojmë, se në vitin 2017 kemi hasur më shumë raste të krimeve kundër jetës dhe shëndetit në vitin 2017 po ashtu kemi më shumë raste për veprat penale në fushën ekonomike financiare, kurse në vitin 2018 kemi më së shumti krime në trafik dhe në fund në analizën e kësaj table kemi 99 raste të veprave.

Veprat penale	Të rritura			Të mitura		
	2017	2018	2019	2017	2018	2019
Krime kundër jetës të kryera me dashje	8	17	11	-	-	1
Krime kundër shëndetit të kryera me dashje	21	4	22	-	-	-
Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzënisë ose nga	2	3	2	-	-	-

mosdhënia e ndihmës						
Krime seksuale	0	0	0	0	0	0
Veprat penale kundër lirisë së personit	1	11	7	-	-	1
Trafiqet e paligjshme	0	4	7	0	0	0
Veprat penale të prodhimit, trafikimit, kultivimit dhe shitjes së narkotikëve	19	18	14	-	-	1
Veprat penale në lidhje me shfrytëzimin e prostitucionit	38	36	45	-	4	2
Veprat penale në lidhje me korrupsionin	2	0	9	0	0	0
Veprat penale në lidhje me detyrën	22	18	24	0	0	0
Vepra penale në lidhje me pastrimin e parave	1	1	0	0	0	0
Veprat penale në lidhje me krimin e organizuar	0	0	0	0	0	0
Veprat penale kundër pasurisë	37	26	58	4	9	2

dhe në sferën ekonomike						
Veprat penale në lidhje me mashttrimet	28	34	33	0	0	0
Veprat penale të lidhura me shkatërrimi n e pronës	4	9	5	0	0	0
Veprat penale në fushën e doganave	7	2	9	0	0	0
Veprat penale në lidhje me taksat dhe tatimet	4	3	3	0	0	0
Veprat penale në lidhje me falsifikimin e dokumenteve	137	62	59	-	-	2
Veprat penale të falsifikimit të monedhave dhe letrave me vlerë	0	0	2	0	0	0
Veprat penale në lidhje me zhvillimin e palejuar të lojërave të fatit	0	1	1	0	0	0
Veprat penale kundër mjedisit	0	0	2	0	0	0
Krime kundër autoritetit të	15	4	14	0	0	1

shtetit ¹⁶⁹						
Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike	47	34	48	1	4	1
Vepra penale kundër drejtësisë	*	*	39	*	*	5
Vepra që cenojnë regjimin juridik të tokës	**	**	-	* *	**	-
Vepra kundër sekretit dhe kufijve shtetërore	13	6	-	-	-	-
Totali	406	293	414	5	17	16

Burimi: document i marrë nga Praktika Gjyqësore në Tetovë, (rastet janë marrë për qëllim të këtij punimi master)

Ajo që vihet re nga analiza e tendencave të rritjes ose të uljes së përfshirjes së grave dhe vajzave në vepra të ndryshme penale për vitet 2017-2018 është fakti se ka një rritje të ndjeshme për përfshirjen e tyre në vepra penale jo të dhunshme.

Ndërsa rritja e përfshirjes së tyre në vepra penale të dhunshme është në shifra më të ulëta. Të dhënat që u referohen grave dhe vajzave si të pandehura brenda grupimeve të këtyre veprave ku përfshihen edhe vepra penale të dhunshme, e bën të pamundur të kuptohet cilat vepra penale konkrete kanë kryer këto të pandehura, për të evidentuar edhe brenda këtyre grupimeve natyrën e dhunshme ose jo të tyre. Analiza e të dhënave të

¹⁶⁹ Informacion zyrtar i DPPSH-së në datë 12.10.2011.

veprave penale të kryera nga gratë e dënuara do të na e mundësojë një argument të tillë në një pjesë më poshtë në këtëpunim.

Statistika rreth veprave penale te kryera nga ana e femrave në RMV për disa vite 2010-2018

Për vitin 2010 janë gjykuar 35 çështje penale me 36 gra si të pandehura dhe për periudhën janar tetor 2011 janë gjykuar 40 çështje penale me 45 gra si të pandehura Vihet re një rritje e numrit të çështjeve penale me gra si të pandehura. Më poshtë paraqiten të dhëna të ndryshme që lidhen me profilin e grave dhe politikën penale të ndjekur nga gjyqtarët për të dyja periudhat kohore në shqyrtim

➤ Moshë

Siç vihet re nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mëposhtme për moshën e grave të pandehura gjatë vitit 2010, 55,5% e numrit të përgjithshëm të grave i përkasin moshës së thyer 55-65 vjeç; 16,6% e numrit të përgjithshëm të grave i përkasin moshës së mesme 45-55 vjeç; 13,8% e numrit të përgjithshëm të grave i përkasin moshës.25-35 vjeç; 8.3% e numrit të përgjithshëm të grave i përkasin moshës 35-45 vjeç dhe vetëm 5.5% e numrit të përgjithshëm të grave i përkasin moshës së re 18-25 vjeç.

Ndërsa mosha e grave të pandehura për vitin 2011 rezulton të jetë më e larmishme se ajo e një viti më parë.

Të dhënat meppshte tregojnë se 37,7% e grave i takojnë moshës 55-65 vjeç, 22,2% të tyre i takojnë moshës 25-35 vjeç duke evidentuar një rritje të ndjeshme të numrit të grave të kësaj moshe krahasuar me vitin 2010, 15,5% janë gra të moshës 45-55 vjeç, 13.3% i takojnë moshës 35-45 vjeç dhe 11,1% e tyre i përkasin moshës më të re 18-25 vjeç. Për këtë grup-moshë është rritur, gjithashtu, numri i grave të pandehura për 10 muajt e parë të 2012-s.

Moshë	Viti 2010	Janar-tetor 2011
--------------	------------------	-------------------------

55-65 vjeç	20 gra	17 gra
45-55 vjeç	6 gra	7 gra
35-45 vjeç	3 gra	6 gra
25-35 vjeç	5 gra	10 gra
18-25 vjeç	2 gra	5 gra

➤ *Arsimimi*

- Burimi: document i marrë nga Praktika Gjygjësore në Tetovë, (rastet janë marrë për qëllim të këtij punimi master)

Sa i takon arsimimit të grave të pandehura, të dhënat e tabelës më poshtë tregojnë se pjesa më e madhe e tyre ka vetëm arsimin 8-vjeçar (37.9% e numrit të tyre për të cilat kemi të dhëna) ose nuk e ka mbaruar atë (13,7%); 20.6% të tyre kanë mbaruar arsimin e mesëm (6.8% nuk kanë përfunduar arsimin e lartë) dhe vetëm 17,2% kanë përfunduar arsimin e lartë. Pra, pjesa më e madhe e grave të pandehura kanë arsimin elementar dhe vetëm pak prej tyre kanë arsimin e mesëm ose të lartë.

Arsimi	Viti 2010	Viti 2011
8- vjeçar	11 gra	4 gra
Nuk ka përfunduar arsimin 8-4 gra vjeçar		5 gra
Nuk ka përfunduar arsimin e1 grua mesëm		2 gra
Arsimi i mesëm	6 gra	7 gra
Nuk kanë përfunduar arsimin e2 gra lartë		1 grua
Arsimi i lartë	5 gra	18 gra
Pa arsim	0	1 grua
Nuk ka të dhëna	7 gra	7 gra

Burimi: document i marrë nga Praktika Gjygjësore në Tetovë, (rastet janë marrë për qëllim të këtij punimi master)

Tabela më poshtë tregon se 70,9% e numrit të grave për të cilat kemi të dhëna për vitin 2010, janë të martuara. 80% e tyre kanë nga dy e më shumë fëmijë, pra janë gra me përgjegjësi familjare dhe prindërore. Për periudhën e caktuar në vitin 2011 vihet re një dyfishim i numrit të grave të pandehura beqare që zënë 27,5% të grave për të cilat kemi të dhëna. Gratë e martuara zënë 66,9% nga të cilat më shumë se 70% kanë dy ose më shumë fëmijë

Gjendja civile	Viti 2010	Viti 2011
E martuar	22 gra	24 gra
Beqare	5 gra	10 gra
E divorcuar	1 grua	1 grua
E ve	3 gra	1 grua
Nuk ka të dhëna	5 gra	9 gra

Burimi: document i marrë nga Praktika Gjyqësore në Tetovë, (rastet janë marrë për qëllim të këtij punimi master)

Sipas të dhënave të tabelës së mëposhtme 91,6% e grave të pandehura për vitin 2010 janë të papuna dhe rreth 41% e tyre janë pa pension. Të gjitha gratë e papuna nuk rezultojnë të përfitojnë përkrahje sociale.

Pothuajse të gjitha gratë vijnë nga familje me probleme të thella ekonomike, përveç përgjegjësive të tyre prindërore. Të dhënat e mbledhura për këtë tregues për gratë e pandehura për periudhën e vitit 2011 janë më të pakta dhe nuk mundësohet nxjerrja e disa përfundimeve, megjithatë vihet re tendenca që shumica e grave janë të papuna dhe vijnë nga familje me probleme të shumta ekonomike.

Vlen të analizohen të dhënat e periudhës 10-mujore të vitit 2011, sipas të cilave shohim një ulje të ndjeshme të përfshirjes së grave të pandehura për vepra penale, si “mashtrimi” dhe kemi një rritje të përfshirjes së tyre në vepra penale që lidhen me “shpërdorimin e detyrës”, krahasuar me vitin 2010.

Gjithashtu, vihet re rritja e gamës së akuzave me vepra të reja penale krahasuar me akuzat e ngritura për gratë gjatë vitit 2010. Më konkretisht, 28,8% e grave akuzohen për “mashtrim”, 20% e tyre akuzohen për “shpërdorim

detyre” dhe 13,3% e tyre akuzohen për disa vepra penale njëkohësisht një pjesë e të cilave ka natyrë të dhunshme. Akuzat e veprave të tjera penale zënë një përqindje më të vogël.

Lloji i veprës penale	Viti 2010	Viti 2011
Mashtrim	22 gra	13 gra
Falsifikim dokumentesh	5 gra	1 grua
Kalim të paligjshëm të kufirit shtetëror	1 grua	0
Kallëzim i rremë	1 grua	1 grua
Shpërdorim detyre	1 grua	9 gra
Vjedhje	4 gra	3 gra
Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor	1 grua	0
Plagosje e lehtë me dashje	1 grua	0
Mosdhënia e mjeteve për jetesë	0	1 grua
Shkatërrim i pronës	0	2 gra
Prostitucion	0	2 gra
Përdorim me keqdashje i thirrjeve telefonike	0	1 grua
Dhunim banese	0	1 grua
Shpifje		1 grua
Kombinim i veprave penale³⁸	0	6 gra
Vetëgjyqësi	0	1 grua
Dhënie e urdhrave arbitrare	0	1 grua
Ushtrim të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike		1 grua
Largimi nga vendi i aksidentit	0	1 grua

Burimi: document i marrë nga Praktika Gjyqësore në Tetovë, (rastet janë marrë për qëllim të këtij punimi master)

Megjithatë, pa dashur të paragjykoen vendimet e dhëna nga gjykata në rastet e dënimeve me gjobë, sugjerohet se do të ishte mirë të shikohen mundësitë e dhënies së dënimeve alternative të dënimit me burgim, pasi pothuajse pjesa më e madhe e grave të pandehura vijnë nga një e kaluar me probleme të thella ekonomike dhe aplikimi i dënimeve alternative të tilla, si punë në interes publik etj., është më i përshtatshëm për to sesa pagesa e gjobave të dhëna si forma dënimi.

Metoda e analizës së të dhënave

Qasja e propozuar në këtë punim është shumëplanëshe duke përdorur metodologji të ndërthurura si punë kërkimore-shkencore, punë kërkimore në terren dhe ndërthurjen e tyre në analizën e ofruar si edhe në gjetjet dhe sugjerimet e ofruara. Puna kërkimore në terren përqendrohet në marrjen në intervistë të grave që gjenden në institucionet penale dhe të një numri përfaqësuesish të institucioneve të administrimit të drejtësisë penale, si: përfaqësues të institucioneve të paraburgimeve dhe burgjeve dhe përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për përfshirjen sociale dhe riintegrimin e këtyre grave në shoqërinë tonë.

Intervista dhe përmbajtja e saj

Numri i të anketuarëve është 60 vetë. Në anketë janë parashtruar gjithësej 10 pyetje me mundësi të ndryshme për tu përgjigjur, në mënyrë të anketuarit të kenë sa më lehtë hapsirën për përgjigje dhe të mund të shprehin mendimin e tij të lirë. Periudha Mars- Prill 2019.

Vendndodhja / Mbulimi

Vendodhja e anketës është rethina e Tetovës dhe Shkupi.

Instrumentet sasiore

Qasja e propozuar në këtë punim është shumëplanëshe duke përdorur metodologji të ndërthurura si punë kërkimore-shkencore, punë kërkimore në

teren dhe ndërthurjen e tyre në analizën e ofruar si edhe në gjetjet dhe sugjerimet e ofruara.

Puna kërkimore përqendrohet në studimin e literaturës bashkëkohore për politikën, strategjitë dhe praktikën për gratë në konflikt me ligjin, përfshirjen sociale dhe studimet në fushën e barazisë gjinore në vend dhe disa vende që do të merren për studim në Europë.

Pyetje e anketës


Anketa përmban këto të dhëna	Numri i përgjithshëm i të anketuarëve 60 vetë
Gjinia	37 meshkuj, 23 femra
Grupmosha	Nga 25 deri 55 vjet
Niveli i arsimit	Të mesëm dhe të lartë

Tabela 1. Anketa përmban këto të dhëna

Në tabelën e dytë kemi paraqitur kategorinë në grupmosha të pjesëmarrësve në anketë.

Grup mosha e të anketuarëve	Numri i pjesëmarrësve
Nga 20 – 25 vjeç	17
Nga 25 - 30 vjeç	3
Nga 31 – 40 vjeç	10
Nga 41 – 50 vjeç	12
Nga 50 – 55 vjeç	18

Tabela 2. Grup mosha e të anketuarëve



Grafikoni 2. Grup mosha e të anketuarëve

Në grafikonin e dytë shihet qartë në përqindje mosha e pjesëmarësve në anketë, këtu mund të dallojmë se përqindja më e madhe është nga mosha 50-55 vjeç, nga kjo kuptojmë se pjesëmarësit e kësaj moshe janë më të informuar sa i përket temës tone

Niveli i shkollimit		Kategoritë e të anketuarëve
Me shkollim të mesëm	të 22	
Me shkollim të lartë	të 38	

Tabela 3. Kategoritë e të anketuarëve

Tabela e tretë nivelin e shkollimit të të anketuarëve. Nga pjesëmarësit në hulumtimin del se të anketuarit në numër më të madh ishin me shkollim të lartë ndërsa me përqindje më të vogël ishin me përqindje shkollim të mesëm.




Grafikoni 3. Kategoritë e të anketuarëve

Nga grafikoni i tretë mund të kuptojmë se numri më i madh i të anketuarëve është me shkollim të lartë, pastaj janë niveli i dytë ata me shkollim të mesëm me përqindje pak më të vogël.

Vendbanimi i të anketuarëve	Numri i të anketuarëve në qytete përkatëse
Tetovë	38
Shkup	22

Tabela 4. Vendbanimi i të anketuarëve

Në tabelën e katërt janë paraqitur vendbanimet e të anketuarëve.



Grafiku 4. Vendbanimi i të anketuarëve


Shpërndarja e anketës në një qytet të ndryshëm prej ku vërehet se numri më i madh janë nga ana e Shkupit. Anketa është realizuar me qytetarët e Tetovës aty ku është realizuar anketa janë takuar njerëz të cilët janë të vendbanimit të Shkupit 37% e të anketuarëve janë nga ana e Shkupit, 63% e të anketuarit janë nga ana e Tetovës.

Interpretimi dhe paraqitja e rezultateve nga pyetësi i realizuar

a) Si keni jetuar përpara sesa të dënoheshit?

Mundësi për tu përgjigjur	Numri i përgjigjeve
- bashkë me familjen	23
- e varur ekonomikisht nga burri/familja/prindërit	12
- kontaktet me rrethin shoqëror në komunitet përpara burgosjes	25

Tabela 5 Si keni jetuar përpara sesa të dënoheshit?




Grafikoni 5 Si keni jetuar përpara sesa të dënoheshit

Para se të dënoheshim un jetoja bashkë me familjen këtë e thonë 38% e të anketuarëve kurse pjesa tjetër deklarojnë se 42% kanë qenë të varur ekonomikisht nga burri, familje/ prindërit.

b) Kanë qenë të mira marrëdhëniet me familjen/fëmijët/vëllezërit/motrat?

Mundësi për të përgjigjur	Numri i përgjigjeve
Po	42
Jo	18

Tabela 6. Kanë qenë të mira marrëdhëniet me familjen/fëmijët/vëllezërit/motrat?




Grafiku 6. Kanë qenë të mira marrëdhëniet me familjen/fëmijët/vëllezërit/motrat?

Po 70% kanë deklaruar se kanë pasur marrëdhënie të mira me familjen kurse 30% kanë deklaruar se jo.

c) Ke qenë e dhunuar (fizikisht/psikologjikisht/seksualisht) përpara burgosjes nga burri ose të tjerë?

Mundësi për tu përgjigjur	Numri i përgjigjeve
Po	36
Jo	24

Tabela 7. Ke qenë e dhunuar (fizikisht/psikologjikisht/seksualisht) përpara burgosjes nga burri ose të tjerë?




Grafikoni 7 Ke qenë e dhunuar (fizikisht/psikologjikisht/seksualisht) përpara burgosjes nga burri ose të tjerë?

60% kanë deklaruar se kanë qenë të dhunuar psikologjikisht përpara burgosjes kurse 40% kanë deklaruar se jo.

d) A ju sigurohet takimi, korrespondenca, bisedat telefonike me avokatët?

Mundësi për tu përgjigjur	Numri i përgjigjeve
Po	39
Jo	21

Tabela 8. A ju sigurohet takimi, korrespondenca, bisedat telefonike me avokatët?




Grafikoni 8. A ju sigurohet takimi, korrespondenca, bisedat telefonike me avokatët?

65% kanë deklaruar se po u sigurohet kurse 35% kanë deklaruar se jo.

e) A është i mirë ushqimi në institucion?

Mundësi për tu përgjigjur	Numri i përgjigjeve
Po	43
Jo	17

Tabela 9. A është i mirë ushqimi në institucion?



Grafikoni 9. A është i mirë ushqimi në institucion

72% kanë deklaruar se është i mirë ushqimi kurse 28% kanë deklaruar se jo.

PËRFUNDIMI

Ky punim do të ketë si qëllim të bëjë një përshkrim të përgjithshëm të dinamikës së krimit dhe mënyrës së ndëshkimit në Republika e Maqedonisë së Veriut dhe përfshin një panoramë të karakteristikave të kriminalitetit të femrave. Faktorët dhe motivet që i shtyjnë femrat të përfshihen në sjelljekriminale zënë një vend të rëndësishëm gjatë këtij punimi, jo për të justifikuar autorin e një veprë penale, por për të treguar që problemi real është më i gjerë dhe jo individual por shoqëror.

Me anë të këtij punimi evidentohen disa nga veprat penale që femrat kanë tendencën të kryejnë më shumë dhe më shpesh. Kemi të bëjmë me krime të tilla si falsifikimi i dokumenteve, mashtrimi, vrasje apo dhe prostitucioni, që nga të dhënat statistikore rezulton të jenë kryer më shumë nga autore femra.

Ajo që evidentohet tjetër në këtë punim është mënyra se si parashikon dhe e rregullon legjislacioni penal trajtimin e femrave që rezultojnë të jenë të akuzuara apo të dënuara për një vepër penale.

Është shumë e rëndësishme të njihen parashikimet ligjore në këtë fushë, të evidentohet saktësia e tyre dhe më e rëndësishmja se sa efikas është zbatimi i tyre në praktikë. Vihet re më së shumti fakti se femrat janë një kategori e vecantë në sistemin drejtësisë penale dhe si të tilla ato duhet të gëzojnë një trajtim të vecantë në përputhje me nevojat dhe interesat e tyre.

Një rëndësi e vecantë në këtë punim i është kushtuar edhe procesit të

riintegrimin të femrave në shoqëri, pasi ato të kenë përfunduar dënimin e dhënë nga gjykata. Ky është një nga proceset më të rëndësishme në drejtësinë penale dhe në mënyrë që sistemi i drejtësisë të jetë sa më eficient dhe të rritet besimi i qytetarëve te drejtësia, këtij procesi duhet t'i kushtohet vëmendje nga autoritetet ligjvënëse dhe ato ligjzbatuese.

Më e rëndësishme është të parashikohen rregulla që të bëjnë të mundur një procesintegrimi sa më eficient se sa t'i kushtohet më shumë rëndësi dënimit dhe ashpërsimit të tij. Në fund të fundit një femër që e ka kuptuar tashmë rëndësinë e asaj veprë që ka bërë, është në dijeni të faktit që ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe është penduar për këtë gjë, është një individ shumë më e vlefshme për shoqërinë se sa një femër që ka vuajtur për shumë kohë dënimin me burgim dhe në fund nuk ka besim tek sistemi i drejtësisë.

Në gjykimin tim të gjithë faktorët e lartpërmendur janë problematika serioze të një shteti që sjellin një zhvillim të calët të tij, një sistem drejtësie me themele të paqëndrueshme dhe institucione inekzistente për sa i përket kryerjes së detyrave të tyre.

Prandaj unë mendoj që duke qenë se gjërat janë zinxhir shkak-pasojë i njëra-tjetrës, fillimisht duhet të punohet fort me të gjithë instrumentet ligjore për krijimin e kushteve të barabarta në shoqëri, arsimin e detyrueshëm për të gjithë fëmijët femra e meshkuj duke i krijuar kushtet minimale si rrugë, shkolla, ngrohje, libra; krijimin e hapësirave të reja për punësim duke përmirësuar legjislacionin e punës, përforcimin e legjislacionit penal për dhunën brenda familjes, përmirësimin e institucioneve ligjzbatuese dhe mbrojtëse të shoqërisë si Policia e Shtetit, Shërbimi i Provës, Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale. Besoj se nëse të gjitha këto elemente do të arrijnë në nivelet minimale europiane, do të shohim shumë shpejt një përmirësim të këtij fenomeni dhe për rrjedhojë efekte më pozitive në shoqërinë shqiptare me shkallë më të ulët të kriminalitetit dhe ndërtimin e një imazhi të qëndrueshëm e të fortë të drejtësisë në vend.

Sipas rezultateve të ndërmarrja nga prokuroria në Tetovë, theksojmë se nivel qendror nga gjithsej të akuzuar 26.498, prej tyre 25.471, janë meshkuj,

kurse 1,027, janë femra apo shprehur në përqindje 96.1 %, meshkuj dhe 3.9 %, femra,(2014).Bazuar në këto statistika në qoftë së bëjmë një krahasim me statistikat e vendeve tjera ku përfshirja e femrës në aktivitete kriminale arrin shkallen e përfshirjes së femrës prej 8-10%.

Pjesa më e madhe e personave të papunësuar janë punëtorë të pakualifikuar (41.4%), me arsim të mesëm teknik janë 26.9% ndërsa pjesa më e vogël (9.7%) janë persona me arsim të lartë dhe universitar.

Analiza e shkallës së papunësisë sipas grupeve moshore tregon shpërndarje relativisht të barabartë, gjegjësisht në moshë prej 20-29 vjeç të papunësuar janë 575 (21.4%), në moshë prej 30-39 vjeç janë 644 (24%), në moshë prej 40-49 vjeç të papunësuar janë 617 (23%), në moshë prej 50-59 vjeç të papunësuar janë 599 persona (22.3%) nga numri i përgjithshëm i të papunësuarve. Në moshë mbi 60 vjeç të papunësuar janë 193 persona, ose 7.2% nga numri i përgjithshëm i të papunësuarve.

Sipas anketës që kemi realizuar, mosha e të anketuarëve, shihet qartë në përqindje mosha e pjesëmarësve në anketë, këtu mund të dallojmë se përqindja më e madhe është nga mosha 50-55 vjeç, nga kjo kuptojmë se pjesëmarësit e kësaj moshe janë më të informuar sa i përket temës tonë, Nga pjesëmarësit në hulumtimin del se të anketuarit në numër më të madh ishin me shkollim të lartë ndërsa me përqindje më të vogël ishin me përqindje shkollim të mesëm.

Mund të kuptojmë se numri më i madh i të anketuarëve është me shkollim të lartë, pastaj janë niveli i dytë ata me shkollim të mesëm me përqindje pak më të vogël. Shpërndarja e anketës në një qytet të ndryshëm prej ku vërehet se numri më i madh janë nga ana e Shkupit.

Anketa është realizuar me qytetarët e Tetovës aty ku është realizuar anketa janë takuar njerëz të cilët janë të venbanimit të Shkupit 37% e të anketuarëve janë nga ana e Shkupit, 63% e të anketuarit janë nga ana e Tetovës.

Para se të dënoheshim un jetoja bashkë më familjen këtë e thonë 38% e të anketuarëve kurse pjesa tjetër deklarojnë se 42% kanë qenë të varur ekonomikisht nga burri, familje/ prindërit. Po 70% kanë deklaruar se kanë

pasur marrëdhënie të mira më familjen kurse 30% kanë deklaruar se jo. 60% kanë deklaruar se kanë qenë të dhunuar psikologjikisht përpara burgosjes kurse 40% kanë deklaruar se jo.

65% kanë deklaruar se po u sigurohet kurse 35% kanë deklaruar se jo. 72% kanë deklaruar se është i mirë ushqimi kurse 28% kanë deklaruar se jo.

BIBLIOGRAFIA

I -Libra

1. A.Mandro, Dhuna Në Familje, E Drejta Familjare, Botimi I Parë, Tiranë, Dhjetor 2006
2. Alisabri Shabani, Muhamed Budimlic, Kriminologjia, Sarajevw/Prishtinw 2007
3. Anastasi, A., (2001). Kanuni i Zhurisë. Studime juridike, 1
4. Anastasi, A., etj., (2012). Barazia gjinore dhe mos-diskriminimi. Tiranë: Botimet Pegi.
5. Atabay, T., (2012). Udhëzuesin e Rregullave të Kombeve të Bashkuara për gratë e dënuara dhe masat jo me burgim për gratë e dënuara, Rregullat e Bangkokut. Botim i Reformës penale ndërkombëtare (Penal Reform International, PRI). Tërhequr nga më 15 gusht 2012 <http://www.penalreform.org/publications/bangkok-rules-guidance-document-and-index-compliance>
6. Austin, J., & Coventry, G., (2001). Çështje që lindin nga burgjet e privatizuara. Nju Jork: Departamenti i shtetit të SH. B. A.-së. Botim i Byrosë së mbështetjes së drejtësisë. Tërhequr më 15 prill 2011 nga <https://www.ncjrs.gov>
7. Benda, B. B., (2005). Ndryshimet gjinore në teorinë e recidivizmit: një analizë e mbijetesës.
8. Bloom, B., & Owen B., & Covington, S., (2003). Strategjitë e ndjeshme gjinore: kërkime, praktika dhe drejtim, parimet për gratë e privuara nga liria. Uashington, D. C.: Departamenti i Drejtësisë, Instituti Kombëtar i Korrektiveve.
9. Bloom, B., & Owen, B., & Convington, S., & Raeder, M., (2002). Strategjitë e ndjeshme ndaj gjinisë: Punë kërkimore dhe parimet drejtuese për gratë e dënuara.

10. Bloom, B., & Owen, B., & Convington, S., (2004). Gratë e dënuara dhe efektet gjinore të politikave publike. Rishikim i punës kërkimore të politikave, 21
11. Boers, K., (2003). Krimi, frika e krimit dhe mënyrat e kontrollimit të krimit në dritën e anketimeve të viktimave dhe studimeve të tjera empirike. Artikull i prezantuar në Konferencën e 22-të shkencore të Këshillit të Evropës, Strasburg, 24-26 Nëntor 2003. Fq. 20
12. ÇELA, PEZA, ELEZI, GJIK, E Drejta Penale E Republikës Popullore Socialiste Të Shqipërisë, Pjesa E Përgjithshme, 1982
13. Downs, D., (1996). Më shumë sesa viktima: Gratë e rrahura, sindroma e shoqërisë dhe e ligjit. SH.B.A.
14. ELEZI.I, E Drejta Penale, Pjesa E Përgjithshme, 2008
15. ELEZI.I, E Drejta Penale, Pjesa Posacme, Botime Erik, 2007
16. ELEZI.I, KAÇUPI.S, HAXHIA.M, Komentari I Kodit Penal Të Republikës Së Shqipërisë, 2012
17. ISLAMI. H, HOXHA. A, PANDA.I, Procedura Penale, Tiranë 2007
18. Ismail Zejneli, E drejta e Procedurës Penale e Republikës së Maqedonisë, 2017
19. Ismail, Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë, 2018
20. KAMBOVSKI.V, E Drejta Penale, Pjesa Përgjithshme, Shkup 2010
21. Kerezsi, K., (2004). Siguria njerëzore në Evropën Jug-lindore. Budapest: Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti ELTE.
22. Lafave, W.R., & Scott A.W., (1986). Mbrojtja e papërgjeshmërisë dhe juria. Revista E drejta penale, 4.5.
23. M.FONCAULT., “Disiplinë Dhe Ndëshkim, (Lindja E Burgut)”, Përkthim , “Odeon”, Tiranë 2010.
24. MUÇI.SH, E Drejta Penale, Pjesa E Përgjithshme, Tiranë 2012
25. Prof.Dr. Vasilika Hysi "Kriminologjia", Shtëpia Botuese Kristalina-KH ISBN 978-99956-43-20-1, Tirane 2010
26. Prof.Dr. Vasilika Hysi "Penologjia" Tiranë 2010

27. Revistë ndërkombëtare e Terapisë së të dënuarve dhe kriminologjia krahasuese,
28. SALIHU.I, E Drejta Penale, Pjesa E Përgjithshme, Prishtinë 2010
29. SHEGANI.A, Penale Krahasuar, Tiranë 2002
30. SPIRO.S., “Elementët Përbërës Të Figurës Së Veprës Penale”, Cikël Leksionesh, UET, Tiranë 2009.
31. Sufaj F., (2000). Historia e Burgjeve të Shqipërisë gjatë shekullit të XX. Tiranë.
32. Sufaj, F., (2008). Ekzekutimi i vendimeve penale, aspekte historike në përfaqje me problemet aktuale. Jeta juridike, 3.
33. Sydney, L., (2005). Strategjitë e ndjeshme ndaj gjinisë. Uashington, D.C.: Departamenti i Drejtësisë, Instituti Kombëtar i Korrektimeve.
34. Sykes, G.,(1958). Shoqëria e të kapurve: Një studim i një burgu të sigurisë se lartë. Prinstoun: Shtypi i Universitetit Prinstoun.
35. Vllado Kambovski, Ismail Zejneli, E drejta penale pjesa e përgjithshmë, Tetovë, 2018
36. Водич За Психолошка Помош И Поддршка На Жртвите На Семејно Насилство, Прирачник, Здружение За Еманципација, Солидарност, И Еднаквост На Жените На Р.М. – ЕСЕ, Скопје, 2010
37. Практикум За Постапување Во Случаи На Семејно Насилство, Академија За Судии И Јавни Обвинители, Скопје
38. Чачева, В., Фришчиќ,Ј., Мишев, С., Живот Во Сенка, ЕСЕ.Скопје, 2007

III- Ligje, Kushtetuta

1. Kodi Penal i Republikës së Kosovës
2. Komentari i normave penale të dhunës seksuale dhe të pedofilisë; A. Cadoppi 2002
3. Konventa europiane për parandalimin e torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese Teksti i Konventës dhe raporti shpjegues Seria e traktateve europiane - nr. 126. Teksti i rishikuar në përputhje me dispozitat Protokolleve nr. 1 (STE nr. 151) dhe nr.2 - STE nr. 152), që kanë hyrë në fuqi më 1 mars 2002
4. Konventa europiane për të drejtat e njeriut, Korrik, 2010
5. Kushtetura e Republikës së Maqedonisë së Veriut
6. Kushtetuta e Rep. së Maqedonisë
7. Kushtetuta e Republikës së Kosovës
8. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut
9. Ligj nr.8331 dt 21.04.1998 "Për ekzekutimin e vendimeve penale" i përditësuar
10. Ligji mbi shtetet; Gerhard von Glahn, James Larry Taulbee, 2015
11. Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e grave të Burgosurave dhe Masat pa-burgim për Gratë Kundërvajtëse (Rregullat e Bangkokut)
12. Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve
13. Studimi "Shoqëria shqiptare përballë sfidave të trafikut të grave dhe vajzave", i kryer nga Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe për Zhvillimin
14. Национална стратегија за заштита од семејно насилство 2008 - 2011 година
15. Ligji Nr. 7905, 21 Mars 1995, `Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë`, i ndryshuar. Tërhequr më 15 maj 2011 nga <http://www.justice.gov.al/>

16. Ligji nr. 8328, 16 Prill 1998, `Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe paraburgosurve`, i ndryshuar. Tërhequr më 15 maj 2011 nga <http://www.justice.gov.al/>
17. Ligji nr. 8331, 21 Prill 1998, `Për ekzekutimin e vendimeve penale` i ndryshuar. Tërhequr më 15 maj 2011 nga <http://www.justice.gov.al/>
18. Ligji nr. 8454, 02 Prill 1999, `Për Avokatin e Popullit`, i ndryshuar. Tërhequr më 15 maj 2011 nga <http://www.justice.gov.al/>
19. Ligji nr. 8678, 14 Maj 2001, `Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtës`
20. i ndryshuar. Tërhequr më 15 maj 2011 nga <http://www.justice.gov.al/>
21. Ligji nr. 10032, 11 Dhjetor 2008, `Për policinë e burgjeve`. Tërhequr më 15 maj 2011 nga <http://www.justice.gov.al/>
22. Ligji nr. 10 295, 1 Korrik 2010, `Për faljen`. Tërhequr më 15 maj 2011 nga <http://www.justice.gov.al/>
23. Ligji nr. 10039, 22 Dhjetor 2010, `Për ndihmën juridike`. Tërhequr më 15 maj 2011 nga <http://www.justice.gov.al/>
24. Ligji nr. 9669, 18 dhjetor 2006, `Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare`.